



**IMAM MEHDIU**

*Shahid Muhammed Bakir Es-Sadër*

“... të gjithë atyre që gjatë tërë shekujve u mbetën besnik idealeve dhe  
mësimeve madhore të Ehli-Bejtit a.s duke u ekspozuar karshi mundimeve, torturave,  
mynxyrave dhe sakrificave nga më të ndryshmet...”

*( Përkthyesi )*

## BIOGRAFIA E SHEHID AJATULLAH MUHAMMED BAKIR ES-SADR

- Muhammed Bakir Ibn Sejjid Hajdar Ibn Ismail Es-Sadri, dijetar, udhëheqës fetar, mësues dhe personalitet i shquar politik, u lind në Kazimain afër Bagdatit, në Irak në vitin 1350 hënor, sipas hixhretit, përkatësisht në vitin 1931 simbas Isait a.s.

- Rrjedh nga një familje e vjetër dhe shumë e njohur, e cila ka dhënë një sërë personalitetesh të shquara në Irak, Iran, dhe Liban. Disa prej këtyre janë:

1. Sejjid Sadrud-din Es-Sadri, i cili ishte merxh'a (që në shiizëm d.m.th ekspert fetar i cili duhet të ndiqet-pasohet) në qytetin e Komit;

2. Muhammed Es-Sadri, udhëheqës fetar i cili lozi rol mjaft të rëndësishëm në revolucionin irakian kundër Britanisë, i cili revolucion u organizua dhe u udhëhoq nga ana e liderëve fetarë, të cilët ia dolën që ta mposhtin Britaninë. Ai, gjithashtu është edhe themeluesi i Forcave të Pavarura të Mbrojtjes (Haras El-Istikhal); dhe

3. Musa Es-Sadri, udhëheqësi (lideri) i shiitëve të Libanit.

- Në moshën katër vjeçare Muhammed Bakir Es-Sadrit I vdiq i ati.

Kështu që, edukimin dhe përkujdesjen ndaj tij e morën përsipër nëna e tij, një grua me virtyte të larta fetare, dhe vëllai më i vjetër Ismaili, i cili gjithashtu në Irak ishte i njohur si muxhtehid (dijetar i cili është i aftë që në mënyrë të pavarur, vetanake të sjell vendime ligjore).

Ismaili thoshte që Muhammedi qysh në rininë e tij të hershme filloi të shquhet me intelegjencën e tij të theksuar. Që në moshën dhjetë vjeçare filloi të mbante ligjërata nga historia islame, si dhe nga disa lëmi tjera të kulturës islame. Ishte i aftë që pa ndihmën e mësuesit t'i kuptojë pyetjet e rënda teologjike-fetare. Në moshën njëmbëdhjetë vjeçare filloi ta mësojë lëndën e logjikës, si dhe madje shkroi edhe një libër në të cilin i kritikonte filozofët, ndërsa në moshën trembëdhjetë vjeçare vëllai-Ismaili filloi t'ia mësonte Usulul-Ilmul-Fikhun (Bazat e shkencës së fikhut të bazuara në Kur'an, Hadith, koncesusin e pranueshëm etj.)

- Kur i mbushi gjashtëmbëdhjetë vjet, duke patur dëshirë të flaktë për zgjerimin e diturive sa më të mira e të mëdhaja në lëmitë e ndryshme islame, vajti në qytetin e Nexhefit. Katër vjet më vonë e shkroi veprën "Gajatul-fikr fil-Usul" ("Domethëniet themelore mbi Usulin"), që është si një lloj enciklopedie mbi Usulin. Nga kjo vepër është botuar vetëm një vëllim.

- Muhammed Bakir Es-Sadri në moshën njëzetepesë vjeçare filloi ta mësojë bahs harixh-in (shkallën më të lartë në edukimin e lëmisë së Usulit). Vlen të theksohet se në këtë kohë ishte më i riu prej të gjithë studentëve tjerë. Gjithashtu e mësoi edhe lëndën (shkencën) e fikhut (ligjit islam). Duhet të potencohet edhe fakti se në moshën tridhjetë vjeçare u bë muxhtehid.

- Në punimet e tij e sulmonte materializmin dialektik dhe në vend të kësaj (materializmit dialektik, vërej. e përkth.) paraqiste qasjen islame në Bërjen e dallimit mes të së vërtetës dhe humbjes-jo të së vërtetës. Shumë ka shkruar mbi ekonominë islame, kështu që me të (Muhammed Bakir Es-Sadri, vërej. e përkth.) mu për këtë shpesh-herë konsultoheshin organizata të ndryshme islamike, siç është fjala Banka Islame e Zhvillimit, etj.

- Gjithashtu përfaqësonte organizimin e lëvizjes islame, përkatësisht ishte ideatori kryesor i organizatës së tillë, e cila në vendet më të ndryshme të botës islame, do të ishte e aftë të punon në drejtim të realizimit të ndryshimeve shoqërore aq shumë të pritura. Ai ishte themeluesi i " Hizbul-da'vel-Islamijetu" ("Partia e Thirrjes Islame"). Predikonte se politika është pjesë e Islamit. Njëherit edhe i ftonte muslimanët që të njihen me traditën e pasur islame, si dhe të çlirohen prej çfarëdo lloj ndikimi të jashtëm, posaçërisht prej ndikimit të kapitalizmit dhe marksizmit. U bënte

thirrje muslimanëve që të largohen nga pasiviteti dhe t'i arrijnë këto synime tejet të rëndësishme duke i zgjeruar mësimet e tyre në mbarë botën islame, njësoj sikur që imperialistët pamëshirshëm shkatërronin mësimet islame. Muslimanët duhet patjetër që nëpërmjet lidhjes së fortë të sistemeve të tyre shoqërore, ekonomike dhe politike, të bashkuar si një trup i vetëm t'u qëndrojnë karshi (në ballë) këtyre sulmeve.

- Për shkak të bindjeve të tija politike dhe mësimëve të shëndosha, të cilat e çuan që ta kritikojë regjimin e partisë BA'S në Irak, regjim ky i cili i thyente-shkelte të drejtat njerëzore dhe normat islame, Ajatullah Muhammed Bakir Es-Sadri u burgos dhe u transferua prej Nexhefit në Bagdat. Pas kësaj u lirua nga burgu, por shkurtëvetëm deri në qershor të vitit 1979, kur sërish në qytetin e Nexhefit u burgos.

- Motra e tij Bintul-Huda, e cila gjithashtu ishte eksperte në çështjet e mësimëve teologjike islame, organizoi protesta kundër burgosjes së merxheas. Një sërë protestash kundër burgosjes së Ajatullah Sadrit u organizuan në mbarë Irakun dhe jashtë tij-në shtete tjera. Ndoshta pikërisht kjo ndikoi në lëshimin e tij prej burgut. Mirëpo, edhe përkundër kësaj u mbajt për plotë 9-të muaj në burgim shtëpiak. Tensioni mes tij dhe Partisë BA'S sa vinte e acarohet. Në këtë kohë shpalli fetva (vendim juridik-bazuar në Sheriat) që muslimanëve u është haram (rreptësisht e ndaluar) antarësimi në Partinë joislamike të BA'S-it; Fill pas kësaj, më 5 prill të vitit 1980 sërish u burgos dhe u transferua në Bagdat. Ai dhe motra e tij- Bintul-Huda tri ditë pas burgosjes u vranë (ekzekutuan). Trupat e tyre të pajetë u kthyen në qytetin e Nexhefit ku edhe u varrosën. Vdekja e tyre është e mbështjellur me një vello të madhe misteri. Shumë pyetje mbeten pa përgjigje, siç janë p.sh: cili ishte synimi i cili qëndronte prapa vrasjes së tyre, si dhe identiteti i atyre që e udhëhoqën tërë këtë operacion...

- Ajatullah Sadri shkroi një varg artikujsh gazetareske. Gjithashtu shkroi një numër bukur të madh librash, shumica nga fusha e ekonomisë, sociologjisë, teologjisë dhe filozofisë; më të njohura nga këto libra janë:

1. "El-Fetva El-Vahida" ("Fetva të qarta");
2. "Menhaxhus-Salihin" ("Rruga e të drejtëve")- Në këtë libër është prezentuar pikëpamja bashkëkohore mbi mesail-in;
3. "Iktisaduna" ("Ekonomia jonë")- Libri përbëhet prej dy vëllimesh, në të cilat detajisht diskuton mbi ekonominë islame, si dhe e sulmon njëkohësisht si kapitalizmin ashtu edhe komunizmin;
4. "El-Medresetul-Islamijjetu" ("Shkolla Islame");
5. "Gajatul-fikr fil-Usul" ("Domethëniet themelore mbi Usulin");
6. Ta'ligat 'ala el-Asfar" ("Komentimi i katër librave mbi udhëtimet e Mulla Sadrit");
7. "Menabiul-kudra fi devletul-islam" ("Burimet e fuqisë së Shtetit Islam");
8. "El-bank El-Islamijjetu" ("Banka Islame");
9. "Durus fi Ilmul-Usul" ("Ligjërata mbi parimet e Ligjit Islam");
10. "El-Mursil, Ver-Resul, Ver-Risale, ("Dërguesi, i Dërguari dhe mesazhi");
11. "Ahkamul-Haxh-xh" ("Rregullat e Haxhit");
12. "El-Usus el-mentikija lil-istikra" ("Themelet logjike të përfundimeve");
13. "Felsefetuna" ("Filozofia jonë"); dhe
14. "Ehlul-Bejti a.s ("Familja e Pejgamberit a.s") si dhe një varg të plotë librash të tjerë...

*' dhjetor 1996, Zenicë.*

Al-lame Sejjid Husein Tabatabai

## **NJOHURI MBI IMAMËT**

( pjesë e nxjerrë prej librit “Shiitët në Islam” )

### **RËNDËSIA ( DOMETHËNIA) E IMAMIT:**

- Imam ose udhëheqës është titulli që i jepet udhëheqësit të bashkësisë, të lëvizjes së caktuar shoqërore, të ideologjisë politike, të mendimit të caktuar fetar bazuar në njohuri të thella. Është e kuptueshme që për shkak të raportit që ka me njerëzit të cilët i udhëheq, ai doemos duhet t’i harmonizojë veprimtaritë e veta me aftësitë e tyre, qoftë kjo kur ka të bëjë me çështjet kryesore, apo me ato të dorës së dytë-periferike.
- Tani më dihet qartë se feja e shenjtë islame shqyrton dhe përshkruan norma lidhur me të gjitha aspektet e jetës, të të gjithë njerëzve. Hulumton jetën njerëzore nga aspekti i këndvështrimit shpirtëror dhe e drejton njeriun drejt kësaj, gjithashtu Feja Islame, ndërmjetëson në mes nivelit material dhe psikik të të ekzistuarit, nga pikëpamja e ekzistencës së individit si qenie njerëzore. Kështu që, në të njëjtën mënyrë vepron edhe në planin shoqëror të jetës si dhe normave të saja, d.m.th në fushën e pushtetit.
- Ndaj, nisur nga kjo imamati dhe udhëheqja fetare në Islam mund të studjohen nga tri këndvështrime të ndryshme: nga këndvështrimi i pushtetit islam, këndvështrimi i diturive dhe njohurive islame, si dhe këndvështrimi i të udhëhequrit dhe ndryshimit të udhëheqësisë në jetën shoqërore. Shiizmi beson, duke u nisur nga ajo se shoqërisë islame patjetër i nevojitet udhëheqje në tërë këto tri aspekte të sipërpërmendura, që personi i cili e merr detyrën e udhëheqësit (prijësit) dhe i cili është njëherit edhe udhëheqës i shoqërisë në këto tri fusha të çështjeve fetare, duhet të jetë i caktuar nga ana e Zotit dhe i Dërguari i Tij. Natyrisht, edhe vetë i Dërguari i All-llahut, gjithashtu ishte i zgjedhur me urdhërin e Zotit.

### **IMAMATI DHE NDJEKJA E TIJ:**

- Njeriu, nga vetë natyra e tij dhënë prej Zotit, pa kurrfarë dyshimi vëren se asnjë shoqëri e organizuar, siç është shteti, qyteti, fshati, fisi apo bile edhe familja, e cila përbëhet prej disa qenieve njerëzore, nuk mundet të vazhdojë së ekzistuari pa udhëheqës dhe kryetar, i cili i vë në lëvizje rrjedhat e shoqërisë dhe vullneti i të cilit ndikon në anëtarët e asaj shoqërie që të bëjnë kryerjen e obligimeve të tyre shoqërore. Pa një udhëheqës të këtillë pjesëtarët e asaj shoqërie, për një kohë të shkurtër prishen/shkatërrohen, dhe për pasojë mbisundon rrëmuja dhe kaosi.
- Prandaj, ai i cili është udhëheqës dhe drejtues i shoqërisë-qoftë ajo e madhe apo e vogël, nëse është i interesuar për pozitën e tij vetanake dhe ekzistimin e përhershëm të shoqërisë së tij, do të caktojë, në rast të mungesës nga funksioni i tij, përkohësisht apo përgjithnjë-trashëgimtarin e tij. Ai asnjëherë nuk do ta lëshojë territorin e shoqërisë ku udhëheq dhe kurrë nuk do të jetë i pavetëdijshëm për ekzistimin e saj, apo shkatërrimin. I zoti i shtëpisë, i cili për ua thotë lamtumirën shtëpisë së vet dhe familjes, për shkak të udhëtimit disa ditë, apo mujor, do të caktojë trashëgimtarin-zëvendësin e tij prej mjedisit të anëtarëve të familjes, apo ndonjë person tjetër dhe kështu, në këtë mënyrë do t’i lë punët e shtëpisë në duart e tij. Shefi i ndërmarrjes, drejtori i shkollës apo pronari i puntorisë, nëse mungojnë për disa orë, gjithashtu do ta caktojnë dikë që t’i përfaqësojë.

- Po kështu, Islami është fe e cila duke u ngritur mbi tekstet e Kur'anit të Shenjtë dhe Sunetit të pejgamberit s.a.v.s është ndërtuar në natyrshmërinë parësore të gjërave. Islami është fe e cila është e lidhur për jetën shoqërore, ashtu siç mund ta vërej ç' do hulumtues qoftë nga afër apo nga larg. Vëmendja e posaçme që All-llahu dhe pejgamberi i Tij i kanë kushtuar natyrës shoqërore të kësaj feje, kurrë nuk mundet të anashkalohet apo të mos merret parasysh. Mu kjo është një karakteristikë e papërshkruar dhe e pakrahasuar e Islamit.

Pejgamberi i All-llahut asnjëherë nuk harroi në çështjen e formimit të grupeve shoqërore kudo që ndikimi i Islamit depërtonte. Cilido qoftë qytet apo fshat i cili arrinte në duar të muslimanëve, ai-Pejgamberi s.a.v.s në afatin e shkurtër sa më të mundshëm, caktonte administratorin apo udhëheqësin, në duart e të cilit i lente punët e muslimanëve. (1) Në ekspeditat mjaft të rëndësishme ushtarake (xhihad), ai caktonte më shumë se një udhëheqës dhe disa komandantë, me qëllim që të ekzistonte mundësia e ndryshimit. Në betejën e Mut'es ai caktoi madje katër komandantë, në rast se i pari vritej, i dyti menjëherë ta merrte komandën dhe komanda e tij kështu të zbatohej, dhe kështu me radhë edhe me të tretin, të katërtin...(2)

- Pejgamberi i All-llahut tregoi mjaft interesim për çështjen e trashëgimtarit dhe kurrë nuk e la pa caktuar trashëgimtar kur kjo ishte e nevojshme. Kurdoherë që e lëshonte qytetin e Medinës, caktonte udhëheqësin në vend të tij. (3) Bile-bile edhe kur e bëri hixhretin (shpërnguljen nga Meka në Medine, derisa akoma nuk dihej se çfarë do të ndodhte, me qëllim që punët e tij në Mekë të kryhen për disa ditë, si dhe t'ua kthejë popullit gjërat e mara në besë, ai e caktoi Aliun (Paqja qoftë mbi të! ) si trashëgimtar të vetin (4). Në të njëjtën mënyrë, pas vdekjes së tij, Aliu ishte trashëgimtari i tij rreth çështjeve dhe pyetjeve që kishin të bëjnë me borxhet dhe punët e tij personale. (5) Shiitët pohojnë se mu për shkak të këtij rasti (kësaj ndodhie, vërejt e përkth.) mjaft të rëndësishme dhe domethënëse, është e papranueshme ajo që i Dërguari i All-llhut është shpërngulur prej kësaj bote, e të mos ketë caktuar dikë për trashëgimtar të tij, të mos ketë udhëheqësin dhe prijësin i cili do të udhëhiqte me punët e muslimanëve dhe i cili do ta lëvizte rrjedhën e shoqërisë islame mëtutje.

(1) Tarih Jakubi, vëllimi 3, f. 60,61; Sira Ibn Hisham, vëllimi 4, f. 197.

(2) Tarih Jakubi, vëllimi 2, f. 44,52,59; Sira Ibn Hisham, vëllimi 2, f. 223.

(3) Tarih Jakubi, vëllimi 2, f. 44,59,60; Sira Ibn Hisham, vëllimi 2, f. 251; vëllimi 4 f. 173,272

(4) Tarih Jakubi, vëllimi 2, f. 29; Tarih Ebil-Fida, vëllimi 1, f. 126; Sira Ibn Hisham, vëllimi 2, f. 98.

(5) Gajatul-Meram, f. 664; Musnedi i Ibn Hanbelit dhe të tjerë.

- Natyra parësore e njeriut nuk dyshon në peshën dhe vlerën e faktit se krijimi i shoqërisë varet prej përcaktimeve të caktuara e të përbashkëta, dhe traditave që në praktikë i ka pranuar shumica e pjesëtarëve të asaj shoqërie, si dhe atë që ekzistimi dhe qëndrueshmëria e asaj shoqërie gjithashtu varen nga qeveria e drejtë-e cila pranon që plotësisht t'i çmojë këto caktime. Secili që posedon inteligjencë nuk e konteston këtë, apo nuk e harron këtë fakt. Në të njëjtën kohë, individi nuk ka se si të dyshojë në rëndësinë dhe vlerën, për të cilën Pejgamberi i All-llahut konsideronte se Islami e posedon, ndaj për të cilën gjë shumë u sakrifikua, me qëllim të jetësimit dhe ruajtjes

së saj. Nuk mund të diskutohet për mendjen gjeniale, intiligjencën e përkryer, mendjemprehtësinë e njohjes, apo fuqinë e gjykimit të Pejgamberit të All-llahut (përveç se faktit se tërë kjo është e vërtetuar nëpërmjet Shpalljes dhe pejgamberllëkut).

- Duke u bazuar në hadithet e vërteta (autentike) si në përmbledhjet sunite ashtu edhe në ato shiite (në kapitujtë ku flitet për sprovat, trazirat,etj) të transmetuara nga Pejgamberi i All-llahut s.a.v.s, Pejgamberi s.a.v.s që më parë, paralajmëroi për kryengritjet dhe rrëmujat, të cilat do të ndodhin pas vdekjes së tij, dhe të cilat do ta përfshijnë shoqërinë islame, të shfaqura në formën më të pahijshme, që do të rezultojnë me njetosjen e trupit të ndritshëm të Islamit, gjithashtu paralajmëroi daljen në skenë të sundimtarëve të dashuruar pas kësaj bote-të cilët do ta shfrytëzojnë fenë e pastër islame për qëllimet e tyre të turpshme dhe të ndyta. Shtrohet pyetja: Si është e mundur që Pejgamberi s.a.v.s nuk kishte nevojë të mos u qasej këtyre ndodhive që do të pasonin, të mos fliste në detaje për sprovat nëpër vite, apo madje edhe në mijëra vite pas tij që do të ndodhnin, ta anashkalojë kushtin të cilin menjëherë pas vdekjes së tij duheshte të plotësohet? Apo, a thua ka qenë vallë i pakujdesshëm, ndaj edhe ta ketë konsideruar kusht të parëndësishëm, kushtin i cili shikuar nga njëra anë është i thjeshtë dhe i qartë, kurse nga ana tjetër megjithatë mjaft i rëndësishëm? Si është e mundur që të jetë përkujdesur për gjërat më të natyrshme dhe themelore, siç janë: të ngrënurit, të pirët, dhe fjetja, si dhe të jepë me qindra urdhëra në lidhje me këto çështje (imametin) dhe të mos caktojë dikë në vendin e tij?

- Bile edhe nëse e pranojmë supozimin (të cilin shiitët nuk e pranojnë) se zgjedhja e udhëheqësit të bashkësisë së muslimanëve, me Sheriat u është dhënë vetë njerëzve, megjithatë, përsëri do të ishte e nevojshme që Pejgamberi i All-llahut s.a.v.s të jepë përgjigje lidhur me këtë çështje. Ai do të duhej t'u jepte udhëzime më se të domosdoshme bashkësisë, me qëllim që kjo e fundit të ishte e vetëdijshme për problematikën nga e cila mvaret vetë ekzistenca dhe zhvillimi i bashkësisë së muslimanëve dhe jeta e simboleve dhe traditave fetare. Por, megjithatë nuk ka gjurmë të një shpjegimi të tillë nga ana e Pejgamberit s.a.v.s apo udhëzim fetar... Të ekzistonte diç e këtillë, ata të cilët e trashëguan Pejgamberin s.a.v.s dhe i mbanin penjtë e pushtetit absolut në duart e tyre, nuk do ta kundërshtonin një gjë të këtillë. Në të vërtetë halifi i parë e përcolli hilafetin tek halifi i dytë nëpërmjet këshillit gjashtë anëtarësh, antarë i të cilit ishte edhe ai vetë, dhe ecjen e mënyrën e procesit e përcaktoi dhe e drejtoi po ashtu vetë ai. Muaviu e detyroi Imam Hasanin të pranojë paqe dhe kësisoji në këtë mënyrë e rrëmbeu hilafatin. Pas kësaj ngjarjeje hilafeti u kthye (shndërrua) në mbretëri trashëguese. Gradualisht... shumë obligime fetare në raport me vitet e mëhershme të sundimit të Islamit (siç ishte fjala vjen: xihadi urdhërimi i asaj që është e ligjshme dhe ndalimi i asaj që është haram, themelet e kufizimit të veprimtarisë së njerëzve, etj.) plotësisht u dobësuan, apo madje edhe u zhdukën nga jeta politike e shoqërisë, kështu duke dobësuar në këtë drejtim mundin e papërshkruar të vetë Pejgamberit s.a.v.s.

- Shiizmi e studjoi dhe hulumtoi natyrën themelore të njeriut dhe traditën e përjetshme të urtësisë e cila mbijetoi tek njerëzit. Depërtoi në kuptimin themelor të Islamit, në ripërtëritjen e natyrës së parë (themelore) të njeriut, dhe i hulumtoi ato gjëra siç janë metodat me të cilat është shërbyer Pejgamberi i All-llahut xh.sh në udhëheqjen e bashkësisë (ummetit), problemet të cilat e kapluan Islamit dhe muslimanët dhe që çuan deri tek përçarja dhe ndarja, si dhe jetën e shkurtër të qeverive muslimane në shekujt e parë-të cilat ishin të karakterizuara me anashkalimin dhe lënien pas dore të normave të pastra islame. Si rezultat i këtij studimi, shiizmi erdhi në përfundim se ekzistojnë plotë tekste autentike tradicionale të cilat i ka lënë

Pejgamberi s.a.v.s që të caktojë mënyrën e zgjedhjes së Imamëve dhe trashëgimtarëve të Pejgamberit të All-llahut.

- Ky përfundim, përkatësisht konkluzë është e bazuar (shoqëruar) me ajete kur'anore dhe hadithe-të cilat shiizmi i konsideron të besueshëm, siç është ajeti mbi velajetin dhe hadithet e Ghadirit, Sifinit, Thekalejnit, Hakk-ut, Menziles, Da'vetit-ashirel-akrebinit dhe të tjerë. (1) Pa dyshim, këto hadithe shumicën e të cilëve e pranon edhe sunizmi, nuk janë njësoj të kuptuar në shiizëm dhe sunizëm... Ngase, në të kundërtën komplet çështja rreth pyetjes së trashëgimisë as që do të duhej të paraqitet. Meqë këto hadithe tek shiitët paraqiten si tregues i qartë i qëllimit të Pejgamberit të All-llahut kur është në pyetje trashëgimia, tek sunitët këto hadithe janë komentuar në mënyrë krejtësisht tjetërfare, kështuqë kjo çështje mbetet e hapur dhe pa përgjigje...

- Në argumentimin e hilafetit të Ali Ibn Ebu Talibit, shiitët kanë vërtetim në ajetet kur'anore, kurse njëri prej atyre ajeteve është edhe ky:

- “Mik i (afërt) juaji është vetëm All-llahu, është i Dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zeqatin duke bërë rukuë (duke qenë respektues)”. (El-Maide, 55)

Komentatorët shiitë dhe ata sunitë janë të një mendimi dhe unanimisht pajtohen se ky ajet kur'anor është shpallur për Ali Ibn Ebu Talibin, kurse gjithashtu ekzistojnë edhe plotë rrëfime sunitë dhe shiite të cilat e prekin këtë çështje. Ebu Dherr El-Giffari thotë: “Një ditë ishim duke e falur namazin e drekës bashkë me të Dërguarin s.a.v.s. Në ndërkohë, një njeri nevojtar, i shtyrë nga skamja e tij, kërkoi ndihmë, por askush nuk i dha gjë. Personi në fjalë i ngriti duart nga qielli duke thënë:

“ O Zot!

(1) Shënim i Sejjid Husein Nasrit: “Kjo të shpie në thëniet e ndryshme të Pejgamberit, në të cilat flitet mbi çështjen e Imamit. Më i njohuri prej tyre, “Hadithi i Ghadirit”, ashtu siç u përmend edhe më parë, është shkas tradicional i festimit të Ghadir-Bajramit. Prej kohës së Safavidëve-ky bajram është shndërruar në ngjarje mjaft me peshë politike në Iran, ngase kjo ditë shënon edhe formalisht përcjelljen e fuqisë politike të Aliut, nën mbrojtjen e të cilit kanë sunduar tërë mbretërit shiitë.”

- Bëhu dëshmitar se në Xhaminë e të Dërguarit s.a.v.s askush asnjë gjë nuk më dha;” Ali Ibn Ebu Talibi ishte duke u falur dhe pikërisht në këto çaste gjendej në rukuë. Menjëherë filloi ta drejtojë gishtin e tij në drejtim të varfanjakut, i cili e mori unazën prej gishtit të tij dhe shkoi. Pejgamberi s.a.v.s i cili po e shikonte tërë këtë skenë, e ngriti kokën e tij kah qielli dhe tha:” O Zot! Vëllai im Musai t'u drejtua Ty: “E vëllai im, Haruni, është më orator se unë, andaj dërgoje atë me mua ndihmë që të vërtetojë fjalët e mia... “ ( El-Kasas, 34) O Zot! Unë gjithashtu jam i Dërguari Yt, ndaj zgjeroje shpirtin tim dhe lehtësoi obligimet e mia, si dhe bëje që Aliu të jetë zëvendësi dhe ndihmësi im.” Ebu Dherr thotë:” Fjalët e Pejgamberit s.a.v.s akoma nuk ishin të shqiptuara ku u shpall ajeti i sipërpërmendur.” (1)

- Ajeti i dytë, të cilin shiitët e konsiderojnë për argument të hilafetit të Aliut është: “... Tashmë, ata që mohuan, humbën shpresën për fenë tuaj (se do të ndërroni), andaj mos u frikësohuni atyre, por Mua të më frikësoheni. Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjedha për ju Islamin fe...” (El-Maide, 3)

- Pa dyshim që rëndësia e këtij ajeti qëndron në atë se, përpara se të shpallet ky ajet në këtë ditë të caktuar, pabesimtarët shpresonin ende se do të vijë një ditë kur Islami do të vdesë... por, All-llahu, me realizimin e ndodhisë së caktuar, bëri që ata



(pabesimtarët) njëherë e përgjithmonë ta humbin shpresën se Islami do të shkatërrohet. Kjo ndodhi tejet e rëndësishme ishte shkak i forcimit dhe përsosjes së Fesë Islame, dhe s' do mend se rëndësia e këtij ajeti aspak nuk ishte e rëndësishë jo të madhe, në krahasim me fjala bie ndonjë ajet ku përcaktohen rregullat fetare, përkundrazi. Në të vërtetë, ky ajet ishte aq i rëndësishëm sa që madje edhe vetë zhvillimi dhe vazhdimi i Islamit varej nga kjo. (d.m.th zbritja e këtij ajeti kur'anor, vërej. e përkth.)

- Ky ajet është i lidhur me një ajet tjetër i cili gjendet në fund të po së njëjtës sure, përkatësisht ajeti 67 i sures El-Maide, ku All-llahu thotë:” O ti i Dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk e bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revelatën-risalen). All-llahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve ( prej armiqëve). All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon.”

- Ky ajet kur'anor tregon se All-llahu xh.sh Pejgamberit s.a.v.s i dha detyrë të rëndësishë dhe vlerës tejet të madhe, moskryerja e së cilës do të çonte në rrezikun e bazës së Islamit dhe pejgamberllëkut. Mirëpo, çështja ishte aq e rëndësishme sa që Pejgamberi s.a.v.s i frikësohej kundërshtimit dhe rezistencës, ndaj edhe hezitonte duke pritur rrethana më të favorshme, gjersa nuk i erdhi urdhëri i qartë dhe urgjent nga All-llahu xh.sh që ky urdhër doemos të zbatohet, pa shtyerje të mëtutjeshme dhe pa frikë nga kushdo qoftë.

(1) Taberiu, “Zeha'ir ul'ukba”, Kajro; 16. Ky hadith është shënuar edhe në një verzion jo të plotë në “ Ed-durr-ul mensur,” vëllimi 2; 293. Në “Gajatul-meramin” e tij, në 103, Bahrani sjell 24 hadithe prej burimeve sunite dhe 119 nga ato shiite- në lidhje me kushtet dhe shkaqet e shpalljes së këtij ajeti kur'anor.

Gjithashtu, kjo çështje nuk ishte vetvetiu vetëm urdhëresë fetare-në kuptimin e përgjithshëm të fjalës-ngase urdhërimi apo urdhëresa e një apo disa parimeve fetare nuk ishte e atyre përmasave, sa që moszbatimi i ndonjëres prej tyre do të çonte për rrjedhojë në shkatërrimin e vetë Islamit si fe. Gjithashtu i Dërguari i All-llahut nuk i frikësohej askujt në kumtimin e normave dhe ligjeve të fesë. Këto tregues dhe dëshmi u japin edhe një domethënie më tepër rrëfimeve shiite-të cilat pohojnë se këto ajete janë shpallur në ”Ghadir Hum” dhe se janë të lidhura për përfaqësimin (velajet) shpirtëror të Ali Ibn Ebu Talibit. Aq më tepër që, shumë komentatorë shiitë dhe sunitë e kanë vërtetuar këtë pohim.

- Ebu Said El-Hudriu thotë: ”Pejgamberi s.a.v.s në “Ghadir Hum” i thirri njerëzit në drejtim të Aliut, dhe e kapi pastaj Aliun për dore, si dhe e ngriti dorën aq lartë, sa që bardhësia e sqetullave të Resulull-llahit mund të shihej. Më pas u shpall ky ajet:”... Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju Islamin fe... (El-Maide, 3).

- Pas kësaj Pejgamberi s.a.v.s tha:

- “ All-llahu Ekber! (All-llahu është më i Madhi!), kjo fe u bë e plotësuar dhe bujaria e All-llahut u plotësua. Kënaqësinë dhe velajetin e Tij e fitoi Aliu;” Më pas shtoi:” Për cilindo që kam qenë shembull dhe prijës, Aliu për të është shembull dhe prijës. O Zot! Bëhu i mëshirshëm ndaj miqëve të Aliut dhe bëhu armik ndaj armiqëve të tij! Atë që e ndihmon Aliun, ndohmoje o Zot, kurse atë që e braktis, braktise edhe Ti o Zot”. (1)

- Në pika të shkurtëra mund të themi se armiqtë e Islamit, të cilët bënin gjithçka që ta shkatërrojnë Islamin, kur humbën të gjitha shpresat për një gjë të tillë, atëherë ata mbetën vetëm me një shpresë. Ata mendonin, meqë Muhammedi s.a.v.s ishte mbrojtës i Islamit, se pas vdekjes së tij, Islami do të shkatërrohet... Mirëpo në “Ghadir Hum” shpresat e tyre u vyshkën, ngase Muhammedi s.a.v.s e prezantoi përpara popullit Aliun si udhëheqës të Islamit. Ndërsa pas Aliut kjo detyrë e rëndë dhe e domosdoshme mbeti mbi supet e familjes së tij.
- Disa hadithe, të cilat i referohen ngjarjes në “Ghadir Hum”, zgjedhjes së Aliut për trashëgimtar, si dhe vlerën e Familjes së Pejgamberit s.a.v.s do t’i citojmë në vijim:
  - Hadithi i “Ghadirit”: Pejgamberi s.a.v.s duke u kthyer prej Haxhit Lamtumirës u ndal në “Ghadir Hum”, i tuboi muslimanët dhe pas mbajtjes së fjalimit e zgjodhi Aliun për prijës të besimtarëve.
  - Ber’a thotë:” Isha me Pejgamberin s.a.v.s gjatë Haxhit Lamtumirës, dhe kur mbërijtëm në “Ghadir Hum”, ai urdhëroi që ai vend të pastrohej. Pastaj e mori dorën e Aliut dhe e vendosi në anën e tij të djathtë. Atëherë tha: “ A jam unë autoriteti të cilin e dëgjoni?” Ata iu përgjigjën:” Ne iu nënshtrohemi urdhërave të tua.” Atëherë Pejgamberi s.a.v.s tha:” Çdokujt që unë i jam udhëheqës (mevla) dhe autoritet që e nderoni, Aliu do të jetë autoriteti i tij. O Zot! Bëhu Mik ndaj miqve të Aliut, kurse armik ndaj armiqtëve të Aliut,” Pas kësaj Omer Ibn Hattabi i tha Aliut:” Të qoftë për hajr ky post, prej tani ti je zotëriu im dhe zotëriu i të gjithë besimtarëve. (2)

(1) Bahrani, “Gajatul-Meram;” f. 336- ku ndodhen 6 hadithe sunite dhe 15-të shiite, në lidhje me shkakun dhe qëllimin e zbritjes së ajetit kur’anor të cilin e përmendëm më sipër.

- Hadithi i Sefineks: Ibn Abbasi thotë: “ Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:
  - Familja ime është sikur anija e Nuhit, kushdo që hyp në të do të shpëtojë, ndërsa kushdo që largohet prej saj do të shkatërrohet.” (1)
  - Hadithi i Thekalejnit: Zejd Ibn Erkami transmeton se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë:
    - All-llahu më thirri kah Ai dhe unë doemos duhet t’i nënshtrohem thirrjes së Tij. Ndaj po ua lë në mesin tuaj dy gjëra të mëdhaja e të çmuara: Librin e All-llahut (Kur’anin) dhe Familjen time. Jini të kujdesshëm se si do të silleni ndaj këtyre dy gjërave. Këto të dyja kurrë nuk do të ndahen, derisa nuk më takojnë mua tek Kevtheri (burimi në Xhennet).” (2)
    - Hadithi i Thekalejnit është njëri prej haditheve më autentike, dhe është transmetuar nëpërmjet një numri bukur të madh të transmetuesve me zinxhir të besueshëm, në versione të ndryshme. Shiitët dhe sunitët unanimisht pajtohen në lidhje me autenticitetin e këtij hadithi. Nga ky hadith mund të konstatohen disa gjëra me rëndësi:
      - 1. Në të njëjtën mënyrë, ashtu siç do të mbetet Kur’ani deri në Ditën e Kijametit, njësoj do të mbetet edhe Familja e Pejgamberit s.a.v.s përkatësisht pasardhësit e saj. Asnjë periudhë kohore nuk do të kalojë pa ekzistimin e personalitetit-të cilin shiizmi e quan Islam, udhëheqës të drejtë të njerëzve.
      - 2. Nëpërmjet këtyre dy amaneteve të mëdha, Pejgamberi s.a.v.s i siguroi të gjitha kërkesat e muslimanëve-Ai-s.a.v.s ia paraqiti Familjen e tij popullit si autoritet

dhe dituri, si dhe i theksoi fjalët e tij se fjalët dhe veprta e tyre janë të vlefshme dhe autoritative.

- 3. Nuk mund të ndahet Kur'ani i Madhnueshëm nga Familja e Pejgamberit s.a.v.s. Asnjë musliman nuk e ka të drejtën ta refuzon "diturinë" e anëtarëve të Familjes së Pejgamberit s.a.v.s dhe të largohet prej udhëzimeve dhe udhëheqjes së tyre.

- 4. Nëse njerëzit i dëgjojnë anëtarët e Familjes së Pejgamberit s.a.v.s dhe i ndjekin fjalët e tyre, kurrë nuk do të jenë në rrugë të humbur. All-llahu xh.sh prore (gjithnjë) do të jetë me ta.

- 5. Ekuilibrin mes kërkesave (nevojave) intelektuale dhe atyre fetare, njeriu mund ta gjejë tek anëtarët e Familjes së Pejgamberit s.a.v.s. Kushdo që i ndjek, assesi nuk do të bjerë në mëkat dhe do të mbërrijë tek gjendja e vërtetë e kënaqësisë, ngase antarët e Familjes së Pejgamberit s.a.v.s janë të pastër nga hamendja dhe mëkatet, ata janë të pagabueshëm. Nga kjo, mund të nxjerrim përfundim se shprehjet "anëtarët e Familjes" dhe "pasardhësit" nuk nënkuptojnë të gjithë pasardhësit dhe kushërinjtë e të Dërguarit të Zotit, por, në të vërtetë me "anëtarët e Familjes" mendohet në individë të caktuar të cilët janë të përsosur në njohjen e tyre ndaj diturive fetare, si dhe janë të mbrojtur nga humbja dhe mëkatet, kësajsoji që në këtë mënyrë janë të aftë t'u prijnë njerëzve.

(1) "Zeha'ir ul-ukba"; f. 20; "Es-Savaikul-muhrik"-prej Ibn Haxherit, Kajro, 1312; fq: 150 dhe 184; "Tarih-Hulefa"-prej Xhelaludin Sujutiut, Kajro f. 307; "Nurul-Ebsar"- nga Shiblejniu, Kajro, 1312, f. 114. Në "Gajatul-Meramin" e tij, në f. 237-Bahrani thekson 11 zinxhir transmetuesish të këtij hadithi nga burimet sunite dhe 17 nga ato shiite.

(2) "El-Bidaje ven Nihaje", vëllimi 5, f. 209; "Zehairul-ukba", f. 16; "El-Fusul-El-Muhime"; f. 22; "Hasais", f. 30; "Es-Savaikul-Muhrik", f. 147; Në "Gajtul-Meram"-39 verzione të këtij hadithi përmenden në burimet sunite, kurse 82 në ato shiite.

- Në shiizëm këta persona janë: Ali Ibn Ebu Talibi dhe njëmbëdhjetë pasardhësit e tij, të cilët janë të zgjedhur për imamet- njëri pas tjetrit. Ky komentim i këtyllë, gjithashtu është i vërtetuar edhe nga tradita shiite. Për shembull: Ibn Abbasi ka thënë: "E kam pyetur Pejgamberin s.a.v.s: Kush janë pasardhësit e tu, të cilët jemi të obliguar t'i duam? Ai m'u përgjigj:" Aliu, Fatimeja, Hasani dhe Husejni." (1). Xhabiri transmeton se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë: "All-llahu i vendoi gjithë fëmijët e pejgamberëve në "kurrizët" e tyre, kurse fëmijët e mi i vendosi në "kurrizin" e Aliut.

(2)

- Hadithi i hakkut (të vërtetës): Ummi Selemeja thotë: E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s duke thënë:

- "Aliu është me të Vërtetën (hakkun) dhe me Kur'anin, ndërsa e Vërteta dhe Kur'ani gjithashtu janë me Aliun, dhe kështu bashkë (të pandarë) do të jenë derisa nuk më takojnë mua tek Kevtheri". (3)

- A nuk je i kënaqur që të jesh për mua ashtu siç ishte Haruni për Musain, vetëm se dije që pas meje nuk ka më pejgamber?" (4)

- Hadithi i da'veti ashirah: Pejgamberi s.a.v.s i ftoi të gjithë familjen (kushërinjtë) në drekë, dhe pas ngrënies iu drejtua me fjalët:

- Nuk di për asnjë njeri që i ka sjellë të mira popullit të vet, aq sa u kam sjellë unë juve. All-llahu më urdhëroi që t'ju ftoj të ktheheni kah Ai. Ndaj, kush prej jush do të më ndihmojë në këtë, do të jetë vëllai im, trashëgimtari dhe mëkëmbësi (halifi) im?

“Të gjithë heshtën, mirëpo Aliu, i cili më i riu në mesin e gjithë të pranishmëve, u çua në këmbë duke thënë: “Unë do të jem zëvendësi dhe ndihmësi yt”; Më pas, Pejgamberi s.a.v.s e përqafoi dhe tha: “Ky është vëllai im, zëvendësi dhe trashëgimtari im. Ndaj duhet që të jeni të dëgjueshëm ndaj tij”; Pas kësaj, grupi i të ftuarve filloi të qeshet dhe t’i thotë Ebu Talibit: “Muhammedi të urdhëroi ta dëgjosh djalin tënd.” (5)

- Hudhejfeja transmeton: “ I Dërguari i All-llahut s.a.v.s ka thënë:

- “ Nëse e zgjidhni Aliun për zëvendës dhe trashëgimtar timin, gjë për të cilën besoj se nuk do ta bëni, në të do të gjeni prijës të shkathët (intiligjent) i cili do t’ju drejtojë kah rruga e vërtetë”. (6)

- Ibn Marđui thotë se Pejgamberi s.a.v.s ka thënë: “Kush dëshiron që jetën dhe vdekjen ta ketë sikur timen dhe të hyjë në Xhennet pas meje, duhet që ta dojë Aliun dhe ta ndjek Familjen time, ngase ata janë pasardhësit e mi dhe janë krijuar prej dheut tim. Dituria ime dhe të kuptuarit tim u janë dhuruar atyre. Prandaj, të mallkuar qofshin ata që e kontestojnë ndershmërinë e tyre. Të këtillët përgjithnjë do të jenë të privuar nga shefaati im në Ditën e Gjykimit”. (7)

(1) “Jenabiul-Mevedde” nga Sulejman Ibn Ibrahim Kundusi, Teheran, 1308, f. 311

(2) “Jenabiul-Mevedde” f. 318

(3) “Gajatul-Meram, f. 539 ku përmbledhja e këtij hadithi detajisht përmendet më tutje në 15 versione sunnite dhe 11 burime shiite.

(4) “El-Bidaje Ven-Nihaje”, vëllimi 7; f. 339; “Zehairul-Ukba”, f. 63, “El-Fusul El-Muhime”, f. 21, Kifajetut-talib El-Kanxhi Esh-Shafi”, Nexhef, 1356, 148-154, “Hasais”, 19-25, “Savaikul-Muhrik” f.177; Në “Gajatul-Meram” në f. 109 janë sjellur 100 versione të këtij hadithi detajisht prej burimeve sunnite, kurse 70 janë sjellur prej burimeve shiite.

(5) “Tarih Ebil-Fida; vëllimi 1, f. 116

(6) “Hiljetul-Evlja” nga Ebu Nuajm Isfahani, vëllimi; Kajro 1351, f. 64, “Kifajetut-talib, f. 67

(7) “Muntehab Kanzul-Ummal, nga margjinat e “Musnedit” të Ahmedit, Kajro, 1368; vëllimi 5, f. 94

## POHIMI I ASAJ QË U THEKSUA MË SIPËR

- Shumë prej argumenteve të shiizmit, që kanë të bëjnë me trashëgimtarin e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s fillojnë me ngjarjen e ditëve të fundit të jetës së Pejgamberit s.a.v.s derisa ishte i sëmurë, dhe kur në prezencë të disa prej as’habëve të tij, kërkoi një letër dhe ngjyrë (pendë) (1), me qëllim që të shkruajë diç që muslimanët nëse do ta praninin një shkresë të tillë, do t’i siguronte prej devijimit nga rruga e drejtë. Disa nga të pranishmit konsideronin se Pejgamberi s.a.v.s është tepër i sëmurë sa që nuk mund të jetë në gjendje që të urdhëron diç, ndaj edhe thanë: “Na njafton Libri i All-llahut (Kur’ani)”. Filloi të bëhet një skenë tollovie dhe të ngriten zërat rreth kësaj çështjeje, kështuqë Pejgamberi s.a.v.s u tha të pranishmëve që ta lëshojnë dhomën e tij, ngase në prezencë të të Dërguarit të All-llahut nuk duhet të ketë kurrfarë tollovie dhe ngritje zëri me të madhe (zhurmë).

- Duke marrë parasysh argumentet e theksuara në hadithet e sipërpërmendura, që kanë të bëjnë me trashëgimtarin e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s dhe ngjarjet të cilat pasojnë pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s, aq më tepër edhe faktin se Aliu nuk është konsultuar me rastin e zgjedhjes së zëvendësit të Pejgamberit s.a.v.s, shiitët arrijnë në përfundim se Pejgamberi s.a.v.s ka dëshiruar që në çastet e fundit të jetës së tij, të dikton qëndrimet e tij të qarta rreth personit i cili duhet ta ndjek, mirëpo, ja që një gjë e tillë nuk iu mundësua...

- Duket se qëllimi i disa prej të pranishmëve që bënë zhurmë, ishte shkaktimi i tollovisë dhe si rrjedhojë ndalimi i vendimit të paralajmëruar përfundimtar. Ndalimi që ata ia bënë fjalimit të Pejgamberit s.a.v.s, ashtu siç thuhet edhe më shpesh, gjithashtu ishte e inicuar kundrejt mundësisë që Pejgamberi s.a.v.s ndoshta, do të mund të shprehte fjalë jo të lidhura (të shprehura rrjedhshëm) për shkak të fuqisë së dhimbjeve nga sëmundja e tij. Para se gjithash, gjatë sëmundjes së Pejgamberit s.a.v.s, askush kurrë nuk dëgjoi që ai të ketë folur apo pëshpëritur apo palidhje ose diç të ngjashme që ka të bëjë me të, bile një gjë e tillë as që është shënuar apo transmetuar. Aq më tepër që, në përputhje me parimet e Islamit, All-llahu xh.sh e mbrojti të Dërguarin e Vet nga pëshpëritja apo shprehja e fjalëve të pakontrolluara, ai ishte i pagabueshëm...

- E dyta: Nëse, fjalët, disa prej të pranishmëve të cilët i shqiptuan me atë rast përpara Pejgamberit s.a.v.s nuk do të ishin të natyrës serioze, atëherë nuk do të kishte vend për deklaratën vijuese: “Na mjafton Libri i All-llahut”. Në qëllimin që të tregohet se Pejgamberi s.a.v.s, ndoshta, ka shqiptuar fjalë të parputhura, në rrethana të jashtëzakonshme, së pari do të duhej të merrej si shkak sëmundja e tij e rëndë, se sa fjalët se përveç Kur’anit nuk ka më nevojë për fjalët e Pejgamberit s.a.v.s. Në përputhje me tekstin e Kur’anit të Madhnueshëm, muslimanët duhet të jenë të dëgjueshëm si ndaj urdhërave të All-llahut xh.sh ashtu edhe ndaj atyre të Pejgamberit s.a.v.s.

- E treta: Një ngjarje jo e këndshme ndodhi gjatë kohës së sëmundjes, përkatësisht në ditët e fundit të jetës së halifit të parë, i cili me urdhërin e tij të fundit dhe me testament e zgjodhi halifin e dytë si trashëgimtar të tijin. Kur Osmani po shkruante porosinë konform urdhërit të halifit, halifi u alivanos dhe i humbi vetedija. Megjithatë, halifi i dytë nuk i përsëriti fjalët të cilat u shqiptuan në rastin e Pejgamberit s.a.v.s, në përputhje me hadhithin “Penda dhe Letra”. (1)

- Ky fakt është vërtetim-pohim në hadithin të cilin e transmeton Ibn Abbasi.(2) Ai konsideron se halifi i dytë ka thënë: “Aliu e ka merituar hilafetin, mirëpo kurejshitët nuk do të ishin në gjendje ta përballojnë këtë, ngase nëse Aliu do të ishte halif, do t’i urdhëronte njerëzit ta pranojnë fenë e pastër dhe ta ndjekin rrugën e vërtetë. Nën hilafetin e tij, ata do të ishin në gjendje t’i kapërcejnë kufinj të drejtësisë, dhe për shkak të kësaj ata do të iniconin fillimin e luftës me të”. (3)

- S’do mend që, në përputhje me parimet fetare, atë i cili devijon nga rruga e vërtetë, atëherë dikush duhet t’a detyrojë ta ndjekë atë rrugë (të drejtë); Nuk guxon të lëshohet e vërteta, për shkak të atij që e ka lëshuar. Kur halifin e parë e lajmëruan (4), se disa fise muslimane refuzojnë të japin zeqatin, ai u shpalli luftë dhe tha: “Nëse vazhdojnë të mos e japin zeqatin, ashtu siç ia jepnin Pejgamberit s.a.v.s, unë do të luftoj me ta”. Pa dyshim që nëpërmjet kësaj deklarate ka dashur të thotë se e vërteta dhe drejtësia duhet të arrihen me çdo çmim. Me siguri që problemi i validitetit të halifit ka qenë më i rëndësishëm dhe më domethënës se sa zeqati, dhe shiizmi beson se të njëjtin princip që e përdori halifi i parë, do të duheshte të përdoret edhe nga ana e tërë bashkësisë, në çështjen e trashëgimit të të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.

## **IMAMATI DHE ROLI I TIJ NË SQARIMIN E DITURIVE HYJNORE (TË ZOTIT)**

- Konform ligjit të pandryshueshëm të udhëzimit të përgjithshëm, çdo lloj krijese përmes krijimit dhe lindjes udhëzon drejt përsosshmërisë dhe mirëqenies së llojit të vet. Kuptohet që, gjinia njerëzore nuk bën veçim në këtë ligj të përgjithshëm. Njeriu duhet që nëpërmjet përpjekjeve “madhore” dhe përsiatjes së të vërtetës, në atë mënyrë, që gjendja e tij e mirëqenies të forcohet si në këtë ashtu edhe në botën tjetër. Me fjalë të tjera, për ta arritur mirëqenien njerëzore dhe përsosshmërinë e tij, njeriu duhet t’i pranon një varg detyrimesh, teorike dhe praktike, si dhe ta ndërtojë jetën e tij mbi këto parime.

- Aq më tepër që, mënyra e kuptimit të programit të plotë të jetës- e cila quhet fe, nuk ka ardhur përmes arsyes, por me anë të Shpalljes dhe pejgamberllëkut, të cilat, sërisht dëftohen (shfaqen) përmes qenieve të caktuara e të pastra, nga mjedisi i gjinisë njerëzore- të cilët quhen pejgamberë

- (1) “El-Kamil”, vëllimi 2, f. 292; “Sherhu” nga Ibn Ebil-Hadidi, vëllimi 1; f. 54
- (2) “Sherhu” i Ibn Ebil-Hadidit, vëllimi 1, f. 134
- (3) “Tarih Jakub”, vëllimi 2, f. 137
- (4) “El-Bidaje Ven-Nihaje”, vëllimi 6; f. 311

Pejgamberët janë ata që pranojnë prej Zotit, nëpërmjet Shpalljes, njohuri (dituri) mbi obligimet e njerëzve, kështu që këta të fundit-njerëzit duke i përmbushur të mbërrijnë mirëqenien e tyre.

- Kuptohet që, në të njëjtën mënyrë, ashtu siç ky përfundim tregon domosdoshmërinë e dijes, e cila e çon njeriun kah arritja e lumturisë dhe përsosshmërisë, ajo (pra njohja, dituria) gjithashtu tregon domosdoshmërinë e ekzistimit të individëve të cilët e sigurojnë të paprekur, trupin e tërësishëm të asaj diturie, dhe të cilët kur e lyp nevoja i udhëzojnë edhe njerëzit.

- Sikur që mëshira e All-llahut (Rahmeti) kërkon ekzistimin e individëve të cilët i njohin detyrimet e gjinisë njerëzore përmes Shpalljes, ashtu e bën të domosdoshëm që këto detyrime njerëzore dhe vepra, të prejardhjes hyjnore, përgjithmonë të mbeten të mbrojtur në këtë botë, dhe nëse paraqitet nevoja atëherë t’u prezentohen dhe shfaqen, përkatësisht shpjegohen gjinisë njerëzore. Me fjalë të tjera, gjithnjë duhet të ekzistojnë individë të cilët e mbrojnë fenë e All-llahut dhe kur e lyp nevoja-madje edhe e shpjegojnë.

- Individu i cili e kryen detyrën e mbrojtjes dhe sigurimit të Porosisë së All-llahut xh.sh, pasi ajo është shpallur, dhe të cilën Zoti e zgjodhi për të, dhe ky individ quhet Imam, në të njëjtën mënyrë sikur që personi i cili e mban në vete shpirtin-frymën pejgamberike dhe i cili ka për obligim pranimin e udhëzimeve të Zotit dhe ligjeve të Tij-quhet pejgamber. Edhe imamati (1) edhe pejgamberllëku-ka mundësi të jenë të njëkohësishme (të gjenden përnjëherë) tek një individ, apo edhe veç e veç (të ndara).

- Argumenti i dhënë më parë, i cili tregon pagabueshmërinë e pejgamberit, gjithashtu tregon edhe për pagabueshmërinë e imamatit, ngase All-llahu xh.sh duhet ta mbrojë fenë e Tij të vërtetë të paprekur, kështu që, në këtë mënyrë të mundet të prezentohet përpara gjinisë njerëzore-në të gjitha kohërat. Kurse kjo nuk është e mundur pa pagabueshmëri, d.m.th pa mbrojtjen e Zotit nga devijimi.

## DALLIMI MIDIS PEJGAMBERIT DHE IMAMIT

- Argumenti i mësipërm mbi pranimin e urdhërave dhe ligjeve të Zotit nga ana e pejgamberit, vetëm që e tregon bazën e pejgamberllëkut, konkretisht pranimin e urdhërave të Zotit. Argumenti nuk e tregon gjatësinë dhe kontinuitetin e pejgamberllëkut, edhe pse është i pakontestueshëm fakti se urdhëresat e ruajtura pejgamberike, natyrshëm ngrenë idenë e qëndrueshmërisë dhe kontinuitetin e pejgamberllëkut.
- Ky është shkaku që nuk është çdo herë e domosdoshme që pejgamberi të jetë i pranishëm në mesin e njerëzve, mirëpo ekzistenca e përhershme e imamatit, i cili është mbrojtës i fesë së All-llahut xh.sh, është e kundërta e tij, d.m.th i domosdoshëm për shoqërinë njerëzore.

(1) Vërejtje e Sejjid Husein Nasrit: «Kuptohet, që në këtë domethënie, Imameti i atribuohet veçanërisht të kuptuarit shiit të Imamatit, e jo në kuptimin e përgjithshëm të përdorimit të këtij termi në proviniencën sunnite, e cila në të shumtën e rasteve ka të njëjtin kuptim siç ka edhe nocioni halif ».

Shoqëria njerëzore kurrë nuk mund të ngelet pa personalitet të cilin shiizmi e quan imam, qoftë ky i pranuar apo i papranuar apo i njohur. I Lartëmadhëruari thotë në Librin e Tij:

- ... e nëse këta e refuzojnë këtë, Ne e kemi siguruar këtë me një popull që nuk e refuzon.” ( El-En’amë, 89) (1)
- Ashtu edhe siç u përmend, funksionet pejgamberllëk dhe imamat mund të jenë të unjësuar në një personalitet i cili është i obliguar me të dy këto funksione, d.m.th pejgamber dhe imam, si dhe për pranimin e Ligjit të Zotit, dhe ruajtjen e tij dhe shpjegimin. Ndërsa ndonjëherë këto funksione mund të jenë të ndara, siç është në periudhat kur nuk ka më pejgamber të gjallë, atëherë imami i vërtetë është gjallë dhe në mesin e njerëzve. Kuptohet që numri i pejgamberëve të All-llahut xh.sh është i kufizuar dhe pejgamberët nuk kanë qenë të pranishëm në çdo periudhë apo kohë.
- Gjithashtu, është me rëndësi të vërehet se në Librin e All-llahut (Kur’anin) disa pejgamberë janë prezentuar edhe si imamë-ashtu siç fjala vjen për Pejgamberin Ibrahim a.s-për të cilin thuhet:
  - “ Përkujto (o i Dërguar) kur Zoti i Vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato, e Ai i tha: “Unë po të bëj ty prijës (imam) të njerëzimit!” Ai tha: “ (bën o Zot) Edhe nga pasardhësit e mi! “ (Zoti) tha: “Mirësinë Time nuk mund ta gëzojnë mizorët!” (El-Bekare, 124).
  - Dhe All-llahu gjithashtu thotë: “ Dhe ata i bëmë shembëlltyrë që udhëzonin sipas urdhërit Tonë...” (El-Enbija, 73)

(1) Vërejtje e Sejjid Husein Nasrit: » Përkthimi i këtij ajeti është marrë prej J.Arbery, « Komentimi i Kur’anit », Londër, 1964, i cili dallon nga ai i Marmaduk Piktolit-të dy këto përkthime janë në anglishte ».

## IMAMETI DHE ROLI I TIJ NË BRENDINË E DIMENSIONIT TË FESË

- Në të njëjtën mënyrë ashtu siç është imami mbrojtës dhe prijës i njerëzve në veprimtaritë e tyre të jashtme, ai, gjithashtu posedon edhe funksionin e brendshëm dhe udhëheqjen ezoterike dhe udhëzuese. Ai është udhëheqës i karvanit të njerëzve, të cilët në planin e brendshëm dhe ezoterik sillen rreth Zotit. Për t'u sqaruar kjo e vërtetë, është më se e domosdoshme t'i kushtohet vëmendja dy komentimeve hyrëse në vijim:

- Para së gjithash, pa asnjë farë dyshimi, jo vetëm sipas Islamit, por edhe sipas religjioneve tjera qiellore, njëshmëria e domethënies së arritjes së lumturisë së vërtetë dhe të përhershme, ose të skamjes, mirëqenies apo tundimit, është në përputhje me veprat e mira apo të këqija-nëpërmjet udhëzimit të fesë së All-llahut xh.sh, si dhe nëpërmjet natyrës vetanake, inteligjencës dhe asaj të dhënë prej vetë Zotit.

- Kurse e dyta: nëpërmjet domethënies së Shpalljes dhe pejgamberllëkut, Zoti i lavdëroi njerëzit apo gjykoj veprat e tyre njerëzore, me anë të gjuhës së qenieve njerëzore dhe shoqërive ku ata jetonin. Ai, u premtoi atyre të cilët bëjnë vepra të mira dhe i pranojnë mësimet e Shpalljes, jetë të lumtur dhe të amshueshme, në të cilën do t'u plotësohen të gjitha dëshirat të cilat janë në pajtim me përsosshmërinë njerëzore. Ndërsa atyre që bëjnë vepra të këqija dhe janë të padrejtë, All-llahu xh.sh u ka përgatitur jetë të skajshme të hidhur, në të cilën janë të manifestuara të gjitha format e të këqijave dhe pikëllimit.

- Pa asnjë farë dyshimi All-llahu, i Cili në çdo mënyrë qoftë, qëndron mbi atë çka mundemi ta paramendojmë ne, nuk posedon « mendim » të manifestuar me ndonjë strukturë të caktuar shoqërore. Raportet mes zotëriut dhe shërbëtorit, sundimtarit dhe të sunduarit, urdhërit dhe ndalimit, shpërblimit dhe dënimit- nuk ekzistojnë jashta jetës sonë shoqërore. Urdhëresat e Zotit nga vetvetja janë sistem i vetë të krijuarit, në të cilin ekzistimi dhe shfaqja e gjithçkaje janë të lidhura ekskluzivisht me krijimin e tij nga ana e Zotit, konform raporteve të vërteta dhe të ngjashmet me to. Më tutje, ashtu siç është përmendur në Kur'anin Fisnik (1) dhe hadithin e Pejgamberit s.a.v.s, feja përmban të vërteta dhe fakte të cilat janë mbi të kuptuarit e njeriut mesatar, e të cilat neve na i ka shpallur All-llahu xh.sh me gjuhën që ne e kuptojmë, d.m.th në nivelin e të kuptuarit tonë.

- Sipas kësaj, mund të konkludojmë se ekziston raport i vërtetë ndërmjet veprave të mira dhe të këqija dhe llojit të jetës e cila është e përgatitur për njeriun në amshueshmëri, raport i cili përcakton lumturinë, apo mizerjen e jetës së ardhshme, sipas vullnetit të Zotit, apo thënë më thjeshtë: Çdo vepër e miër apo e keqe, e cila lën gjurmë të vërteta në shpirtin e njeriut, e përcakton karaktertin e jetës së ardhshme-ahiretit. Qoftë ai ta kuptojë atë apo mos ta kuptojë, ngase njeriu është sikur fëmia i cili mësohet nga udhëzimet e mësuesit, fëmia nuk dëgjon asgjë veç urdhërit bërë ose mos e bën, por, ai megjithatë nuk i kupton domethëniet e veprave të cilat i kryen. Mirëpo, kur rritet, si rezultat i shprehive të pastra shpirtërore të cilat duke i mësuar i ka formësuar në vetvete ai është në gjendje të jetojë jetë të lumtur shoqërore. Kurse, nëse refuzon t'u nënshtrohet mësimëve të mësuesit, nuk do të fitojë, gjë tjetër pos varfëri dhe jokënaqësi përkatësisht vuajtje. Ai është sikur ndonjë person i sëmurë, i cili kur gjendet nën përkujdesjen e mjekut, dhe si rrjedhojë atij nuk i mbetet rrugëdalje tjetër pos t'i ndjekë udhëzimet e mjekut të tij. Rezultati i nënshtimit të tij ndaj rekomandimeve të mjekut është krijimi i harmonisë së organizmit i cili është burim i shëndetit dhe kënaqësisë shpirtërore dhe fizike. Shkurt mund të themi se në këtë jetë të jashtme, njeriu ka edhe jetën e brendshme, jetën shpirtërore e cila është e lidhur me



veprat e tija dhe fushëveprimin, si dhe zhvillon lidhjen mes tyre, dhe se lumturia apo jolumturia në atë botë, plotësisht varen nga jeta e tij e brendshme.

- Gjithashtu edhe Kur'ani Fisnik e vërteton këtë shpjegim. (2). Në shumë ajete ai pohon ekzistimin e jetës tjetër dhe shpirtit për ata të ndershmit dhe takvatë (të devotshmit), një jetë më të lartësuar se kjo jetë dhe një shpirt më të pastër se sa shpirti i njeriut të cilin ne e njohim këtu dhe tani. Ai tregon se veprat e njeriut kanë efekte të brendshme në shpirtin e tij i cili gjithnjë mbetet me të. Në thëniet e Pejgamberit s.a.v.s gjithashtu ekzistojnë shumë tregues për këtë. Në hadithin e Miraxhit (udhëtimit qiellor) All-llahu xh.sh i drejtohet Pejgamberit të Tij me këto fjalë: » Ai që dëshiron të veprojë asisoi që Unë të jem i kënaqur, duhet t'i posedojë tri cilësi: ai duhet të shprehë falënderimin, i cili nuk është i përzier me padituri; kujtimin në të cilin nuk guxon të bie hija e harresës, dhe dashuria e cila nuk guxon të mbisundojë ndaj krijesave të Mia më shumë se sa ndaj Meje. Nëse robi më don Mua, atëherë edhe Unë e dua atë, Unë do t'ia hap sytë e zemrës së tij nëpërmjet të të pamurit nga Madhështia Ime dhe nuk do t'i mbrojë prej tij të zgjedhurit e Mi nga krijesat e Mia. Unë do të kem besim ndaj tij në errësirë e thellë të natës dhe në shkëlqimin e ditës derisa bisedimi dhe të drejtuarit e krijesës nuk mbaron. Do t'ia bëj që ta dëgjojë fjalën Time dhe fjalën e melakve të Mi. Unë do t'ia kumtoj sekretin (të fshehtë) të cilën e kam fshehur prej krijesave të Mia. Do ta mbuloj me rrobat e dliresisë prej të cilave do të turpërohen krijesat. Do të ec nëpër tokë dhe do të jetë i falur. Do ta bëj që zemra e tij të posedojë vetëdije dhe njohuri të shkathta. Unë nga ai nuk do të fshehi asgjë që ndodhet në Xhennet dhe Xhehennem. Do t'ia bëj të ketë dije për gjithçka që njerëzit do të përjetojnë në Ditën e Gjykimit qoftë kjo frikë apo pikëllim.» (3)

(1) P.sh “Ha’Mim; Pasha Librin (Kur’anin) sqarues! S’ka dyshim se Ne e bëmë atë Kur’an arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni. Dhe se në librin amzë (Levhi-Mahfudh) te Ne, gëzon famë të larët dhe është plotë urtësi.” (Ez-Zuhruf, 1-4).

(2) “E do të vijë secili njeri e bashkë me të edhe grahësi edhe dëshmitari! (I Thuhet) “Ti ishe në një huti nga kjo (ditë) e Ne ta hoqëm perden tënde dhe tash ti sheh shumë mprehtë” (Kaf, 21-22) “Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull apo femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim një jetë të mirë...” (En-Nahl, 97); “O ju që besuat, përgjigjuni (thirrjes) së All-llahut dhe të Dërguarit kur ai (I Dërguari) ju ftonë që ju jep jetë, (për fenë e drejtë)” (El-Enfalë, 24); “Ditën kur çdo njeri e gjen pranë vete atë që veproi mirë ose keq...” (Ali-Imran, 30); “Vërtet, Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shkruajmë veprat, gjurmët e tyre dhe çdo gjë kemi regjistruar në librin e ruajtur (Levhi-Mahfudh)” (Jasin, 12).

(3) “Biharul-Envar” vëllimi 17, f. 9

- Ebu Abdullahu, shpëtimi qoftë mbi të! transmeton se Pejgamberi s.a.v.s e pranoi një ditë Harith ibn Malik ibn Al-Nu'manin dhe e pyeti: Si je o Harith? Ai u përgjigj: O i Dërguar i All-llahut, unë jetoj si besimtar i vërtetë,” Pejgamberi s.a.v.s i tha: “Çdo gjë ka të vërtetën e vet. Cila është e vërteta e fjalëve të tua?” Ai i tha: “O i Dërguari i Zotit! Shpirti im është larguar nga kjo botë. Netët e mia kalojnë zgjuar, kurse ditët e mia në gjendje të pikëllimit. Dhe më duket se shoh Fronin (Arshin) e Zotit tim, dhe se llogaria është duke u bërë, si dhe më bëhet se i shohë njerëzit e Xhennetit duke e vizituar njëri-tjetrin, kurse dëgjoj vajtimin e njerëzve të Xhehennemit në zjarr” Më pas Resulull-llahu s.a.v.s tha: “Ky është rob, zemrën e të cilit e ka ndriçuar All-llahu”. (1)

- Gjithashtu, duhet patur parasysh se shpeshherë njëri prej nesh e çon tjetrin në vepra të mira apo të këqija, pa marrë në konsiderim shprehjen e fjalëve të tij personale. Ashtu, siç është rasti me të Dërguarin dhe Imamin, udhëheqja dhe roli prijës i të cilëve caktohet me urdhërin e Zotit, por nuk ndodh rëndom edhe kështu... Ata vetë e praktikojnë fenë-udhëheqjen e së cilës e kanë marrë. Jeta shpirtërore, sipas së cilës ata e udhëheqin gjininë njerëzore-është vetë jeta e tyre personale shpirtërore.

(2)

- Nga kjo aq sa diskutuam më sipër, mund të vijmë në përfundimet vijuese:

- 1). Në çdo bashkësi fetare pejgamberët dhe imamët janë më të shquarit në aspektin e përsosshmërisë dhe arrijen e jetës shpirtërore dhe fetare të lartë të cilën edhe e propagojnë, ngase ata i praktikojnë dhe duhet t'i ndjekin vetë mësimet e tyre dhe marrin pjesë në jetën shpirtërore të cilën ata vetë e predikojnë.

- 2). Meqë ata janë të parët në mesin e njerëzve, si dhe prijës dhe mbrojtës të bashkësisë, ata janë njerëzit më të ndershëm dhe më të përsosur.

- 3). Personi mbi shpatullat e të cilit qëndon përgjegjësia e udhëheqjes së bashkësisë, ashtu siç është udhëheqës i veprave dhe jetës së jashtme, gjithashtu është edhe udhëheqës i jetës shpirtërore, kurse dimensionin e jashtëm i jetës njerëzore dhe praktika fetare varen nga udhëheqja e tij. (3)

(1) “El- Vafi” nga Mulla Muhsin Feid Kashani, Teheran, 1310-14, vëllimi 3; f. 33

(2) “... Thuaj: “ Vetëm All-llahu udhëzon në të vërtetën. Atëherë pra, a është më e drejtë të shkohet pas atij që udhëzon në rrugë të drejtë, apo pas atij që nuk udhëzon, (sepse nuk mund ta udhëzojë as vetveten) vetëm nëse prej dikuj tjetër udhëzohet? Ç’është me ju? Si gjykoni?” (Jasin, 35)

(3) “ Dhe ata i bëmë shembëlltyrë që udhëzonin sipas urdhërit Tonë, i orientuam në punë të mira...” (El-Enbija, 73) “ Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhërin Tonë udhëzojnë, pasi që ata (që i bëmë prijës) ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur.” (Es-Sexhde, 24) Dikush nga kjo mund të vie në përfundim se përveç posedimit të rolit publik prej prijësi dhe këshilltari, Imami-gjithashtu posedon edhe një lloj të fuqisë shpirtërore, e afërt me botën shpirtërore-të ftojë dhe të tërheq njerëzit. Ai vepron dhe plotësisht i përfiton zemrat e njerëzve, përmes rrugës së të vërtetës, dritës, dhe aspektit të brendshëm të qenies së vet, si dhe në këtë mënyrë drejtojnë kah përsosshmëria dhe qëllimi madhor i vetë ekzistimit.

## IMAMËT DHE PRIJËSIT E ISLAMIT

- Diskutimi i mësipërm na sjell deri tek përfundimi se në Islam, pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s, gjithnjë ka ekzistuar dhe do të vazhdojë të ekzistojë në bashkësinë islame (ummet) imami (prijësi i zgjedhur nga Zoti). Në shiizëm transmetohen një numër i madh hadithesh të Pejgamberit s.a.v.s (1) të cilët flasin mbi përshkrimin e imamit, numrin e tyre, faktin se të gjithë janë Kurejshitë dhe se janë nga Familja e Pejgamberit s.a.v.s, si dhe faktin se Mehdiu i Premtuar është në mesin e tyre dhe njëherit është edhe i fundit.

- Gjithashtu, këto janë fjalë të qarta të të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s që flasin mbi imametin e Aliut dhe vendin e tij si imam i parë si dhe deklaratat konkrete të Pejgamberit s.a.v.s dhe Aliut, në lidhje me imametin e imamit të dytë. Në të njëjtën mënyrë, Imamët para shpërnguljes së tyre për në ahiret, lenin udhëzime të qarta në lidhje me imametin e atyre të cilët do të vijnin pas tyre. (2)

- Duke u bazuar në thëniet e vërtetuara, të përmbledhura në burimet e shiitëve duodecimalë (ithna-asherijje), imamë gjithsej ka dymbëdhjetë, kurse emrat e tyre të ndershëm janë:

1. Ali Ibn Ebu Talibi,
2. Hasan Ibn Ali,
3. Husejna Ibn Ali,
4. Ali Ibn Husejn,
5. Muhammed Ibn Ali,
6. Xhafer Ibn Muhammed,
7. Musa Ibn Xhafer,
8. Ali Ibn Musa,
9. Muhammed Ibn Ali,
10. Ali Ibn Muhammed,
11. Hasan Ibn Ali, dhe
12. Mehdi

(1) Xhabir Ibn Samure thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin s.a.v.s duke thënë: “Gjersa të ekzistojnë 12 halifë kjo fe do të jetë e fuqishme”, Xhabiri thotë: “Njerëzit bëritën “All-Ilahu Ekber” dhe filluan të qajnë, pastaj Pejgamberi s.a.v.s tha diç me zë të ulur. Xhabiri e pyeti babain e vet: “O baba, çfarë tha? Kurse babai iu përgjigj: “Të gjithë halifët do të jenë kurejshitë”, Sahihu i Ebu Davudit, Kajro 1348, vëllimi 2 f. 207 “Musnedi” i Ahmed Ibn Hanbelit, vëllimi 5 f. 92. Ekzistojnë gjithashtu edhe disa hadithe të tjera të ngjashëm me këtë. Selman Farisiu thotë: “Erdha te Pejgamberi s.a.v.s dhe e pashë Husejnin në prehrin e tij, të cilit Pejgamberi s.a.v.s ia puthte buzët dhe sytë, duke i thënë: “Vërtet je njeri fisnik, bir i njeriut fisnik, Imam, djalë i Imamit, Huxh-xhet, bir i huxh-xhetit, baba i nëntë huxh-xhetëve nga të cilët i nënti prej tyre është mbështetje (Kaim)”, Xhenabiul-Mevada, f. 308.

(2) Shih: “El-Gadir”, “Gajatul-Meram”, “Isbel-Hudaf” nga Muhammed Ibn Hasan Hurr El-Amili, Kum-Teheran, 1285; “Xhenabiul-Mevedde”, “El-Fususul-Muhimme”, “Delailul-Imame” nga Muhammed Ibn Xherir Et-Taberi, Nexhef, 1369 “En-Nass vel-xhihad”, nga Sherefuddin Musavi, 1375; “Usulul-Kafi”, vëllimi 1 dhe “Kitabul-Ershad” nga Shejh Mufidi, Teheran, 1377.

### *Imami i dymbëdhjetë*

Mahdiu i premtuar, i cili zakonisht zihet ngoje me titullin e tij Imam-i Asr (Imam i kohës) dhe Sahib al-Zaman, është i biri i Imamit të njëmbëdhjetë. Emrin e ka të njëjtë me atë të Pejgamberit të Shenjtë. Ai u lind në Samarra më 256/868 dhe deri më 260/872, kur u martirizua babai i tij, jetonte nën kujdesin dhe tutelën e të atit. Ai fshihej të mos e shihnin haptas dhe vetëm disa veta nga elita e shiitëve qenë në gjendje ta njihnin.

Pas martirizimit të babait ai u bë imam dhe me Urdhrin Hyjnor shkoi në fshehtësi ((*ghajbiat*). Kështu ai u paraqitej vetëm ndihmësve të tij (*naib*) po edhe atëherë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.<sup>98</sup>

Imami si zëvendës të tij e zgjodhi për një kohë Uthman ibn Said Umarin, njërin nga shokët e babait dhe të gjyshërve të tij i cili ishte mik i tij i besueshëm dhe besnik. Përmes zëvendësit të tij Imami u përgjigjej kërkesave dhe pyetjeve të shiitëve. Pas Uthman ibn Saidit, zëvendës i Imamit u emërua i biri i tij Muhamed ibn Uthman Umari.

Pas vdekjes së Muhamed ibn Osmanit, Abul Kasim Husein ibn Ruh Navbakhti ishte zëvendës i posaçëm, dhe pas vdekjes së tij në këtë detyrë ishte zgjedhur Muhamed Simari.<sup>99</sup>

Disa ditë para vdekjes së Ali ibn Muhamed Simarit në vitin 329/939, u lëshua një urdhër nga Imami duke thënë se brenda gjashtë ditëve do të vdiste Ali ibën Muhamed Simari. Prej këtu zëvendësimi special i imamit do të merrte fund dhe do të fillonte fshehtësia kryesore (*ghajbiat-i kubra*) dhe do të zgjasë deri në ditën kur Zoti do t'i japë leje Imamit të shfaqet.

Fshehtësia e Imamit të dymbëdhjetë, pra, ndahet në dy pjesë: e para, fshehtësia e vogël (*ghajbiat-i sughra*) e cila filloi më 260/872 dhe mori fund 329/939, duke zgjatur rreth shtatëdhjetë vjet; pjesa e dytë, fshehtësia kryesore e cila filloi më 329/939 dhe do të zgjasë sa të dojë Zoti. Në një hadith mbi autenticitetin e të cilit pajtohet secili, Pejgamberi i Shenjtë ka thanë: “Po të duhej të mbetej në jetën e kësaj bote vetëm një ditë, Zoti do ta zgjaste atë ditë derisa Ai të dërgojë në të një njeri nga komuniteti dhe familja ime. Emri i tij do të jetë i njëjtë me timin. Ai do ta mbushë botën me barazi dhe drejtësi ashtu siç ishte mbushur me dhunë dhe tirani.”<sup>100</sup>

### *Mbi paraqitjen e Mahdiut*

Në bisedën mbi pejgamberinë dhe imamllëkun u tha se si rezultat i ligjit të udhëzimit të përgjithshëm i cili e drejton gjithë krijimin, njeriut me doemos i është dhuruar fuqia e marrjes së shpalljes përmjet pejgamberisë, e cila e drejton atë drejt përsosjes së normës njerëzore dhe mirëqenies së racës njerëzore. Pa dyshim, po të mos ishin të mundshme përsosja dhe lumturia për njeriun, jeta e të cilit posedon aspekt shoqëror, vetë fakti se atij i është dhuruar kjo fuqi do të ishte e pakuptimtë dhe e kotë. Por në krijim nuk ka kotësi.

Me fjalë të tjera, qyshse ka filluar të banojë në tokë, njeriu ka dashur të bëjë jetë shoqërore të mbushur me lumturi në kuptimin e vërtetë dhe është përpjekur drejt këtij qëllimi. Po të mos ekzistonte objektivi i një dëshirë e tillë, ajo kurr nuk do të ishte ngulur në natyrën e brendshme të njeriut, njësoj sikur po të mos kishte pasur ushqim nuk do të kishte pasur as uri. Ose po të mos kishte pasur ujë nuk do të kishte pasur as etje dhe po të mos kishte pasur riprodhim nuk do të kishte pasur tërheqje seksuale midis gjinive.

Prandaj, me arsyen e nevojës dhe vendosjes së brendshme, e ardhmja do të shohë dritën kur shoqëria njerëzore do të jetë e ngopur me drejtësi dhe kur të gjithë do të jetojnë në paqe dhe qetësi, kur qeniet njerëzore do të posedojnë virtyt dhe përsosje. Vendosja e kushteve të tilla do të paraqitet përmes duarve të njeriut por me ndihmën e Hyjnisë. Kurse udhëheqësi i një shoqërie të tillë, i cili do të jetë shpëtimtari i njeriut, në gjuhën e hadithit quhet Mehdi.

Në religjione të ndryshme që mbretërojnë botën, si hinduizmi, budizmi, judaizmi, zoroastrianizmi edhe islami i referohet një personi i cili do të vijë si shpëtimtar i njerëzimit. Këto religjione zakonisht kanë dhënë lajme të reja të ardhjes së tij, ndonëse natyrisht janë disa dallime në hollësi të cilat mund të shquhen kur të krahasohen këto mësimet me kujdes. Hadithi i Pejgamberit të Shenjtë me të cilin pajtohen të gjithë muslimanët: “Mahdiu është nga pasardhësit e mi” i referohet së njëjtës të vërtetë.

Ka shumë hadithe që zihen nga burimet sunnite dhe shiite nga Pejgamberi i Shenjtë dhe nga imamët që kanë të bëjnë me paraqitjen e Mahdiut, si ai që thotë se ai ka prejardhjen e Pejgamberit dhe se paraqitja e tij do t'ia bëjë shoqërisë njerëzore të mundshme të arrijë përsosje të vërtetë dhe kuptimin e plotë të jetës shpirtërore.<sup>101</sup> Përveç kësaj, ka shumë tradita të tjera lidhur me faktin se Mahdiu është i biri i Imamit të

njëmbëdhjetë, Hasan al-Askerit. Ata pajtohen se pasi të lindet dhe pasi të kalojë një kohë të gjatë në fshehtësi Mahdiu do të paraqitet përsëri, duke e mbushur me drejtësi botën e cila është prishur nga padrejtësia dhe poshtërsia.

Si shembull, Ali ibën Musa al-Ridai (Imami i tetë) ka thënë në rrjedhë të hadithit: “Imami pas meje është biri im, Muhamedi, dhe pas tij i biri i tij, Aliu, dhe pas Aliut i biri i tij, Hasani, dhe pas Hasanit Huxhat al-Kaimi, i cili pritet gjatë fshehtësisë dhe dëgjohej gjatë shfaqjes së tij. Nëse mbetet nga jeta e kësaj bote vetëm një ditë, All-llahu do ta zgjasë atë ditë derisa ai të shfaqet, dhe ta mbushë botën me drejtësi njësoj sikur që ishte mbushur me poshtërsi. Por kur? Sa i përket lajmit të “orës”, vërtet babai më ka treguar, se kishte dëgjuar nga babai i tij i cili kishte dëgjuar nga babai i tij i cili kishte dëgjuar prej të parëve të tij të cilët kishin dëgjuar nga Aliu, që ishte kërkuar nga Pejgamberi i Shenjtë: ‘O Pejgamber i Zotit, kur do të duket “përkrahësi” (*kaim*) i cili është nga familja jote?’ Ai tha: ‘Rasti i tij është sikur ai i Orës (së Ringjalljes). “Ai vetë do të shfaqë atë në kohën e duhur. Ajo është e rëndë në botën hyjnore dhe në këtë botë. Ajo nuk ju vjen juve për të pavetëdijshmit” (Kur’ani, VII, 187).’”<sup>102</sup>

Sakr ibën Abi Dulaf ka thënë: “Kam dëgjuar nga Abu Xhafar Muhamed ibën Ali al-Ridai (Imami i nëntë) i cili tha: ‘Imami pas meje është im bir, Aliu; urdhëri i tij është urdhëri im; fjala e tij është fjala ime; të dëgjosh atë është sikur të më dëgjosh mua. Imami pas tij është i biri i tij, Hasani. Urdhëri i tij është urdhëri i babait të tij; fjala e tij është fjala e babait të tij; të dëgjosh atë është sikur të dëgjosh babain e tij.’ Pas këtyre fjalëve Imami mbeti i heshtur. Unë i thashë: ‘O bir i Pejgamberit, kush do të jetë imam pas Hasanit?’ Imami bërtiti fort, pastaj tha: ‘Vërtet pas Hasanit i biri i tij është imami që pritet i cili është “al-ka’im bi’l-hakk” (ai që përkrahët nga e vërteta).’”<sup>103</sup>

Musa ibën Xhafar Baghdati ka thënë: “Kam dëgjuar nga Imam Abu Muhamed al-Hasan ibën Aliu [Imami i njëmbëdhjetë] i cili tha: ‘Shoh se pas meje do të paraqiten dallime mes jush lidhur me imamin pas meje. Kushdo që pranon imam pas Pejgamberit të Zotit, por e mohon djalin tim, është njësoj sikur ai që pranon të gjithë pejgamberët, por e mohon pejgamberinë e Muhammedit, Pejgamberit të Zotit, paqja dhe bekimi qofshin mbi të. Dhe kushdo që e mohon [Muhammedin] si Pejgamber të Zotit është sikur ai që ka mohuar të gjithë pejgamberët e Zotit, sepse të dëgjosh të fundit nga ne është sikur të dëgjosh të parin, kurse të mohosh të fundit nga ne është sikur të mohosh të parin. Por kij kujdes! Vërtet për birin tim është një kohë e fshehtësisë gjatë së cilës të gjithë njerëzit do të bijnë në dyshim përveç atyre të cilët i mbron Allahu.’”<sup>104</sup>

Kundërshtarët e shiizmit protestojnë se sipas besimit të kësaj shkolle Imami i Fshehtë duhet të jetë plakur deri tani dymbëdhjetë shekuj, kurse kjo është e pamundshme për çdo qenie njerëzore. Si përgjigje duhet të thuhet se kundërshtimi mbështetet vetëm në mungesën e gjasës për një paraqitje të tillë dhe jo për pamundësinë e saj. Natyrisht, një jetë e tillë e gjatë ose një jetë e një periudhe më të gjatë duket pa gjasa. Por, ata që studiojnë hadithet e Pejgamberit të Shenjtë dhe të imamëve do të shohin se ata i referohen kësaj jete si diçka që posedon cilësi të mrekullueshme. Mrekullitë vërtet janë të pamundshme, por as që mund të mohohen me argumente shkencore. Kurrë nuk mund të provohet se shkaqet dhe faktorët veprues që po funksionojnë në këtë botë janë vetëm ata që i dimë dhe i njohim dhe se shkaqe të tjera të cilat nuk i njohim ose efektet dhe veprimet e të cilave nuk i kemi parë as kuptuar nuk ekzistojnë. Në këtë mënyrë është e mundshme se në njërin ose në disa anëtarë të njerëzimit mund të veprojnë disa shkaqe dhe faktorë veprues të cilët ua dhurojnë një jetë shumë të gjatë të mija ose të disa mija vjetve. Mjekësia madje as që ka humbur shpresën për të zbuluar mënyrën për të arritur jetë shumë të gjatë. Sido që të jetë, kundërshtime të tilla nga “njerëzit e Librit” siç janë izraelitët, të krishterët dhe muslimanët janë më të

çuditshmet, sepse ata pranojnë merkullitë e pejgamberëve të Zotit sipas vetë shkrimeve të shenjta të tyre.

Kundërshtarët e shiizmit po ashtu kundërshtojnë, se ndonëse shiizmi i konsideron imamët si të domosdoshëm për të shpjeguar urdhërat dhe të vërtetat e religjionit dhe për të udhëzuar njerëzit, fshehtësia e imamëve është mohimi i vetë këtij qëllimi, sepse imami në fshehtësi të cilin nuk mund ta arrijnë njerëzit kurrsesi nuk mund të jetë i dobishëm as efektiv. Kundërshtarët thonë se nëse Zoti dëshiron të sjellë një imam për të reformuar njerëzimin, Ai është në gjendje ta krijojë në çastin e domosdoshëm dhe nuk ka nevojë ta krijojë atë me mija vjet përpara. Si përgjigje duhet të thuhet se njerëzit e tillë nuk e kanë kuptuar vërtet domethënien e imamit, sepse në bisedën mbi imamllekun u bë e qartë se detyra e imamit nuk është shpjegimi formal i shkencave të religjionit dhe i udhëzimeve të jashtme të njerëzve. Njësoj sikur që ka detyrë t'i udhëzojë njerëzit së jashtmi, imami po ashtu e ka detyrën e valajatit dhe të udhëzimit ezoterik të njerëzve. Është pikërisht ai i cili e drejton jetën shpirtërore të njeriut dhe e orienton aspektin e brendshëm të veprimit njerëzor drejt Zotit. Qartë, prania ose mungesa e tij fizike nuk ka kurrfarë efekti në këtë çështje. Imami i vështron njerëzit prej së brendshmi dhe është së bashku me shpirtin dhe frymën e njeriut qoftë edhe të jetë ai i fshehur nga pamja fizike. Ekzistenca e tij është gjithmonë e nevojshme qoftë edhe të mos ketë arritur ende koha për dukjen e tij së jashtmi dhe për rindërtimin universal që ai do të sjellë.

shëhid Muhammed Bakir Es-Sadër  
**IMAM MEHDIU**

*Bismil-lahir-rahmanir-rahim!*

*( Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit!)*

*“ E ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë,  
t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues”. (El-Kasas, 5).*

## HYRJJE

- Mehdiu nuk paraqet vetëm realizimin e besimit islam në aspektin shpirtëror, ai është edhe mënyrë e arritjes së synimit të veçantë për të cilën njerëzimi aspiro, si dhe formë e inspirimit natyror me ndihmën e të cilit njerëzit, përkundër besimeve të ndryshme dhe mënyrave të padukshme të afrimit arrijnë deri te njohuria se në tokë është caktuar dita kur Porositë e Zotit, në madhështinë dhe plotshmërinë e tyre do të përmbushen; kur pas luftës së gjatë dhe marshimit lodhës përgjatë gjithë historisë, njerëzimi do ta arrijë stabilitetin dhe sigurinë.
- Mirëpo, vetëdija për këtë ardhmëri të pritur, nuk është e kufizuar vetëm tek ata që besojnë në të padukshmen-nga pikëpamja fetare, por i përfshinë edhe të gjithë të tjerët, përfshinë edhe ideologjitë të cilat fuqishëm e kanë kundërshtuar ekzistimin e të padukshmes, apo cilësdo nga format e saja, siç është p.sh materializmi dialektik i cili historinë e komenton si lëvizje drejt kontrastit (të kundërtës, antitezës), por në fund megjithatë e pranon faktin se do të vijë koha kur të gjitha këto antagonizma do të zgjidhen, kurse paqja dhe harmonia do të mbisundojë në botë...
- Kështu që shohim se përvoja psikologjike e kësaj vetëdije, të cilën njerëzimi e ka fituar gjatë kohës, është njëra nga vetëdijet më të përhapura dhe më dominueset në mesin e njerëzve. D.m.th derisa feja e përforcon këtë vetëdije, duke e pohuar bindshëm, se më në fund-bota (toka) do të jetë e mbushur me drejtësi, pas periudhës së gjatë të padrejtësisë dhe dhunës, ajo (feja) në të vërtetë, asaj vetëdijeje i siguron vlerën e vërtetë duke e shndërruar në besim të fuqishëm në fatin e njerëzimit, që nuk është vetëm burim i ngushëllimit, por edhe burim i zemërgjerësisë dhe forcës.
- Besimi në zemërgjerësi është burim i fuqisë, sepse besimi në Mehdiun, në të vërtetë, d.m.th është besim në luftën kundër të gjitha llojeve të shtypjeve dhe dhunës, edhe pse ato (shtypja dhe dhuna) akoma mbisundojnë me këtë botë.
- Besimi në Mehdiun është gjithashtu burim i forcës e cila nuk shterret, ngase ajo është shenjë e dritës (shkëlqimit) e cila gjithnjë lufton kundër pikëllimit njerëzor, ajo e mban ndezur fllakdanin e shpresës në zemrat e tyre, përkundër vështirësive dhe shtypjeve të cilave u ekspozohen gjatë jetës. Ardhja e ditës së caktuar e vërteton faktin se drejtësia është në gjendje ta sfidojë botën e mbushur me tirani dhe mëkate, t'i shkundë themelet e saja dhe nga fillimi (nga e para) ta ndërtojë. Shtypja nga vetë vetvetja është gjendje jo e natyrshme, pa marrë parasysh intenzitetin e fuqisë së saj dhe shkallën, përkatësisht përmasat e saja në pjesët e ndryshme të botës, dhe ajo në fund me siguri që do të pësojë disfatë. Kjo disfatë në kulmin e fuqisë së saj-jep shpresë të madhe në arritjen e baraspeshës dhe ndërtimin e sërishëm të rendit në botë, për secilin individ të shtypur dhe popull të diskriminuar.
- Edhe pse ideja mbi Mehdiun është më e vjetër se Islami, përpunimet islame detajisht të kësaj teme, i kanë kënaqur të gjitha përpjekjet të cilat kanë qenë të drejtuara kah realizimi i saj dhe paraqesin paralajmërim të besueshëm për ata, të cilët gjatë historisë kanë qenë të shtypur dhe të nënçmuar. Islami idenë e të padukshmes e kthen në realitet, kurse nga aspiratat për Shpëtimtarin, të cilin bota ka herë e aspironte dhe priste në një të ardhme të mugët, formoi besimin, se i njëjti në të vërtetë ekziston bashkë me të tjerët pa durim duke pritur ditën e caktuar, si dhe rrethanat të cilat do t'ia mundësojnë ta merr në duar rolin e tij të madh. Ndaj, Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!) nuk është më vetëm ide e cila duhet të realizohet, as profeci e cila duhet të ndodhë, por ajo është e vërtetë e gjallë (realitet) dhe person nga gjaku dhe mishi, i cili jeton midis nesh, ndanë shpresat tona, mynxyrat, pikëllimin dhe gëzimin, në fakt ai është dëshmitar i të gjitha vuajtjeve, të zinjve të ullirit dhe mëkateve që ekzistojnë në sipërfaqe të tokës. Ai të gjitha këto i ndjenë dhe pret momentin e duhur në të cilin do



të zgjaten duart e tij kah çdo i shtypur dhe i përvuajtur, si dhe t'i shkatërrojë zullumqarët.

- Mirëpo, është përcaktuar që ky Prijës të tjerëve nuk guxon t'u shpalos asgjë nga jeta dhe personaliteti i tij, edhe pse jeton në mesin e tyre, derisa të vijë dita e caktuar, të cilën është duke e pritur.

- S'do mend se mendimi, i cili është në përputhje me këto përkufizime islame, e ngushton jazin e të padukshmes mes të shtypurve dhe Shpëtimtarit të pritur, si dhe e zvogëlon distancën psikike mes tyre, pa marrë parasysh se sa do të mund të zgjasë pritja...

- D.m.th kur nga ne pritet që të mendojmë mbi Mehdiun si person të gjallë, i cili është bashkë me ne dëshmitar i ndodhive, atëherë, duhet të na frymëzojë fakti se ideja për revoltën e pakompromistë kundër çdo lloj gabimi dhe vuajtjeje, e cila gjendet te Mehdiu, veçmë është realizuar në prijësin e fshehur dhe të pritur, ashtu siç është përmendur edhe në hadith. Gjithashtu me besimin në të, në të vërtetë, ne besojmë në protestën e paluhatshme dhe aktive kundër dhunës dhe marrim pjesë në të.

- Vërtet, shumë hadithe gjithnjë i përkujtojnë ata që besojnë në Mehdiun-që të presin lirim nga vuajtjet dhe të jenë të përgatitur për ardhjen e tij-gjë e cila e forcon lidhjen e tyre shpirtërore dhe emotive me prijësin e fshehur të personifikuar me të gjitha mirësitë që shfaq, gjë që qartë na e bëjnë me dije se ai në të vërtetë edhe nuk mundet të mos ekzistojë.

- Kështu që vërejmë se realizimi i kësaj ideje në protestën e pakompromis i ka dhënë shtytje të re ( idesë së Mehdiut, vërej e përkth) dhe e ka shndërruar në burim të forcës dhe zemërgjerësisë të shkallës më të lartë, në formën e ngushëllimit dhe lehtësimit-të cilën çdo person i shkelur e ndjen derisa është duke i përjetuar dhimbjet dhe vuajtjet nga ana e atyre që shtypin; duke e dijtur se Imami dhe udhëheqësi i veprave të ndjenjave të tij, nuk është “tjetër” dhe i “huaj” e as ide që duhet të realizohet, por, përkundrazi e ndjen se ai (Mehdiu) është edhe bashkëkohës i tij. Mirëpo, realizimi i asaj që u përmend më sipër, shumë nga ata që e kanë patur të vështirë të besojnë në të, i ka çuar të marrin qëndrim negativ, bile edhe ndaj vetë idesë mbi Mehdiun. Të gjithë ata pyeten a thua vallë ideja mbi Mehdiun asocon në person të gjallë i cili ka qenë bashkëkohës i të gjitha gjeneratave në periudhën prej dhjetë shekujve dhe i cili do të vazhdojë të jetojë derisa nuk vjen koha të shfaqet në sipërfaqe të tokës, si dhe si është e mundur që një qenie njerëzore të jetojë aq gjatë dhe t'i sfidojë të gjitha ligjet e natyrës sipas të cilave të gjithë ne plakemi dhe vdesim. A thua një gjë e këtillë nuk është e mundur të ekzistojë duke e parë nga ky këndvështrim?

- Përse All-llahu aq shumë ka dashur që atij personi të caktuar, për të cilin nuk vlejnjë ligjet e natyrës, t'ia zgjatë jetën dhe ta ruajë për ditën e caktuar? A thua njerëzimi është i paaftë që vetë të zgjedhë udhëheqës të aftë? Përse ajo “ditë e caktuar” nuk do të vijë me lindjen e prijësit, i cili si të gjithë njerëzit e tjerë do të rritet, dhe gradualisht do ta marrë rolin e tij-derisa bota, pas një periudhe të gjatë të padrejtësisë të mbushet me drejtësi.

- Ata, gjithashtu pyeten se a është emri Mehdi i zgjedhur për person të caktuar, përkatësisht djalin e imamit të njëmbëdhjetë prej Familjes së Pejgamberit s.a.v.s (Ehlul-Bejtit a.s), i cili është lindur në vitin 256 sipas hixhretit, kurse babai i të cilit ka vdekur në vitin 260 sipas hixhretit?! Kjo d.m.th se ai ka qenë shumë i ri kur i ka vdekur i ati, nuk kishte madje as 5 vjet, si dhe se për te, në atë moshë, ishte shumë herët që t'i merr përsipër arsimimin fetar, d.m.th marrjen e udhëheqjes nga i ati. Ndaj edhe shtrohet pyetja: si dhe në çfarë mënyre ai ka mundur të jetë i përgatitur për këtë rol të madh fetar, intelektual dhe shkencor?

- Aq më tepër, që nëse i Caktuari është gati, atëherë pse do të priste gjithë këto qindra vjet? A thua të gjitha zullumet dhe katastrofat shoqërore, për të cilat bota ka qenë dëshmitare, nuk janë argument i mjaftueshëm për ardhjen e tij, nëpërmjet të cilit do të vendosej drejtësia në botë? Gjithashtu e shtrojnë pyetjen: Si mundemi të besojmë në ekzistimin e tij, edhe në qoftë se do të supozonim se është e mundur? Mund që dikush ta pranojë një pohim të këtillë kur ajo nuk argumentohet, ta zëmë me ndonjë argument logjik apo shkencor? A thua mundet që disa hadithe të Pejgamberit s.a.v.s në autencitetin e të cilëve mund të ketë dyshime, janë të mjaftueshëm ta vërtetojnë këtë pohim?

- Shumë të tjerë, shkojnë më tej dhe pyeten në lidhje me rolin që ky person do të duhej ta lozte në “ditën e caktuar”, si është e mundur që individit të merr rol kaq të madh dhe vendimtar, kur e dijmë se, sado që dikush mund të jetë i aftë, ai nuk mund ta krijojë historinë, e as që ta drejtojë kah zhvillimi i ri, duke marrë parasysh se çdo embrion i cilësdo lëvizjeje historike zhvillohet në rrethana objektive dhe jep rezultate me bashkimin e tyre, kurse veçoritë e individit janë vetëm faktor i cili i shoqëron dhe u sjell zgjidhje të duhur?

- Ata pyeten: Si është e mundur të besojmë se ky person do të sjell ndryshime të mëdha dhe fitore kundër ekzistimit të padrejtësisë së madhe që mbretëron, vuajtjes dhe shtypjes, kur shtypësit posedojnë fuqi dhe ndikim? si dhe mjete për shkatërrim dhe standarde të larta shkencore, politike, shoqërore dhe ushtarake?

- Pyetje të këtilla shpesh-herë parashtrohen në forma të ndryshme. Mirëpo, ata në parim nuk kanë vetëm motive intelektuale, por edhe motive psikologjike të shprehura përmes frikës e cila dominon në botë, si dhe në mungesën e çfarëdo qoftë mundësie të ndryshimeve rrënjësore. Sa më shumë dyshimet thellohen, ndërsa numri i pyetjeve rritet aq më shumë mjerimi bëhet i vetëdijshëm për realitetin e hidhur i cili mbisundon botën. Kështu që, mospajtimi, hamendja dhe dobësia-të cilave njeriu iu është ekspozuar, bëjnë që ai çdoherë të ndjejë presion psikik të përhershëm, sidomos kur tenton të mendojë se mund të vijë deri te ndryshimet e mëdha në botë, ndryshime këto që do ta çlironin nga vuajtjet historike dhe do ta mbjellte pushtetin e ri i cili do të bazohej mbi parimet e drejtësisë dhe të vërtetës. Ky person e nxit individin të dyshojë edhe në tërë konceptin e ndryshimit dhe kundrejt saj, nga cilido qoftë shkak të ndjejë refuzim. Sa na përket neve, ne në vazhdim do të merremi me secilën nga këto pyetje, duke iu përgjigjur secilës shkurt, për shkak të hapësirës dhe kohës së kufizuar.

## **PËRSE MEHDIUT I ËSHTË DHURUAR KAQ JETË E GJATË?**

- A është e mundur që njeriu të jetojë me qindra vjet, ashtu siç është rasti me Prijësin e Shumëpritur, që të vie deri te ndryshimet në botë? Vjetërsia e tij (mosha) do të duhej të ishte njëmijë e njëqind e dyzet vjet, që është katërmëdhjetë herë më shumë se mesatarja e jetëgjatësisë së njeriut të rëndomtë e cila zgjat prej lindjes deri në vdekje.

- Fjala “mundësi” këtu ka tri kuptime të mëposhtme: mundësi praktike, mundësi shkencore dhe mundësi filozofike dhe logjike.

- Me mundësinë praktike mendoj në atë që ka të bëjë me mua, ju apo dikë të tretë, si p.sh udhëtimi nëpër oqean, depërtimi deri te thellësitë më të largëta të detit apo shkuarja (fluturimi) në Hënë. Gjithë kjo praktikisht është e mundur, ngase veçmë këto kanë ndodhur.

- Me mundësinë shkencore nënkuptoj detyrat të cilat nuk më janë dhënë mua, juve apo dikujt të tretit nëpërmjet mjeteve të cilat na janë mundësuar në civilizimin

ekzistues. Mirëpo, nuk ekziston asgjë në trendet e ndryshueshme shkencore që do ta justifikonte hudhjen e mundësisë së kryerjes së detyrave të këtitilla-kryerja e së cilave do të përputhej në veçoritë dhe rrethanat e mundësive. P.sh. asgjë në shkencë nuk mund ta mohojë mundësinë e udhëtimit në Venerë, ngase të gjitha gjërat tregojnë në mundësinë e këtitillë, edhe pse një gjë e tillë (pra udhëtimi drejt Venerës) nuk është i mundshëm për mua, ju, por dallimi në mes udhëtimit për në Hënë dhe atij për në Venerë është vetëm një hap. Ky i dyti kërkon kapërcimin e disa vështirësive relative-të cilat burojnë nga fakti se udhëtimi drejt Venerës do të zgjaste mjaft gjatë. Nga kjo konkludojmë se shkencërisht është e mundshme të udhëtohet në Venerë, edhe pse nuk është e mundur nga aspekti praktik të kryhet ky udhëtim.

- E kundërta e kësaj ideje është ideja e udhëtimit drejt Diellit apo thellësive të universit, e cila parë nga pikëpamja e mundësisë shkencore është e pamundur. Shkenca kurrë nuk do ta pranonte këtë mundësi, ngase edhe shkencërisht ashtu si dhe nga përvoja, nuk do të kishte mundësi të zbulimit të teshave të cilat do të mbronin trupin nga nxehtësia e diellit. Dielli është sikur një furrë gjigante, temperatura e lartë e së cilës është aq e lartë-sa që është e pamundur edhe të imagjinohet.

- Me mundësinë logjike ose filozofike nënkuptojmë që nuk ekziston asgjë në arsye, e cila është në përputhje me atë që e di nga përvoja, dhe e cila do të mund të arsyetonte refuzimin e mundësisë të ndonjë ngjarjeje/ndodhie apo të vendosmërisë së a thua e njëjta do të duhej të ndodhte apo të mos ndodhte. Ta zëmë p.sh. se tri portokallë duhet t'i ndajmë në dy pjesë të barabarta-gjë që logjikisht është e pamundur, ngase logjika e di, përpara kryerjes së këtij eksperimenti se numri tre është numër tek, ndaj edhe nisur nga kjo është e pamundur që të ndahet në dy pjesë të barabarta, ngase atëherë do të ishte shndërruar në numër çift-e cila do të paraqiste kundërshti e cila përsëri është e pamundur në logjikë.

- Mirëpo, nëse njeriu i është ekspozuar zjarrit ose është nën rrezet e diellit dhe nuk digjet, përkatësisht ndjen nxehtësi-logjikisht kjo është e pamundur-ngase kjo është në kundërshtim me pohimin se nxehtësia nga trupi me temperaturë të lartë kalon drejt atij me temperaturë më të vogël (ulët). Një gjë e tillë do të ishte në kundërshtim vetëm me eksperimentin i cili tregon, se në të vërtetë trupi me temperaturë të lartë kalon kah ai me të ulët-derisa nuk bazohet temperaturuar e të dy trupave. Nga kjo kuptojmë se mundësia logjike ka fushëveprim më të gjerë se ajo shkencore, kurse kjo e dyta më të gjerë se ajo praktike.

- Nuk ka dyshim në mundësinë logjike të zgjatjes së jetës njerëzore (të njeriut) në disa mijëra vite, nga kjo nuk është e pamundur nga pikëvështrimi i perceptimit të gjërave nga aspekti mendor. Në këtë supozim nuk ka jologjikshmëri, ngase jeta ashtu siç është-nuk e kupton vdekjen e befasishme dhe këtë fakt askush nuk mund ta kontestojë. Po ashtu, nuk ka dyshim edhe në supozimin se kjo jetë e zgjatur nuk është e mundur nga këndvështrimi i pikëpamjes praktike, ashtu siç është rasti me depërtimin në thellësinë e oqeanit apo lëshimin në Hënë, ngase-edhe përkundër mjeteve dhe instrumenteve moderne-bashkëkohore-të cilat janë rezultat i zhvillimit teknik, dhe të cilët bota (njerëzimi) sot i posedon, përsëri nuk është e mundur që të zgjatet jeta e njeriut për disa qindra vite. Ky është shkaku që dijme, se madje edhe ata që nga mesi i njerëzve dëshirojnë të jetojnë më gjatë dhe të cilët janë të aftë në shfrytëzimin e mundësive shkencore, prapëseprap mundin të jetojnë vetëm jetëgjatësinë e njeriut të rëndomtë.

- Sa i përket mundësisë shkencore, sot nuk ekziston asgjë në shkencë që do ta arsyetonte mohimin e këtij fakti nga këndvështrimi teorik i gjërave. A thua kjo dukuri tregon për ligjin natyror-në të cilin qelizat e organizmit njerëzor, kur njëherë e arrijnë kulminacionin e zhvillimit të tyre, gradualisht shkojnë kah ngurtësimi dhe humbja e

aftësive për kryerjen e detyrave të tyre, deri në momentin e caktuar, bile edhe në rastin e mbrojtjes nga disa faktorë të jashtëm, njeriu nuk vdes? Apo, a thua vallë ky ngurtësim i qelizave trupore, pastaj mungesa e aftësisë së kryerjes së obligimeve fiziologjike është rezultat i luftës kundër disa faktorëve të jashtëm, siç janë mikrobet apo helmi i cili lirohet në organizëm gjatë ushqimit të tepërt apo punës së rëndë-me të cilën individi merret apo rezultat i diç krejt të tjetër? Kjo është pyetje për të cilën shkencën duhet të gjejë përgjigje, edhe pse ka shumë mundësi të cilat do të mundeshin të jenë përgjigje.

- Në qoftë se e shqyrtojmë pikëpamjen shkencore e cila përpiket që procesin e plakjes dhe të dobësismit që vjen me të-ta shpjegojë si rezultat të reaksioneve ndaj faktorëve të jashtëm, kjo d.t.th që teorikisht është e mundshme, njëherë kur i izolojmë qelizat të cilat e përbëjnë organizmin dhe të cilat reagojnë ndaj këtyre ndikimeve, ta vazhdojnë jetën deri te niveli ku është e mundshme të anashkalohej, po madje edhe të kalohet mplakja...

- Nga ana tjetër, nëse e marrim në shqyrtim pikëpamjen e dytë, sipas së cilës plakja (të plakurit) është proces natyror, të paktën sa u përket qelizave të gjalla, kjo do të thotë se njëloj brenda vetë vetvetes (qelizat) ruajnë embrionin e vdekjes së tyre, e cila vjen (shfaqet) njëherë kur përfundon procesi i mplakjes.

- Unë them: (Muhammed Bakir Es-Sadri, vërej e përkth). Nëse e analizojmë këtë qëndrim, do të arrijmë në përfundim se kjo nuk do të thotë që në këtë ligj natyror nuk ka përshtatje, por që më parë-supozimi mbi ekzistimin e saj tregon se është i njëjti, përkatësisht i përshtatshëm, ngase në jetën e përditshme përpos asaj që kryejnë shkencëtarët me anë të eksperimenteve bëjnë në laboratorët e tyre, vërejmë se mplakja nuk është dukuri fiziologjike e cila nuk ka tamam kohë të caktuar. Ngase mund të jetë shumë plak, ndërsa trupi i tij të jetë në gjendje shumë të mirë-pa shenjë pleqërie-ashtu siç e kanë vërtetuar mjekët. Aq më tepër kur disa shkencëtar duke u shërbyer me metodën e përshtatjes ua zgjasin jetën disa llojeve të gjallesave-njëqind herë më tepër se sa natyra e jetesës së tyre, duke krijuar kësisoji, rrethana të caktuara dhe shkaktarë (faktorë) të cilët e shtojnë procesin e të plakurit. Kështu që, shkencërisht është vërtetuar se ky proces mund të shtyhet me krijimin e rrethanave dhe faktorëve të ndryshëm, edhe pse një eksperiment i këtillë nuk është bërë ndaj krijesës së ndërlikuar siç është qenia njerëzore, ngase ekziston dallimi me kryerjen e eksperimenteve tek trupi i njeriut dhe i organizmave të tjerë.

- Kjo d.t.th nga pikëpamja teorike, se shkencë-përmes metodave të saja të orientuara, kurrë nuk ka patur vërejtje serioze në lidhje me idenë e zgjatjes së jetës së njeriut, pa marrë parasysh se mplakja a është komentuar si prodhim i luftës dhe kontaktit të afërt me ndikimet (rrethanat) e jashtme, apo si rezultat i procesit natyror të qelizave të cilat çojnë në vdekje.

- Kështu përfundojmë se zgjatja e jetës njerëzore dhe jetëgjatësia e tij shekullore është e mundshme si nga aspekti logjik ashtu edhe nga ai shkencor, por është e pamundshme nga aspekti praktik, si dhe fakti që shkencën duhet akoma edhe më tepër të përparojë me qëllim që kjo mundësi të mund edhe të realizohet.

- Në frymën e asaj çfarë kemi diskutuar, tani do të merremi me jetën e Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) dhe me numrin e madh të çudirave dhe të papriturave që e rrethojnë.

- Kështu theksojmë (potencojmë) se pasi që mundësia e zgjatjes së jetës logjikisht dhe shkencërisht është e vërtetuar, shkencën tani, është në procesin e gradualshëm të shndërrit të mundësisë teorike me atë praktike. Nuk ka vend për tu habitur, se sa më pak mundësi, që Mehdiu, përpara se shkencën ta arrijë nivelin e duhur të zhvillimit të kësaj mundësie, pikërisht t'i paraprijë shkencës në këtë drejtim. Kjo do

ta barazonte me atë person, i cili përpara shkencës së sotshme, do të kishte zbuluar ilaçin e kancerit.

- Pyetja që tani shtrohet është se si Islami, i cili e ka caktuar periudhën kohore të Prijësit të Pritur, i ka paraprirë shkencës në aspektin e kësaj diturie? Përgjigj-ja është se Islami jo vetëm në këtë lëmi i ka paraprirë shkencës. A thua vallë Sheriati Islam (Ligji) plotësisht nuk i ka paraprirë zhvillimit të mendimit njerëzor, dhe atë për disa shekuj? Po a nuk ka shpallur shembuj të caktuar-të cilët kanë dhënë plane të cilat është dashur të shndërrohen në vepra, dhe që njeriu-duke vepruar i pavarur, mund të arrihet vetëm pas disa shekjush? Po a nuk i formuloi rregullat e caktuara, të përsosura nga urtësia e tyre, fshehtësitë e të cilave njeriu i kuptoi vetëm pas një kohe bukur të gjatë? Po urtësia e urdhërit Hyjnor a nuk i hapi fshehtësitë e universit, të cilat, as që mund të depërtonin në trurin e njeriut, të cilën shkencë vetëm më vonë e vërtetoi dhe përkrahu?

- D.t.th nëse për ne këto fakte janë mjaft bindëse, përse atëherë nuk do ta pranoni faktin se Ai që e dërgoi këtë porosi, i Lartëmadhëruari i ka paraprirë shkencës në aspektin e vjetërsisë (moshës së gjatë të Mehdiut).

- Këtu kam përmendur vetëm ato paraprirje të mundësishme me të cilat drejtpërdrejt ballafaqohemi, ne mund t'i bashkangjesim edhe aspektet e përmendura më herët të Porosisë së Zotit, si p.sh kur neve na lajmëron mbi udhëtimin e natës të Pejgamberit s.a.v.s nga Xhamia e Haremit-Sherfit (Qabeja) në Xhaminë e El-Aksasë (Bejtul-makdis). Në qoftë se këtë udhëtim duhet ta kuptojmë (perceptojmë) në suaza të ligjeve natyrore-do të shohim se i njëjti është kryer në mënyrën-të cilën shkencë ka mundur ta arrijë vetëm pas disa qindra vjetësh.

- Ndaj e njëjta dituri e Zotit, e cila Pejgamberit (Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë gjithnjë mbi të dhe Familjen e tij!) ia ka mundësuar të ecë përpara shkencës, po ashtu ua ka mundësuar pasardhësve të tij të zgjedhur të kenë jetë të zgjatur, kuptohet, përpara se shkencë të mund ta pranojë një arritje të këtillë.

- Me siguri jeta e gjatë të cilën All-llahu i Lartëmadhëruar ia ka dhuruar Shpëtimtarit të Priturit (Mehdiut) mund të duket në shikim të parë e habitshme, kuptohet nëse kundrohet brenda pikëpamjeve të jetës së përditshme dhe të arriturave shkencore. Por, a thua ky rol vendimtar i ndryshimit të botës-i përgatitur për Shpëtimtarin, nuk është i jozakonshëm brenda suazave të jetës së njerëzve të thjeshtë dhe përvojave të tyre në zhvillimin e historisë? Po a thua Atij-Mehdiut nuk i është besuar detyra e ndryshimit të botës dhe ndërtimi i sërishëm i qytetërimit mbi themelet e drejtësisë dhe të vërtetës? A thua është i mjaftueshëm shkaku për mospranimin e kësaj-ajo që ky rol i madh është i karakterizuar me ndodhi të çuditshme dhe të jashtëzakonshme, siç është zgjatja e jetës së Prijësit të Pritur? Moskuptueshmëria e këtyre fakteve dhe jorëndësia e tyre, sado që janë të mëdhaja, prapëseprapë nuk mund ta anashkalojnë rëndësinë (vlerën) e këtij roli të madh-i cili gjithsesi do të realizohet ditën e caktuar. Ndaj, nëse ia japim vleftën këtij roli unikat (të vetëm), vështruar nga pikëpamja historike, përkundër faktit se në historinë e njerëzimit kurrë nuk ka patur ndonjë rast të këtillë, përse atëherë nuk do ta pranoni jetën e zgjatur të njeriut-i cili akoma është unikat në jetën tonë të përditshme?

- Pyetem, a thua vallë kjo është rastësi që vetëm dy njerëzve u është dhënë roli i pastrimit të civilizimit njerëzor nga prishja (destruktiviteti), dhe më pas ndërtimi i sërishëm i tij (civilizimit), që d.m.th se u është dhënë jetë më e gjatë se e jona, jeta e rëndomtë. I pari prej tyre është Nuh i a.s i cili rolin e tij e luajti në peridhën e hershme të njerëzimit. Në Kur'an thuhet se Nuh i a.s jetoi në mesin e njerëzve nëntëqind e pesëdhjetë vjet. Roli i tij ishte që nga e para ta ndërtojë botën pas Përmytjes së Madhe (Tufanit).

- I dyti është Mehdiu i cili rolin e tij do ta luajë në të ardhmen (në ardhmëri), dhe i cili në mesin e njerëzve jeton veçmë më shumë se prej njëmijë vjetësh. Ai përsëri, nga e para do ta ndërtojë botën në ditën e caktuar. A thua atëherë vallë: Me të vërtetë do ta pranoni Nuhin i cili jetoi gati njëmijë vjet, dhe do ta refuzoni Mehdiun?

## **ÇUDIA DHE JETA E GJATË**

- Gjer më tani pamë se zgjatja e jetës njerëzore shkencërisht është e mundshme. Por, ja të supozojmë se nuk është e mundshme, se procesi i mplakjes dhe vdekjes është i pashmangshëm dhe as sot, e as në të ardhmen nuk mundet ta kalojnë gjendjen e tyre vetjake. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se zgjatja e jetës njerëzore, siç është rasti me Nuhin dhe Mehdiun, është në kundërshtim me ligjet e natyrës-të cilat shkenca megjithatë falë mjeteve bashkëkohore përmes eksperimenteve e ka vërtetuar mundësinë e jetëgjatësisë. Kështu që, kjo zgjatje e jetës së personit të caktuar i cili duhet ta rivendosë porosinë e Zotit është shndërruar në çudi (mrekulli) e cila u kundërvihet zbatimit të ligjeve natyrore, përmes rrethanave të caktuara.

- Megjithatë, kjo nuk është çudia e vetme e këtij lloji, e as që është e huaj për Islamin, i cili ngritet mbi themelet e Kur'anit dhe Sunnetit. Aq më tepër që, procesi i mplakjes nuk është aq më i komplikuar sesa procesi i barazimit të temperaturës së dy trupave-ku trupi i cili ka më tepër temperaturë e përçon të njëjtën tek trupi tjetër me më pak temperaturë. Kjo ka ngjarë në rastin e Ibrahimit a.s kur e vetmja mënyrë për t'u mbrojtur jeta e tij ishte funksionimi i këtij procesi, ndaj edhe fjalët vijuese (të All-llahut xh.sh) iu drejtuan zjarrit në të cilin u hodh:

- “Po Ne i thamë: “O zjarr, bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!” (El-Enbija, 69)

- Kështu që Ibrahim i a.s nga zjarri doli i sigurtë dhe i padëmtuar. Ekzistojnë edhe raste të tjera kur ka ardhur deri tek çrregullimi i ligjeve të natyrës, me qëllim të mbrojtjes së ndonjë peygamberi apo Argumenti të All-llahut në tokë. P.sh është, fjala vjen, rasti i çarjes së detit para Musait a.s; pastaj rasti i romakëve-të cilët ranë në huti duke menduar se e kanë gozhdur Isain a.s (ata në të vërtetë kapën Jehudhën i cili i gjasonte për nga pamja Isait a.s), apo rasti kur Muhammedi s.a.v.s doli nga shtëpia e tij e rrethuar me ushtarë mushrikë-Kurejshit, të cilët me orë të tëra pritnin që ta sulmonin, por All-llahu i Lartëmadhëruar e fshehu nga sytë e tyre-derisa ai ishte duke kaluar përmes tyre. Të gjitha këto raste tregojnë se ligjet e natyrës-në rastin kur është dashur të mbrohet individi të cilin All-llahu ka dashur ta ruajë, janë ndalur (çrregulluar ligjet e natyrës, vërej. e përkth.). Përse atëherë në këtë nuk do të kishim bashkangjitur edhe procesin e mplakjes dhe të veniturit?!?!

- Nga kjo mund të përfundojmë, marrë në përgjithësi, se kurdoherë, kur mbrojtja e jetës së Pejgamberit s.a.v.s mvaret nga lëshimi i ndonjë ligji natyror, kurse vazhdimi i jetës së tij është i domosdoshëm për shkak të detyrës të cilën duhet ta kryejë, këtu ndërhyjnë brenga/përkujdesi i All-llahut xh.sh, duke e zgjatur procesin, me qëllim që detyra të mund të kryhet derin në fund. Nga ana tjetër, kur më veç përfundon misionin e All-llahut ai person i zgjedhur, atëherë ai vdes me vdekje natyrore, apo si dëshmor (shehid), mvarësisht se si ia ka caktuar Zoti.

- Kështu që, gjendemi përballë pyetjes e cila është e pranishme në lidhje me pohimet e sipërpërmendura: Si mundet që procesi i mplakjes të ndryshohet? Si mund të vie deri te prishja e lidhjeve të vendosura në mes paraqitjeve/shfaqjeve natyrore? A thua kjo nuk është në kundërshtim shkencën, e cila e ka zbuluar ekzistimin e atij

ligji natyror, apo procesi dhe e ka definuar atë raport, nëpërmjet rrugës eksperimentale të përfundimit?

- Përgjigjja është si vijon: Shkenca e ka zgjidhur këtë problem duke hequr dorë nga ideja e domosdoshmërisë, të paktën sa u takon ligjeve natyrore. Për të sqaruar këtë, mund të themi që shkenca zbulon ligjet natyrore përmes hulumtimeve dhe eksperimenteve sistematike. P.sh. kur vjen deri te paraqitja e ndonjë dukurie natyrore pas së cilës pason tjetra, nga kjo nxjerrim përfundim mbi ligjin natyror i cili thotë: Kurdoherë që vjen deri te paraqitja e një dukurie natyrore, pas asaj automatikisht pason edhe tjetra.

- Mirëpo, shkenca nuk rekomandon që domosdoshmëria e raporteve në mes të dy dukurive të rrjedh nga natyra e tyre, ngase domosdoshmëria është kusht i padukshëm, i cili nuk mund të tregohet me anë të eksperimentit apo mjeteve të hulumtimit shkencor. Ndaj, logjika e shkencës moderne (bashkëkohore) potencon se ligji natyror, ashtu siç e ka përcaktuar shkenca-nuk tregon në nevojën e raporteve të ndërsjella, por në lidhjen e pashkëputur në mes të dy dukurive. Por, kur ndodh çudia dhe dy dukuritë ndahen (veçohen), kjo nuk do të thotë se është prishur raporti i tyre i ndërsjellë.

- E vërteta është në atë që çudia, në aspektin e saj fetar (d.t.th parë nga pikëpamja fetare) është e kuptueshme nga pikëpamja e logjikës shkencore moderne, se sa nga pikëpamja klasike e shkaqeve të raporteve të ndërsjella. Ky konstatim i vjetër ka konsideruar se në çdo rast, ku nga dukuria e parë-automatikisht pason tjetra-patjetër duhet të ekzistojë raport i domosdoshëm i ndërsjellë në mes atyre dukurive, që d.t.th se është e pamundshme t'i ndashë. Mirëpo, falë logjikës bashkëkohore të shkencës, ky konstatim është zëvendësuar me ligjin e raporteve të ndërsjella apo paraqitjen e një pas njëshme të dy dukurive, pa supozimet mbi domosdoshmërinë e të padukshmes.

- Në këtë mënyrë, çudia, nga këndvështrimi i ndjekjes së mvarur, shndërrohet në gjendje të jashtëzakonshme, pa kundërshtimin e parimeve të domosdoshmërisë. Ajo përfundon së qenuri diçka që nuk është e mundshme.

- Nën dritën e induktionit logjik të bazuar, pajtohem me konstatimin bashkëkohor sipas të cilit indukcioni nuk tregon në ekzistimin e kauzalitetit të raporteve të ndërsjella mes dukurive. Ne konsiderojmë se ajo tregon se ekziston komentimi i përbashkët i lidhshmërisë zinxhirore mes tyre. Meqë ky komentim mund të formësohet në bazë të supozimeve të domosdoshmërisë subjektive ka mundësi të formohet edhe mbi supozimet e urta-të cilat Krijuesi i universit (All-llahu xh.sh) gjithnjë i ka lidhur dukuritë njëra me tjetrën. Ndaj, e njëjta Urtësi, ndonjëherë, bën përjashtime, kështu që edhe ndodhin çudira...

## **PREJ NGA DËSHIRA PËR ZGJATJEN E JETËS**

- Tani do të merremi me pyetjen vijuese, kurse ajo është: Përse All-llahu i Lartëmadhëruar ka treguar kaq dëshirë (të madhe) t'ia zgjasë jetën mu këtij individit? Përse do të duhej të çrregulloheshin ligjet e natyrës vetëm e vetëm që të zgjatej jeta e tij? Përse udhëheqja në "Ditën e caktuar" i është dhënë atij, e jo individit i cili do të lindet në të ardhmen dhe do ta merr rolin e pritur?

- Me fjalë të tjera: Çfarë dobie ka nga mungesa e këtillë shumë e gjatë dhe çfarë motivi fshehet pas kësaj? Vërtet shumë njerëz parashtrojnë pyetje të këtilla, ndërsa akoma askush nuk është gati ta pranon përgjigjen hyjnore (të Zotit). Mirëpo, ne besojmë se dymbëdhjetë imamët formojnë grupin e vetëm të individëve dhe se për asnjërin prej tyre nuk ekziston zëvendësim, përdërisa njerëzit kërkojnë komente shoqërore të pozitës së tyre në lëminë e njohjes së të vërtetës, me qëllim të kuptimit të asaj se deri në çfarë ndryshime të mëdhaja do të vie dhe se çfarë është e duhur për atë ditë të caktuar.

- Nisur nga kjo, ne herë pas here do t'i lëmë pas dore cilësitë për të cilat besojmë se duhet t'i posedojnë imamët e pagabueshëm dhe do të parashtrojmë pyetje:

- Sa i përket ndryshimit në « Ditën e caktuar » dhe kuptimësinë e saj në suaza të përvojës dhe rregullave të jetës, a mundemi ta konsiderojmë jetën e zgjatur të prijësit të zgjedhur dhe të mbrojtur si faktor suksesi të po të njëjtit?

- Në këtë pyetje mundemi të japim përgjigje pohuese, ngase për këtë ekzistojnë shumë shkaqe, nga të cilët po i përmendim të mëposhtmit:

- E para është ajo që ky ndryshim i madh kërkon prej udhëheqësit vend të posaçëm shpirtëror, të mbushur me kuptimësi për sukses dhe sens për mospranimin e civilizimit të dhunshëm-në luftë për të cilën edhe është përgatitur-me qëllim që ta ndryshojë (d.t.th. civilizimin e dhunshëm) në civilizim të ro botëror.

- Pra Prijësi sa më i vetëdijshëm të jetë për të këqijat e civilizimit, kundër të cilave edhe lufton, dhe sa më të qartë ta ketë se ajo është vetëm një shtresë (e hollë) pluhuri në shtegun e gjatë të ekzistimit të njeriut, do të jetë më i gatshëm nga aspekti psikik, për luftën, me qëllim të ndërprerjes së zullumit dhe qëndrimit të tij të paluhatshëm drejt fitores (triumfit) përfundimtar.

- Ndaj është e qartë se madhësia e këtij pozicioni shpirtëror duhet të jetë me përmasat e mëdha të ndryshimit që të ketë mundësinë e duhur për ta çrrënjësuar civilizimin aktual të dhunës botërore. Aq sa më shumë pengesat të jenë të mëdhaja dhe civilizimi thellë i rrënjësuar, pozita shpirtërore duhet të jetë më e madhe dhe me të duhet vendosshmërisht të ecet përpara.

- Meqë porosia e “Ditës së caktuar” është ndryshimi i përgjithshëm i botës së mbushur me padrejtësi dhe vuajtje, atëherë e natyrshme është që individi, i cili duhet të çojë deri te kjo, duhet të ketë shkallë të lartë të pozitës shpirtërore, ai duhet të jetë ai që jeta e të cilit e kapërcen jetëgjatësinë e atyre të cilët janë të lindur në këtë botë dhe të rritur nën hijen (frymën) e civilizimit-kundër të cilit ai do të duhet të luftojë, me qëllim të shkatërrimit dhe zëvendësimit të tij me qytetërim të ri, të ngritur mbi parimet e drejtësisë dhe të vërtetës.

- Secili që është rritur në civilizimin bashkëkohor, vlerat dhe mënyrat e të menduarit, të cilat mbisundojnë në botë, nuk mund t'i kundërvihet, ngase është i lindur gjersa ai akoma ekziston dhe i hap sytë e tij vetëm që t'i shoh dallimet dhe specifikat ekzistuese të tij (civilizimit aktual) të cilat sa vijnë e zgjerohen. Në anën e kundërt të individit të tillë, gjendet ai-fillimi i të cili daton thellë në histori, i cili ka filluar të jetojë përpara se qytetërimi i cili e ka rrethuar njerëzimin dhe periudhën e zhvillimit të tij, e ka parë dritën (jetën). Ai ka parë se si embrioni i imët, i cili mezi që duket, fillon të rritet dhe lëshon rrënjë në shoqëritë njerzore, duke e pritë momentin e duhur të lulëzimit dhe shpërthimit. Ai është dëshmitar i zhvillimit dhe lëvizjes së tij, ndonjëherë vetëm duke vështruar, kurse ndonjëherë suksesshëm (duke u kyçur në rrjedhë). Ky civilizim poshtë (në tokë) përparon dhe bëhet i madh, gradualisht duke e marrë dominimin mbi fatete njerëzve. Njeriu i këtillë, i cili nëpërmjet gjithë këtyre staveve ka kaluar urtë dhe me kujdes, duke e kundëruar këtë div (kundër të cilit duhet të luftojë) gjatë historisë të cilën vetë e ka përjetuar, dhe për të cilën nuk ka lexuar



vetëm në libra, do të konsiderojë se shkatërrimi i atij civilizimi-është fati i tij qartë i përcaktuar, dhe nuk do të sillet sikur Jean Jacques Rousseau (Zhan Zhak Ruso) i cili ishte i tmerruar me vetë faktin se Franca mund të ekzistojë pa mbret, d.t.th. pa monarki (mbretëri), edhe pse ishte njëri prej intelektualëve të parë dhe filozofëve të cilët trajtonin (merreshin) me situatën politike të kohës së vet. Rusosë, kjo i ndodhi ngase jetonte nën hijen dhe ndikimin e monarkisë.

- Nga ana tjetër, ky individ (Mehdiu) fillimi i të cilit i ka rrënjët thellë në histori, do ta ketë krenarinë historike, forcën dhe ndjenjën e fortë të dirigjimit të asaj me të cilën është i rrethuar, gjithë atë çka ekziston, lindur në periudhën e caktuar historike në të cilën është krijuar, dhe pastaj do të zhduket, ashtu siç nuk ka qenë edhe përpara se të zhdukej në të kaluarën e largët apo të afërt, si dhe se historiku i cilitdo civilizim, sado gjatë ai të ketë ekzistuar-nuk paraqesin asgjë tjetër pos-numër të caktuar të ditëve në historinë e gjatë.

- Po a thua në Kur'an nuk e kemi lexuar suren "El-Kehf" (suren e "Shpellës")? A nuk kemi lexuar për ata të rrinj të cilët All-llahu i ndihmoi, ata të rrinj të cilët iu kundërvunë pushtetarëve paganë, të rrinj të cilët ishin të vendosur dhe fare të paluhatsëm në luftë kundër atyre të cilët ishin kundër Tevhidit (Njëshmërisë së All-llahut), dhe mundoheshin ta ndalojnë sundimin e politetizmit. Djelmohat ishin të vetëdijshëm se dritaret e shpresave para syve të tyre ishin të mbyllura, ndaj edhe kërkuan strehim në shpellë, duke e lutur sinqerisht t'u ndihmojë në gjetjen e rrugëzgjdhjes, meqë vetë nuk ishin në gjendje për një gjë të tillë. Nuk mund të kalonin nëpërmjet fakteve se gjërat e shtrembëruara/të devijuara mbisundonin botën, zullumi gjithandej ishte përhapur, si dhe se çdokush zemra e të cilit e aspironte të vërtetën ishte i persekutuar. A e dini se çfarë bëri All-llahu? I vuri në gjumë dhe në gjumë ndejtën treqind e nëntë vjet brenda në shpellë. Më pas i zgjoi nga gjumi dhe i dërgoi në botë. Në ndërkohë të kësaj periudhe (gjersa ata ishin në gjumë) kishte ardhur deri te shkatërrimi i civilizimit- i cili i kishte turbulluar me zullumin e tij, dhe po i njëjti (civilizim) ishte shndërruar vetëm pjesë e historisë që më askënd nuk mund ta frikësonte. Djelmohat u dërguan në botë me qëllim që edhe vetë të vërtetohen dhe të marrin mësim se gjithçka që është e shtrembër-më në fund të shkatërrohet.

- Dhe vërtet, nëse këtë qartë e panë njerëzit e shpellës, me gjithë kuptimin e asaj mrekullie (që paraqiste befasi për to) e cila ua zgjati jetën për treqind vjet, atëherë po e njëjta është e mundshme edhe në rastin e Mehdiut, Prijësit të pritur, jetëgjatësia e të cilit ia mundëson që dragoi ta shohë xhuxhimaxhuxhin (shkurtabiqin), druri i lartë farën, kurse uragani erën e thjeshtë...

- Me këtë duhet të theksojmë se përvoja deri tek e cila arrihet me anë të ndjekjes së të gjitha ndodhirave të civilizimit të cilat ndërmjet veti ndërrohen dhe me ballafaqim të tyre të drejtëpërdrejtë me këto ndërrime, ka ndikim të madh në parapërgatitjen mendore dhe zgjerimin e horizonteve të tyre Prijësi i Pritur, ngase drejtëpërdrejtë ballafaqohet me traditat e të tjerëve, dobësitë e tyre dhe fuqitë si dhe llojet e tyre të gabimeve dhe preciziteteve.

- Kjo gjithashtu, i jep aftësi t'i vështrojë sëmundjet shoqërore, plotësisht i vetëdijshëm për shkaqet dhe rrethanat historike të cilat sollën këto.

- Aq më tepër që, kryerja e ndryshimeve, që është detyrë e Prijësit të Pritur, është ngritur mbi themelet e porosisë personale, e kjo është porosia e Islamit. Ndaj, është e natyrshme në këtë rast, të kërkojë që udhëheqësia e domosdoshme të jetë shumë afër burimeve të Islamit, që personi i zgjedhur të jetë i pavarur, i çliruar prej ndikimit të civilizimit-kundër të cilit do të luftojë në "Ditën e Caktuar". Individu i cili është lindur dhe rritur në të (civilizimin), intelekti dhe ndjenjat e të cilit janë zhvilluar në suaza të tij, nuk do të ishte në gjendje, për shkak se shpesh-herë një person i tillë

nuk mund të çlirohet prej ndikimit dhe shprehive të mbetura nga civilizimi në të cilin jeton, madje edhe në qoftë se ky individ zgjidhet nga njerëzit të udhëheq, t'u prijë ndryshimeve të atij civilizimi.

- Për shkak të kësaj, se Prijësi i Mbrojtur (Mehdiu) nuk mund të bie nën ndikimin e civilizimit, për ndryshimin e të cilit edhe është i përgatitur, e domosdoshme është që personaliteti i tij plotësisht të jetë i formuar në stadiet (zhvillimet) e civilizimeve të mëhershme, aq më afër shpirtit të përgjithshëm (univerzal), dhe sipas parimeve të asaj gjendjeje aktuale të zhvillimit të njerëzimit-në "Ditën e Caktuar"-duhet të ndodhin nën udhëheqjen e tij.

## **SI ËSHTË I PËRGATITUR PRIJËSI I MADH?**

- Tani erdhëm edhe tek pyetja e tretë, kurse ajo është: Si ka mundësi që Prijësi i caktuar të jetë i përgatitur për misionin e tij? Kur e dijmë se me babain e tij, Imam Askeri-un, ka ndenjtur vetëm pesë vjet, që paraqet periudhën e fëmijërisë, e cila nuk është e mjaftueshme për arritjen e pjekurisë? Ndaj edhe pyetemi: Në çfarë rrethanash erdhi deri te kjo arritje e madhe?

- Përgjigjja është vijuese: Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!) ka qenë i caktuar për trashëgimtar të babait të vet, si prijës i muslimanëve, që d.t.th se ka qenë Imam, në kuptimin e plotë shpirtëror dhe intelektual të fjalës, qysh në periudhën e hershme të jetës së tij fisnike.

- Aq më tepër që, Imameti (udhëheqësia) në vitet e hershme të jetës së tij, ekzistonte edhe më parë, siç ishte rasti me paraardhësit e tij (Paqja qoftë mbi ta!). P.sh në rastin e Imam Muhammedit, birit të Ali El-Xhevadit (Paqja qoftë mbi te!), kishte domethënie të vërejtur dhe praktike, për të cilën muslimanët ishin të vetëdijshëm dhe me të cilët jetonin, në përvojat e tyre me Imamët. Kështu që, nuk mund të kërkojmë argument më të mirë, për drejtësinë dhe përhapjen e paraqitjes së Imametit, sesa përvoja e tërë bashkësisë. Kështu që këtë pyetje mund ta shpjegojmë në mënyrën vijuese:

- Udhëheqja e Imamëve të Ehlul-Bejtit (Familjes së Pejgamberit s.a.v.s) kurrë nuk ishte qendër e influencës dhe fuqisë që përcillet nga i ati te i biri, me anë të trashëgimisë, nën përkrahjen e fortë të regjimit sundues, siç ishte me dinastitë e fatimitëve dhe abasitëve, por e kundërta: ato gjithmonë ngriteshin (zgjidheshin) nga admirimi që kishin njerëzit për ta, mbi bazën e bindjeve të arsyeshme (logjike) dhe shpirtërore përkitazi mbi vlerën e imametit për udhëheqje në Islam.

- 2. Ky admirim, kjo dashuri e njerëzve ekzistonte qysh në periudhën e hershme të Islamit, e veçanërisht u zgjerua në kohën e dy imamëve, Bakirit dhe Sadikut (Paqja qoftë mbi ta!). Shkolla të cilën e udhëhoqnin këto dy imamë çoi në progresin e madh në mbarë botën islame, duke i bashkuar qindra juristë (fukaha), teologë (mutekelimunë) dhe komentues të Kur'anit (mufesirë), si dhe njerëz të dijshtëm nga fushat e ndryshme të shkencave islame dhe humane, të cilat dominonin në atë periudhë, kështu që Hasani, i biri i Ali El-Vashasë, tha "Shkova në Xhaminë e Kufesë, ku gjeta nëntë qind shejhë, të cilët zëshëm flisnin: "Xhaferi, biri i Muhammedit, është në farefisni me ne"...

- 3. Kjo shkollë dhe ajo pjesë e shoqërisë islame të cilën e përfaqësonte, kishte, në lidhje me përcaktimin e Imametit dhe aftësisë së tij për atë rol, kritere të caktuara në të cilat besonte dhe mbi të cilat bazoheshte, ngase konsideronte se individit nuk mund të vendoset për Imam-në qoftë se nuk është më i dijshtëm se gnostikët e kohës së tij.

- 4. Kjo shkollë dhe ndjekësit e saj, për shkak të besimit të tyre në Imamet, i cili besim nga ana e strukturave udhëheqëse konsiderohej linjë armiqësore, bile edhe nga

pikëpamja intelektuale, ishin të gatshëm për sakrifica. Ky ishte shkaku që pushteti të udhëheq disa fushata kundër kësaj shkolle, ndaj si rrjedhojë e kësaj, shumë ndjekës u vranë apo u burgosën, kurse qindra të tjerë vdiqën qelive të errëta. Me këtë, u tregua se ata, të cilët besonin në imamet, me të vërtetë ishin të gatshëm të sakrifikohen, ndërsa mbështetja e vetme të cilën e kishin, ishte afërsia e tyre me All-llahun.

- 5. Imamet nuk dëshironin të ishin të ndarë prej ithtarëve të tyre, kjo bënte vaki vetëm atëherë kur autoritetet i ndiqnin apo venin në egzil. Nga rrëfimet (transmetimet) mësojmë në lidhje me atë çfarë ju ka ndodhur këtyre dymbëdhjetë imamëve, si dhe nga letrat-të cilat ata ua kanë dërguar bashkëkohësve të vet si dhe udhëtimet të cilët i kanë ndërmarrë, nga njëra anë kurse nga ana tjetër-nga përfaqësuesit e tyre të cilët mbërrinin në vende të ndryshme të botës Islame, si dhe nga vizitat të cilat shiitë u bënë imamëve të tyre në qytetin e shenjtë të Medinës-gjatë kohës së kryerjes së haxhxit.

- Të gjithë këto faktorë tregojnë për lidhjen e pashkëputshme në mes imamëve dhe ithtarëve të tyre, e cila lidhje është përhapur nëpër vise të ndryshme të botës islame, përkundër të gjitha dallimeve në klasa, përfshirë dijetarët dhe të tjerët.

- 6. Halifati i cili ekzistonte në periudhën e Imamëve, i konsideronte ata (d.m.th. Imamet) kërcënim të madh për ekzistencën e vet dhe fatin e tij. Kështu që, shumë mund ofroi në dobësimin e Imametit, sidomos aspektit të tij shpirtëror. Ekzistonte një dozë e madhe e mosdurimit, e cila, nga ndonjëherë kur siguria e tyre personale ishte në pyetje, merrte përmasa të dhunës. Përndjekjet dhe vrasjet ishin të rëndomta për Imamet, përkundër neveritjes dhe pikëllimit i që nxiste në mesin e muslimanëve dhe ithtarëve, pa marrë parasysh dallimet klasore, raporti i tillë ndaj tyre.

- Në qoftë se i shqyrtojmë këto gjashtë pika, duke e dijtur se të gjitha këto janë fakte historike, atëherë nuk ka vend për dyshimin, dhe nisur nga kjo, vijmë në përfundimin vijues: Shfaqja e imameti në rininë e hershme është fakt, e jo iluzion, ngase imami i cili u shfaq si i ri dhe haptas shpalli se është udhëheqës shpirtëror dhe intelektual i bashkësisë muslimane në përgjithësi, dhe të cilit po e njëjta t'i jep legjitimitetin, me siguri që duhet të posedojë ekskluzivisht-jo vetëm dituri dhe njohje-por edhe horizonte të gjera dhe shkathtësi në jurisprudencë, komentim të fesë dhe mësimëve të saja. Në të kundërtën, populli nuk do t'i besonte, e as që do ta konsideronte të aftë për udhëheqje shpirtërore.

- Gjithashtu, duhet ta kemi ndërmend se Imamet ishin në pozita të caktuara-me anë të së cilave mund të mbanin lidhjen me ithtarët e tyre, në jetën dhe personalitetet e të cilëve kanë patur ndikim të ndryshëm.

- A thua mendoni se, mund të ndodh që fëmija ta shpall imametin (udhëheqjen shpirtërore), si dhe ta ngrëjë flamurin e Islamit, plotësisht duke i njohur ata të cilët besojnë në të dhe ata të cilët janë të gatshëm të sakrifikohen pa menduar mbi gatishmërinë e tij, dhe pa shqyrtimin e paraqitjes së imametit në rini dhe vlerën e tij, si dhe konstatimin e veçorive dalluese të Islamit?

- Tani paramendojmë se njerëzit nuk janë përpjekur ta parashikojnë situatën, a thua do të mund të ishte e mundur, që pas aq ditësh, muajsh, po madje edhe vitësh, tërë çështja të kalojë pa hetuar dhe e vërteta të mos del në shesh, edhe pse ka ndodhur rëndom dhe gjithnjë takimi i ndërsjellë mes Imamit të ri dhe njerëzve të tjerë? A është e kuptueshme që vlefshmëria e mënyrës së të menduarit të atij djaloshi të ri dhe dituria e tij, pas një periudhe aq të gjatë të takimit të ndërsjellë kanë mundur të kalojnë pa hetuar?

- Nëse supozojmë se ithtarët e imamit të Ehlul-Bejtit a.s nuk ishin në gjendje të vijnë deri tek e vërteta, përse halifatet të cilat ekzistonin nuk përpiqeshin ta zbulojnë të vërtetën-në qoftë se ajo do t'u mund t'u sillte dobi?

- Asgjë nuk do të ishte më e lehtë se sa konfrontimi me Imamin i cili ishte fëmijë, akoma i papjekur në arsimin dhe mënyrën e të menduarit, gjë që është normale te të gjithë fëmijët e asaj moshe.
- Asnjë plan nuk do të ishte i suksesshëm se sa ajo që fëmija t'u prezentohej ithtarëve të tij (shiitëve) dhe të tjerëve si i paaftë për imamet, d.m.th udhëheqjen shpirtërore dhe intelektuale.
- Nëse veçmë më është vështirë t'i bindësh njerëzit në atë se njeriu, në moshën e tij dyzet apo pesëdhjetëvjeçare, i cili posedon arsimim solid, nuk mund të jetë imam, atëherë kjo nuk do të ishte rast kur bëhet fjalë për fëmijun e thjeshtë, pa marrë parasysh inteligjencën dhe vetëdijen e tij.
- Gjithë kjo do të ishte më lehtë se sa mjetet e ndërlikuara të zhdukjes dhe mundimit të cilat pushtetarët i kanë shfrytëzuar në të gjitha këto periudha.
- I vetmi shpjegim për lojën e këtillë që e loznin halifët e ndryshëm-ishte fakti se imameti në moshën e re ishte shfaqje e vërtetë, e jo vetëm ide-dhe për këtë madje edhe ishin të vetëdijshëm. I vërtetë është fakti se ky fakt është kuptuar pasi që u tentua të luhet në këtë kartë, por ky tentim dështoi. Historia na transmeton numër të madh rrëfimesh për tentime të këtilla dhe dështimet e tyre, por aspak nuk e përmend situatën në të cilën paraqitja e imametit në moshën e re-ishte vënë në shenjë pikëpyetjeje, situata që imami do të ballafaqohej me vështirësitë dhe mynxyrat të cilat do t'i karakterizonin mundësitë dhe do të bënin që populli të ketë besim në te.
- Në këtë kemi menduar kur kemi përmendur se imameti në rini është dukuri e vërtetë në jetën e Ehlul-Bejtit a.s (pasardhësve të Pejgamberit s.a.v.s), aq më tepër që kjo është shfaqje që rrënjët i ka në Urtësinë e Zotit, e cila shtrihet përmes të gjitha porosive dhe udhëheqësve të Zotit. Mjafton të sjellim vetëm një shembull të udhëheqjes së hershme (të re) të Ehlul-Bejtit a.s (Familjes së Pejgamberit s.a.v.s) në rastin e Jahjas a.s-kur All-llahu xh.sh thotë:
  - “ O Jahja merre librin me shumë kujdes”, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë”. (Merjem, 12)
- Tani kur erdhëm në përfundim se udhëheqja në moshë të re, është shfaqje/paraqitje e vërtetë në jetën e Ehlul-Bejtit a.s, atëherë nuk mund të ketë më vërejtje për udhëheqjen e Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) e as për faktin se ishte shumë i ri kur e trashëgoi të atin e vet.

## **SI MUNDEMI TË BESOJMË NË EKZISTIMIN E EL-MEHDIUT**

- Në radhë është pyetja e katërt: Supozojmë se hipoteza mbi Prijësin e Caktuar dhe jetën e tij të zgjatur, si dhe udhëheqjen e tij, pastaj largimin e heshtur-është e mundshme, por nuk është si argument i mjaftueshëm për ekzistimin e tij. Ndaj, vërtet, në çfarë mënyre të besojmë në ekzistimin e Mehdiut?
  - A thua ndonjë rrëfim nga Libri mbi Pejgamberin e Madh s.a.v.s ka qenë i mjaftueshëm që neve plotësisht të na bind në ekzistimin e Imamit të dymbëdhjetë, përkundër veçantësisë së këtij supozimi dhe përjashtimit të tij prej rregullit? Apo, si mund të tregojmë se Mehdiu është personalitet i vërtetë historik, e jo vetëm supozim, personalitet për vërtetimin e të cilit vetëdija ekzistuese e njerëzve kërkon lidhshmërinë e rrethanave të ndryshme psikike?
  - Përgjigjja është: Ideja për Mehdiun si Prijës, Udhëheqës të pritur, i cili do ta ndryshojë botën për të mirë, është përmendur në disa hadithe të Pejgamberit s.a.v.s-hadithe këto të cilat flasin mbi Pejgamberin s.a.v.s në përgjithësi, kurse për Imamet e Ehlul-Bejtit në veçanti. Të gjitha këto hadithe, pa kurrfarë dyshimi, vërtetohen në

shumë tekste. Unë mund të numëroj afro 400 hadithe për Pejgamberin s.a.v.s, të cilët sot kanë mbërritur te ne, me anë të ndihmës së vëllezërve tanë sunnitë (p.sh libri mbi Mehdiun, të cilin e shkruajti daja im i nderuar Es-Sejjid Saduddin Es-Sadri (All-llahu e bekoftë shpirtin e tij!), si dhe një varg rrëfimesh mbi Imam Mehdiun nga ana e sunnitëve dhe shiitëve, për afërsisht afro 6000 (p.sh libri « Muntehabul-Eser fi Imani eth-thani asher » Përmbledhja e zgjedhur e rrëfimeve mbi Imamin e dymbëdhjetë, të cilin e ka shkruar Shejh Lutfull-llah Es-Safi), që s’do mend se paraqet numër jashtëzakonisht të madh.

- Sa i përket mishërimit të kësaj ideje mbi Imamin e dymbëdhjetë (Paqja qoftë mbi të!) ne posedojmë mjaft arsytetime të vërteta për vërtetueshmërinë se pikërisht ai është Prijës i zgjedhur (i shumëpritur). Argumentet në lidhje me këtë mund të ndahen në dy grupe; në ato

a) islame; dhe

b) shkencore.

- Grupimi islam vërteton ekzistimin e Prijësit të pritur. Kurse sa i përket grupimit shkencor, mund të tregojmë se Mehdiu nuk është vetëm mit apo supozim, por realitet i vërtetuar nga pikëpamja historike. Argumenti islam paraqitet nëpërmjet qindra haditheve mbi Pejgamberin s.a.v.s dhe Imamët e Ehlul-Bejtit a.s (Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë gjithnjë mbi ta!) të cilët hadithe qartë tregojnë se Mehdiu do të jetë i caktuar për Imam, se ai është njëri prej pasardhësve të Muhammedit s.a.v.s dhe të Fatimesë a.s, si dhe atë se ka dymbëdhjetë pasardhës të Pejgamberit s.a.v.s.

- Të gjitha këto rrëfime e kufizojnë atë idenë e përgjithshme (univerzale) duke e personifikuar me Mehdiun, Imamin e dymbëdhjetë të Ehlul-Bejtit a.s. Aq më tepër që, shumë janë të zgjeruara dhe në numër, edhe përkundër asaj se Imamët gjithnjë kanë qenë të drojtur dhe të kujdesshëm duke patur frikë në prezentimin publik të këtyre gjërave, duke dashur që përmes kësaj t’i ruajë pasardhësit e drejtë nga vuajtjet apo kërcënimet e paparashikuara ndaj jetëve të tyre.

- Mirëpo, numri i këtyre rrëfimeve nuk është shkak i vetëm i vlefshmërisë së tyre, ngase krahas kësaj ekzistojnë cilësi të caktuara dhe veçori të cilat duhet të kihen parasysh gjatë argumentimit të vlefshmërisë së tyre.

- Ekzistojnë hadithe të Pejgamebrit s.a.v.s mbi faktin se Imamë, halifë apo emirë, varësisht nga stili që është përdorur në hadith-gjithsej ka dymbëdhjetë. Disa shkrimtarë numërojnë më tepër se dyqind e shtatëdhjetë hadithe, të marra nga librat bukur mirë të njohura, Tirmidhiu, Ebu Davudi dhe përmbledhja e Ahmed ibn Hanbelit. Këtu duhet ta kemi parasysh se Buhariu, i cili i ka mbledhur këto hadithe, njëherit ka qenë bashkëkohanik i dy Imamëve-Hadiut dhe Askeriut-që mjaft domethënie ka, ngase kjo tregon se hadithet janë të shënuara drejtpërdrejtë nga Pejgamberi s.a.v.s, përpara se të kuptohet domethënia e tyre dhe të realizohet ideja e Imamit të dymbëdhjetë. Kjo do të thotë se nuk ka vend për dyshim se hadithet e shënuara (të mbledhurar) nuk kanë qenë nën ndikimin e “Imamit të dymbëdhjetë”, e as vështrim ndaj tij, ngase çdo hadith i këtillë i cili vjen nga Pejgamberi s.a.v.s është ose paralajmërim ose arsytim i asaj që do të ngjajë në periudhën e mëvonshme historike. Ata nuk kanë paraprirë me paraqitjen e tyre, por, përkundrazi në to gjithçka është shënuar në mënyrë të qartë dhe argumentuese. Këto hadithe vijnë nga ana e All-llahut xh.sh shprehur nëpërmjet gojës së Pejgamberit s.a.v.s dhe që përmbajnë, çiltërsi, sinqeritet dhe besueshmëri. Muhammedi s.a.v.s ka thënë:

- “Pas meje do të ketë dymbëdhjetë imamë”.

- Kjo fjalë e Muhammedit s.a.v.s edhe vërtetë u realizua, duke filluar nga Imam Aliu, e duke përfunduar me Mehdiun. Ky është komentimi i vetëm i kuptueshëm i këtij hadithi të Pejgamberit s.a.v.s.

- Sa i përket argumentit shkencor, ai është i karakterizuar me përvojën, jetën në bashkësinë njerëzore e cila ka zgjatur afro shtatëdhjetë vjet, të cilën ne e quajmë periudha e “Fshehjes së Vogël” (“Gajbetis-Sugra”). Për ta bërë këtë të qartë, do të japim në vazhdim një përshkrim të shkurtër.

- Kjo “Fshehja e Vogël” shënon fazën e parë të Imametit të Prijësit të pritur a.s. Nga momenti i caktuar, kur e mori rolin e tij, qëndroi i fshehur nga bota e jashtme. Larg nga gjithçka që ndodhte, por ama përsëri i afërt ndaj gjithçkaje me shpirtë dhe zemër.

- Gjithashtu vlen të kemi parasysh edhe faktin se, nëse në çfardo rrethane kjo fshehje do të ndodhte befasisht, një gjë e tillë do të shkaktonte shok (traumë) në mesin e popullit i cili besonte në Imamet, ngase ai (populli) ishte mësuar ta ketë imamin në çdo kohë, dhe këshillat e tyre për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Ndaj në qoftë se befas (papritur) do të largohej, ithtarët e tij do të kishin ndjenjën e shkëputjes nga lideri intelektual dhe shpirtëror. Një ngjarje e këtillë do të shpiente drejt jazit të madh i cili do ta shkundte tërë strukturën dhe unitetin e saj. Prandaj, ishte e domosdoshme që kjo fshehje të ndodhë gradualisht, me qëllim që populli të mësohej me të dhe gradualisht t’i përshtatej situatës së re.

- Kjo edhe ndodhi, kështu që Imam Mehdiu gjatë “Fshehjes së Vogël”, u tërhoq nga jeta shoqërore, duke qëndruar në kontakt me popullin dhe ithtarët nëpërmjet emisarëve të tij dhe shokëve të vet më besnikë, të cilët njëherit edhe ishin lidhja në mes Imamit dhe atyre që besonin në drejtimin e tij.

- Pozitën e përfaqësuesit të Imamit në këtë kohë e kishin katër personalitete, të cilët populli i pranoi për shkak të frikës së tyre ndaj All-llahut xh.sh, devotshmërisë (takvallëkut) dhe sinqeritetit.

Ata ishin:

1. Osman ibn Said El-Amri,
2. Muhammed ibn Osman ibn Said El-Amri,
3. Ebul-Kasim El-Husejn ibn Ruhi dhe
4. Ebul-Hasan Ali ibn Muhammed Es-Samurri.

- Sipas kësaj renditjeje ata kryenin edhe rolin e përfaqësuesit të Imamit a.s. Kur njëri nga ta vdiste, tjetri menjëherë e trashëgonte, pasi që Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!) ia jepte këtë detyrë.

- Përfaqësuesi i Imamit e mbante lidhjen me shiitët dhe pyetjet e tyre ia drejtonte Imamit, duke u kthyer me përgjigjet e marra prej tij. Ndonjëherë ato ishin gojore, ndërsa shumë rrallë përgjigje të shkruara. Në këtë mënyrë, përmes kësaj lidhjeje ndërmjetsuese, njerëzit në pamundësi për ta parë Imamin e tyre, gjenin kënaqësi dhe prehje të caktuar.

- Aq më tepër që, gjatë shtatëdhjetë viteve në të cilat jetuan këto katër përfaqësues të Imamit, njerëzit qartë mund të binin në përfundim dhe të vërenin se edhe nënshkrimi dhe shkronjat gjithnjë ishin po të njëjtat. Përfaqësuesi i fundit i Imamit- Es-Samurri, shpalli se koha e “Fshehjes së Vogël”, në të cilën ishin caktuar përfaqësuesit-të cilët e mbanin lidhjen mes Imamit dhe popullit, përfundoi dhe se tani e tutje filloi periudha e “Fshehjes së Madhe” në të cilën nuk do të ketë më ndërmjetësues apo përfaqësues në mes të Imamit dhe shiitëve. Kalimi në këtë gjendje do të thoshte se “Fshehja e Vogël” veçmë e kishte arritur synimin, ngase shiitët i kishte shndërruar në rezistent ndaj shokut (traumës) të madhe dhe jazin e gjerë i cili do të rridhte si pasojë e kësaj, si dhe ata (shiitët) iu adaptuan situatës së re të sapokrijuar dhe gradualisht u përgatitën ta pranojnë idenë e përfaqësimit të përgjithshëm në emër të Imamit. Në vend të individit i cili ishte përcaktuar ta përfaqësojë Imamin, tani filloi së ekzistuari lidhja e përgjithshme e mishëruar në

muxhtehidin e drejtë (dijetarin e aftë të sjellë gjykime vetanake përkitazi me disa pyetje), i cili ka peshë të thellë në çështjet fetare dhe ato të kësaj bote te muslimanët, kuptohet pas kalimit të Imamit a.s nga “Fshehja e Vogël” në “Fshehjen e Madhe”.

- Tani besoj se mund të keni fotografi të qartë mbi atë që diskutuam deri më tani, dhe të kuptojmë se Mehdiu është realitet të cilin e përjetoi një bashkësi njerëzore dhe i cili zgjati 70 vjet, duke u manifestuar nëpërmjet përfaqësuesve të Imamit, për të cilën gjë askush nuk mund të dyshonte, se dikush gënjente apo lozte me fjalë.

- Po vallë a thua mund të paramendoni se gënjeshtria e cila zgjati afro shtatëdhjetë vjet, për mrekulli do ta përmbanin dhe me të pajtohen katër njerëz, si dhe të jetojnë mbi bazat e saja sikur të jetë e vërtetë? Dhe asgjë të mos ju del jashta kontrollit dhe asgjë të mos bëjnë që njerëzit t’i cyste të dyshojnë në ta? Që asnjëfarë lidhjeje e veçantë të mos ekzistonte në mes atyre të katërtëve, nëpërmjet asaj që fitonin besimin e të gjithëve, dhe besimin në të vërtetën e asaj për të cilën thonin se jetojnë madje?

- Një fjalë e urtë e moçme thotë: “Gënjeshtria i ka këmbët e shkurtëra”. Edhe logjika e jetës vërteton se është e pamundshme që gënjeshtria të ekzistojë në këtë mënyrë dhe përgjatë gjithë kohës të qëndrojë, dhe përsëri ta ketë besimin e çdokujt...

- Kështu periudha e “Fshehjes së Vogël” mund të shqyrtohet si eksperiment shkencor, me anë të cilit vërtetohet besueshmëria e faktit mbi ekzistimin e Imamit, lindjen e tij, jetën dhe fshehjen, për të cilën është fshehur nga bota dhe akoma askujt nuk i është shfaqur/zbuluar.

## **PËRSE PRIJËSI AKOMA NUK ËSHTË SHFAQUR?**

- Përse gjatë kësaj periudhe të gjatë, Prijësi nuk është shfaqur? Nëse vërtet është i përgatitur që ta kryejë detyrën e tij shoqërore, çfarë e ka penguar që të mos paraqitet gjatë periudhës së “Fshehjes së Vogël” (në vend që e njëjta të vazhdohet) apo pas saj, kur kushtet për çfardo qoftë detyrë ndryshimi shoqëror ishin më të lehta dhe më të thjeshta, kurse lidhjet mes udhëheqësit dhe njerëzve, falë vetë natyrës së “Fshehjes së Vogël”-ishin të tilla që mundësonin formimin e lëvizjes dhe fuqishëm realizimin e detyrës. Gjithashtu, as pushteti i atëhershëm nuk posedonte forcë dhe fuqi të këtille që posedon pushteti i sotshëm, e cila është arrijtur falë zhvillimit teknik dhe atij shkencor.

- Përgjigjja është si vijon: Suksesi i çdo lëvizjeje e cila ka për synim ndryshimin shoqëror, është e lidhur me kushte të caktuara dhe rrethana objektive-pa të cilat realizimi i së cilës është i pamundshëm.

- Mirëpo, të gjitha këto ndodhi, të cilat si obligim vijnë nga Zoti, janë të shënuara me faktin se përmbajtjet e porosive nuk janë të lidhura me çfardo qoftë rrethana objektive. Meqë porosia nga e cila mvaret tërë veprimtaria është nga Zoti, dhe meqë në të nuk kanë ndikim kurrfarë rrethana objektive, por ajo, në të vërtetë mbështetet në to, vetëm në aspektin kryerës dhe kohor, është dashur të kalojnë pesë shekuj të paditurisë (injurancës) derisa porosia e fundit i është dorëzuar peygamberit të fundit-Muhammedit (Paqja dhe shpëtimi i All-llahut qofshin gjithnjë mbi të dhe familjen e tij!). Shkaku i kësaj është lidhja që duhet të ekzistojë në mes rrethanave objektive dhe atyre kryerëse. Ky ishte shkaku i vonimit, ndaj edhe bota (njerëzimi) priste shumë gjatë në porosinë e Zotit.

- Nga mesi i rrethanave objektive, të cilat kanë ndikim në pjesën kryerëse të ndryshimeve janë ata të cilat krijojnë klimë të favorshme dhe atmosferë të

përgjithshme për ndryshimin i cili duhet të ndodhë, gjersa të tjerat janë disa detaje që duhen për zhvillimin e po të njëjtit ndryshim.

- P.sh në kryerjen e ndryshimeve që i udhëhoqi Lenini në Rusi, faktorë i rëndësishëm i cili ishte i lidhur me të, ishte Lufta e Parë Botërore dhe rënia e fuqisë së carit të atëhershëm rus. Pikërisht këto, luajtën rol kryesor në krijimin e atmosferës së duhur për realizimin e saj (fjala është për revolucionin bolshevik të Tetorit të vitit 1917, vërej e përkth). Ekzistonin edhe faktorë të tjerë të cilët kishin ndikim të pjesshëm, nga të cilët po përmendim p.sh shëndetin e Leninit gjatë udhëtimit dhe ardhjes në Rusi, pastaj gjatë Revolucionit, ngase po të ndodhte ndonjë e papritur në udhëtimin e tij, do të vinte deri te shtyerja (pezullimi) dhe Revolucionin nuk do të shkonte rrjedhës së duhur.

- Mirëpo, tradita e pandryshueshme e Zotit, në çdo mënyrë procedimi hyjnor të ndryshueshëm vazhdonte, kështu që në pjesën zbatuese ajo gjithnjë mbështetej në rrethanat objektive të cilat krijojnë klimë të përgjithshme për sukses të saj. Nga kjo ndodhi që Islami të shfaqet te pas një jazi të madh dhe një periudhe të gjatë kohore e cila zgjati me shekuj.

- Edhe pse All-llahu i Lartëmadhëruar mundeshte t'i tejkalojë të gjitha pengesat dhe vështirësitë të cilat haseshin në rrugën e realizimit të porosisë së Zotit, edhe pse atmosferën ekzistuese mund ta ndryshonte me mrekulli... Megjithatë, All-llahu i Lartëmadhëruar zgjodhi rrugë tjetër, ngase sprovat, hekat dhe ndjenjat, të cilat e përbëjnë qenien njerëzore të përsosur, kërkonin që detyra e Zotit të jetë e bërë dhe realizuar natyrshëm dhe në mënyrë objektive.

- Mirëpo, kjo nuk e pengoi All-llahun e Lartëmadhëruar që, kohë pas kohe të përzihet, jo që me disa detaje ta karakterizojë klimën gjegjëse, por që të mundësojë lëvizje të lehtë në të. Rast i këtillë ndodhi p.sh kur All-llahu i Lartëmadhëruar u ndihmoi peygamberëve të tij në momentet e vështira, me qëllim të ruajtjes së vetë Porosisë. Kështu që befaz zjarri i Nemrudit u ftoh dhe Ibrahim i a.s nuk është më në rrezik. Pastaj, dora e tradhtarit mbeti e paralizuar (shtangur) dhe e humbi fuqinë për goditje me shpatë drejt dorës së Peygamberit s.a.v.s, rast tjetër është kur fortuna e papritur i mori tendat e mosbesimtarëve dhe mushrikëve të cilët kishin rrethuar qytetin e Medinës, në ditën e Luftës së Jevmul-Hendek. Mirëpo, të gjitha këto ndodhi nuk ishin asgjë më tjetër pos dhënies ndihmë në çastet vendimtare, kur atmosfera gjegjëse veçmë ishte krijuar për realizimin e shkollave të ndryshimit në mënyrë natyrore dhe në pajtim me rrethanat objektive.

- Nën dritën e këtij këndvështrimi mund ta shqyrtojmë pozitën e Mehdiut, me qëllim që të mund të vërejmë se mënyra e ndryshimit, për të cilën ai është përgatitur, ashtu siç janë edhe lëvizjet e tjera të ndryshimeve shoqërore, të lidhura, në aspektin realizues me rrethanat objektive-të cilat sigurojnë kushte përgjegjëse për realizimin e atyre ndryshimeve.

- Gjithsesi duhet ta kemi ndërmend se Mehdiu nuk është përgatitur për asnjëfarë roli shoqëror të kufizuar, e as për ndryshimin i cili do të realizohet vetëm në një vend të caktuar të botës. Roli të cilin All-llahu ia ka dhënë është gjithëpërfshirës me destinacion të ndryshimit të tërë botës dhe kthimin e njerëzimit nga errësira e mëkateve drejt dritës së drejtësisë. Mirëpo, megjithatë për këtë ndryshim të madh nuk është e mjaftueshme të ekzistojë porosia dhe prijësi, ngase deri tek ndryshimi atëherë do të kishte ardhur qysh në kohën e Peygamberit s.a.v.s. Por, për të (ndryshimin) nevojitet klimë e përshtatshme në tërë botën dhe atmosferë e përgjithshme e cila do t'i përmbushë të gjitha rrethanat e domosdoshme për realizimin e tij.

- Nga aspekti i pikëpamjes njerëzore, do të duhej ta merrnim parasysh ndjenjën e stërholluar, të cilën e ka njeriu i civilizuar, nga ajo është fakti themelor për krijimin



e klimës së përgjegjshme me anë të së cilës hapet rruga për pranimin e porosisë së re dhe të drejtë. Kjo ndjenjë është rrënjësore në shumë drejtime civilizuese, nga ku njeriu del i stërngarkuar me refuzimin e asaj ekzistuese, ndaj edhe për shkak të kësaj, kthehesh drejt asaj që nuk e sheh dhe nuk e njeh.

- Nga pikëpamja materiale, është e mundshme që kushtet e sotshme të jenë të favorshme për kuptimin e synimeve të porosisë anekënd botës, nga kushtet të cilat kanë ekzistuar në periudhat e mëparshme, siç është p.sh periudha e “Fshehjes së Vogël”. Janë më të favorshme falë largësive më të shkurtëra dhe vënies së lehtë të lidhjeve mes popujve të ndryshëm të botës, si dhe mjeteve disponuese të cilat i nevojiten organizatës qendrore për ta realizuar programin e saj të arritjes së nivelit të lartë të vetëdijes tek popujt e ndryshëm dhe arsimimin/edukimin e tyre mbi themelet e porosisë së re.

- Megjthatë, ajo çfarë këtu na u tregua, e që është fakt, gjithsesi është rritja e fuqisë ushtarake-deri tek e cila mbërrihet gjithnjë-kur është shtyrë paraqitja e Prijësit. Mirëpo, çfarë arrihet me këtë, nëse shpirti i njeriut veçmë ka përjetuar disfatë shpirtërore, kështu që ai që e posedon atë fuqi, do të ballafaqohet në fund-me shkatërrimin shpirtëror?

- Me të vërtetë historia dëshmon se madje edhe ekspeditat e vogla pushtuese kanë shkaktuar shkatërrimin e madh të strukturës së mbarë qytetërimin. Kjo ka ngjarë, ngase ajo ka filluar të shkatërrohet dhe ta humbasë besimin në ekzistimin e vet dhe realitetin.

## **A MUNDET QË INDIVID I TË LUAJ NJË ROL TË TILLË?**

- Në rradhë është pyetja vijuese: A mundet që individ, sado që të jetë i madh, të luajë një rol kaq të rëndësishëm? A thua nuk është i madh vetëm ai individ të cilin e rretojnë ndodhitë dhe i cili ballafaqohet me lëvizjet e tyre?

- Kjo ide ka lidhje me shikimin/pikëpamjen e veçantë në histori-sipas së cilës njeriu është vetëm faktor sekundar në rrjedhën e saj, kurse bazë është fuqia objektive me të cilën është i rrethuar. Në këtë pikëpamje, individ-në rastin më të mirë-mund të jetë shprehje e mençur e saj.

- Mirëpo, në kapitullin paraprak të këtij libri dhe librave të tjerë që i kemi botuar, këtë temë e kemi sqaruar, duke thënë se historia ka dy shtylla: e para është njeriu, kurse e dyta: fuqia materiale me të cilën është i rrethuar. Dhe... përderisa fuqia materiale, kushtëzon prodhimtarinë dhe natyra ndikon në njeriun, ai gjithashtu ka ndikim në to. Aq më tepër që, nuk ka argumente për supozimin se ndodhitë fillojnë nga shkaqet materiale, dhe përfundojnë me njeriun, përpos kur ekziston argument për këtë, ngase të dy faktorët ndikojnë njëri ndaj tjetrit në kohë. Ndaj, individ nuk e ka të domosdoshme t’u përmbahet rregullave të vendosura përgjatë historisë, veçanërisht nëse e marrim parasysh raportin e tij me Zotin, ngase Ai, si faktor përcaktues, merr pjesë në ndodhitë (ngjarjet). Kjo gjatë historisë u ka ndodhur të gjithë pejgamberëve, e sidomos të fundit, ngase për shkak të lidhjes së tij me Zotin, pejgamberi Muhammedi s.a.v.s vetë e mori drejtimin e rrjedhës së historisë dhe filloi me zhvillimin e hovshëm të qytetërimin, që në rrethanat ekzistuese me të cilat ishte i rrethuar, në asnjë mënyrë nuk do të mundej t’i realizonte (kuptohet, pa ndihmën e Zotit) ashtu siç edhe e përmendën në hyrjen “El-Fetva El-Vahida-së.

- Ndaj ajo që ka mbërritur Pejgamberi i Madh s.a.v.s mund t'i ndodhë edhe Prijësit të Pritur, i cili vjen (rrjedh) nga loza e tij, dhe ardhja e roli i të cilit janë shpallur.

### **SI DO TË VIJË TE NDRYSHIMET NË DITËN E CAKTUAR?**

- Në rradhë është pyetja e fundit në kallëzimin e asaj se si fitorja vendimtare e drejtësisë do të vie dhe çfarë fundi do të përjetojë destruktiviteti me të cilin Prijësi i pritur do të ballafaqohet?

- Një pjesë nga kjo pyetje i përket diturisë për kohën dhe periudhën kur Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!) duhet të paraqitet, si dhe për mundësinë e veçorisë së supozimit dhe lidhshmërinë e raporteve të cilat mund ta karakterizojnë atë periudhë. Kështu që do të mund të japim një tabelë në të cilën, ndryshimet do të ndodhin dhe shtegut të cilit do të ecin.

- Mirëpo, derisa nuk dijmë asgjë për atë periudhë, rrethanat e saja, shkencërisht nuk mundemi të parashikojmë se çfarë do të ndodhë në “Ditën e Caktuar” edhe pse për këtë mundemi të rezonojmë dhe supozojmë, por ama në baza teorike e jo në ato të vërteta.

- Në bazë të rrëfimeve të theksuara dhe ndryshimeve të mëdhaja, të cilat kanë ndodhur gjatë historisë-ekziston një supozim themelor-të cilin mundemi ta marrim, e kjo është paraqitja e Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) pas jazit të madh i cili do të përfundojë me shkatërrimin shokant dhe krizën e civilizimit. Ky jaz do të mundësojë që porosia të përhapet, kurse civilizimi shtypës (agresiv) të shkatërrohet.

- Mirëpo, ky shkatërrim nuk është i rastësishëm i cili në historinë e civilizimit njerëzor do të ndodh rastësisht, ky është rezultat i natyrshëm i kundërshtive të cilat kanë ndodhur në civilizimin, i cili është shkëputur nga All-llahu i Lartëmadhëruar, civilizim i cili nuk është në gjendje ta arrijë pikën përfundimtare të rrugëtimit të vet, ndaj edhe mu për këtë do të digjet (shkatërrohet) duke mos lënë asgjë pas vetes. Mandej, pas kësaj do të shfaqet (paraqitet) drita e drejtësisë së Zotit në tokë.

## DRITA E FUNDIT

### PARATHËNIE

- Festimi madhështor, dinjitoz i pesëmbëdhjetë Sha'banit po përgatitet gjithkund.
- Gjithçka është e zbukuruar. Gjithandej mund të shihen grupe njerëzish të gëzuar dhe të buzëqeshur, të mbushur plot me hare...
- Dhe vërtet, a ekziston ditë tjetër të cilën njerëzit e festojnë me kaq përmallim dhe entuziazëm?
- Pesëmbëdhjetë Sha'bani është dita që shiitët e festojnë si ditë të përmbushjes së porosive të peygamberëve të Zotit.
- Kjo është dita në të cilën porosia e Islamit, Kur'anit, Hadithit dhe imamëve të pagabueshëm do të realizohet. Në ditëlindjen e tij, drejtësia e tij do të përfshijë edhe Lindjen edhe Perëndimin, dhe ai (Mehdiu a.s) nëpërmjet dorës së tij të fuqishme do t'i shkatërrojë demonët (shejtanët, ifritët) padëgjueshmërinë dhe mosbesimin (kufrin).
- Në atë ditë pushteti i margaritarit të fundit të All-llahut xh.sh do të vendoset në sipërfaqe të Tokës. Ai është i cili do ta përfundojë luftën e gjatë mes të vërtetës dhe gënjeshtërs. Paraqitja (shfaqja) e tij do të thotë fitore e të vërtetës, dhe shkatërrim i gënjeshtërs.
- Ai është i cili me ndihmën dhe vullnetin e All-llahut xh.sh do t'i mposhtë mësimet e dobëta (të shtrembërta) dhe do t'i përmbush synimet e Pejgamberit të fundit Muhammedit (Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë gjithnjë mbi të dhe familjen e tij!)
- Ai është i cili do t'i zhdukë dallimet klasore mes të gjithë njerëzve në botë. Ai të varfërve do t'ua mundësojë të shërbehen me begatitë e tokës dhe do ta bëjë që kjo t'ua mjaftojë.
- Vala e madhe e begative (mirëqenies) dhe lumturisë atëbotë do të shkaktojë të dalin (shpërthejnë) lotë në sytë e njerëzve, kurse sytë e atyre që janë të mallëngjyer dhe të përvuajtur e që janë duke e pritur ardhjen e tij, do t'i mbushë me dritë-shkëlqim.
- Ideja mbi Mehdiun është besimi më themelor Islam, të cilin do ta pranojë madje edhe ai i cili ka njohuri të kufizuara (të pakta) mbi Islamin.
- Pasi që është obligim i çdo muslimani të dijë (ketë njohuri) mbi "Prijësin e Pritur"-imam Muhammed El-Mehdiun (Paqja qoftë mbi të!), këtu jemi përpjekur, edhe pse fare shkurt, të mësohet historia e shkurtër e besimit themelor dhe të prezentohet në pika të shkurtëra jeta e Huxhhetul- Hakku-t (Argumentit të Vërtetë të All-llahut).
- Mbetemi me shpresë se kjo "përmbledhje" e varfër, si dhuratë modeste, do të pranohet nga ana e "Solomonëve" të të gjitha kohërave!

*Më 15 Sha'ban 1396.*

## LAJMET E MIRA

- Nuk ka dyshim se Kur'ani i Madhnueshëm është Libri i All-llahut dhe të gjithë muslimanët e botës e pranojnë dhe i ndjekin mësimet e tij.
- Kur e hapim Librin (Kur'anin) dhe i shohim ajetet e tij, fitojmë një fotografi të qartë, e cila na rrëfen për ngjarje jo të rëndomta (të jashtëzakonshme) dhe dramatike që do të ndodhin në të ardhmen si dhe për fundin e botës.
- Kur'ani i Madhnueshëm thotë se misioni final i Pejgamberit të Islamit është që kjo fe e lartësuar (Islami) t'i mbisundojë të gjitha fetë tjera botërore; dhe vërtet: Një ditë kjo aspiratë e lartësuar do të plotësohet, ashtu siç është thënë edhe në Kur'anin e Madhnueshëm.
- « Ai (All-llahu) është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejtën idhujtarët. » (Et-Tevbe, 33)
- Libri hyjnor i Pejgamberit të Fundit s.a.v.s përmend se pushteti në tokë, në fund, do t'u takojë të drejtëve dhe atyre që besojnë në All-llahun xh.sh.
- ... “S'ka dyshim se toka është e All-llahut, ia lë në trashëgim atij që do nga robtë e Tij, (ndërsa) e ardhmja e lumtur është për të devotshmit”. (El-Ar'afë, 128)
- Toka e mbushur përplot me destruktivitet, amoralitet dhe injorancë, sikur një trup i pajetë, do të rringjallet me dritën e drejtësisë, ashtu siç është shënuar në Kur'an.
- Në Kur'an gjithashtu lexojmë edhe këtë në vijim:
- “ Atyre nga mesi i juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë, ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre, dhe fenë të cilën Ai e pëlqen për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë... (En-Nurë, 55)
- All-llahu i Lartëmadhëruar gjithashtu thotë:
- “ Ata duan ta shuajnë dritën e All-llahut me gojët e tyre, po All-llahu e plotëson (e përhap) dritën e Vet, edhe pse e urrejnë jobesimtarët”. (Es-Saff, 8)
- Këto janë vetëm disa shembuj të shkurtër nga porositë e All-llahut në Kur'an. Me studjimin e këtyre dhjetë ajeteve si dhe ajeteve të tjera, mund të vërejmë se porosia e Islamit do të përmbushet kur do të vie deri tek arritja e këtyre synimeve dhe aspiratave të larta. Të gjitha synimet e trilluara dhe bestytnitë do të zhduken, vetëm Islami-feja e vetme dhe e vërtetë-do të mbesë dhe në te njerëzit do të besojnë edhe në Lindje edhe në Perëndim. Padrejtësia, poshtërimi dhe jobarazia do të zhduken, dhe gjithkund do të vendoset drejtësia dhe barazia-të cilat janë ligj i krijimit të botës. Në të gjitha viset e botës do të vendoset superioriteti i halifëve të Zotit. Drita e udhëheqjes së All-llahut do të shkëlqejë, kurse toka do t'u takojë falënderuesve.
- Po, Kur'ani i Madhnueshëm sjell lajme të mira për ditën e cila do të vije dhe të cilën të gjithë muslimanët e botës mezi e presin që të ndodhë.
- Krahas Kur'anit të Madhnueshëm, hadithet e Pejgamberit s.a.v.s dhe thëniet e Imamëve të ndershëm janë thesari më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm i mësimave islame. Për secilin musliman obligim i domosdoshëm është ndjekja dhe dëgjimi i thënieve të Pejgamberit s.a.v.s dhe Imamëve, ngase kjo posaçërisht është përmendur edhe në Librin e All-llahut xh.sh.
- Në detin e madh të margaritarëve të thënieve islame, gjenden edhe porositë mbi Udhëheqjen e Drejtësisë. Aq më tepër që përmendet veçanërisht “Revolucioni Hyjnor” dhe Prijësi i cili do të sjell deri te arritja e këtij “Revolucioni”.
- Pejgamberi i Islamit s.a.v.s ka thënë:
- “ Qoftë edhe nëse do të kalonte koha e ekzistimit të botës, dhe do të mbetej vetëm edhe një ditë gjer në “Ditën e Kijametit, All-llahu do ta zgjaste atë ditë aq sa do

të nevojitej deri tek ardhja e sundimit të atij që do të vijë nga familja ime, dhe do të ketë emrin tim (Ebul-Kasim). Ai pastaj do të bëjë që paqja dhe barazia të mbisundojë botën, ashtu siç dikur në të mbisundonte padrejtësia dhe tirania, para tij”. (1)

- Përmbajtja e kësaj thënie të çmuar, zbulon para së gjithash, lajmet e mira dhe i paralajmëron njerëzit për SUNDIMIN E DREJTË, realizimin e Premtimeve të Zotit, e njëjta që përmendet në burimet e shumta shiite dhe sunnite.

- Në një thënie tjetër, Pejgamberi s.a.v.s iu drejtua Emirul-Mumininit, Ali ibn Ebu Talibit me fjalët:

- “Do të ketë dymbëdhjetë Prijës (eimme) pas meje, nga të cilët i pari je ti o Ali, kurse i fundit do të jetë “Mbështetësi” (El-Kaim), i cili me mëshirën e All-llahut të Lartëmadhëruar, do të mbisundojë edhe në Lindje edhe në Perëndim.” (2)

- Imamët e ndershëm në disa thënie i përkujtojnë njerëzit në rëndësinë (peshën) e premtimit të Zotit dhe Sundimin e Imamit të dymbëdhjetë, duke folur se vepra e më madhe është pritja e Shpëtimtarit të Madh, dhe se ata të cilët e bëjnë këtë dhe i janë lojal atij, janë njerëzit më të mirë dhe më të dashur. Do të ishte e mjaftueshme që këtu të përmendim, p.sh, vetëm disa nga këto thënie (rrëfime):

- 1) Imam Hasan El-Muxhteba luftoi kundër dyftryrëshit-Muaviut, i cili nëpërmjet ndihmës së mëkëmbësit të tij-ia doli që t’i gënjejë miqët e Imamit, ndaj ata edhe e braktisën Imamin. Nisur nga kjo Imami ishte i detyruar të bëjë marrëveshje paqeje me Muaviun, sipas së cilës detyrimet e Muaviut ishin kryerja e disa detyrave, dhe përmbajtja për caktimin e zëvendësit dhe largimi prej luftimeve të mëtutjeshme. Ngandonjëherë Imami (Hasani, biri i Aliut) e shfrytëzonte rastin dhe u tregonte njerëzve për gabimet dhe veprat jo të drejta të Muaviut.

- Në ndërkohë disa njerëz të padijshëm filluan ta kritikojnë Imamin për shkak të marrëveshjes së paqes të bërë me Muaviun! Imam Hasani (Paqja qoftë mbi të !) ua shpjegoi njerëzve rolin e Imamit dhe udhëheqësit, dhe domosdoshmërinë e dëgjueshmërisë së çdo urdhëri të tij pa parashtrimin e asnjë pyetjeje. Pastaj ua shpjegoi sundimin e Imamit të dymbëdhjetë, duke u thënë:

(1) “Muntehabul-Eser”, Lutfull-llah Safi Gulpajigani, pjesa e tretë, kapitulli 1.

(2) Ibid, pjesa e parë, kapitulli 4

- “A nuk e dini se secili prej nesh (imamëve) ka përgjegjësi që nga shtypësi (tirani) i kohës së tij-të kërkojë betimin për besueshmëri, përveç “Mbështetësit” (El-Kaim) pas të cilit është Shpirti i All-llahut (Isa); All-llahu i Plotëfuqishëm lindjen e tij (Imamit të dymbëdhjetë) do ta ruajë si fshehtësi prej disa njerëzve, dhe nuk do t’ua mundësojë që ta shohin. Kur të shfaqet, Ai nuk do të ketë nevojë ta pranojë betimin prej askujt. Ai është pasardhësi i nëntë i nipit tim Huseinit, djalit të princezës, robëreshë. All-llahu i Plotëfuqishëm do ta zgjasë periudhën e tij jetësore gjatë fshehjes, Ndaj Ai kur do të paraqitet, do të duket si njeri i moshës dyzetvjeçare, dhe njerëzit do të mësojnë nga kjo se All-llahu, vërtetë ka pushtet/fuqi mbi të gjitha gjërat”. (1)

- Imam Xhafer Es-Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) në pyetjen që ia bëri njëri prej ithtarëve të tij, iu përgjigj si vijon:

- Imami që mua do të më trashëgojë do të jetë djali im Musai, kurse Imami i Pritur do të jetë Muhammed ibn Hasan ibn Ali ibn Muhammed ibn Ali ibn Musa”. (2)

- Po të njëjtit Imam (Xhafer Es-Sadikut) i përkasin edhe këto fjalë, të cilat shpesh i përsëriste: “Çdo grup pret ndonjë udhëheqësi, kurse ne presim udhëheqjen (sundimin) i cili do të vendoset kur të vijë fundi i botës”.
- Imami i shtatë fisnik Musa ibn Xhaferi (Paqja qoftë mbi të!) në përgjigjen ndaj pyetjes së njërit prej shokëve të tij se a është ai “El-Ka’im bil Hakk” (“ Ai i cili është mbështetur në të vërtetën) tha:
  - “Po unë jam El-Ka’im bil-Hakk, mirëpo ai Ka’im që do të vijë t’i largojë të gjithë armiqtë e All-llahut në tokë dhe ta mbushë tokën me barazi dhe drejtësi do të jetë pasardhësi im i pestë. Pasi që do të ketë frikë për jetën e tij, shumë gjatë do të jetë i fshehur, dhe në atë periudhë (fshehjeje) do të ketë grupe njerëzish të cilët do ta refuzojnë, por edhe grupe të cilat fort do të besojnë në të”; Dhe më pas shtoi:
    - “Qofshin të bekuar pasardhësit tanë (shiitët), të cilët gjatë periudhës së fshehjes (gajbetit) të Imamit të Fshehur do ta mbajnë pushtetin tonë (velaje) dhe do të qëndrojnë larg prej armiqëve tanë. Ata e kanë pranuar udhëheqjen tonë, kurse ne jemi të kënaqur me përkushtimin e tyre. Andaj janë edhe të bekuar. Beto hem në All-llahun se ata do të jenë me ne edhe në Xhennet”. (4)
    - 4). Dhe në fund të përmendim Imamin e njëmbëdhjetë Hasan El-Askeriun (Paqja qoftë mbi të!) i cili ka thënë: “Shoh se pas vdekjes sime në mesin tuaj do të mbretërojnë dallimet, në lidhje me Imamin pas meje. Ai që pranon imamë pas Pejgamberit s.a.v.s, kurse e mohon birin tim, është njësoj sikur ai i cili i pranon të gjithë pejgamberët, por jo edhe të fundit, pejgamberin-Muhammed, Paqja dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!- Kurse kush e mohon Pejgamberin e All-llahut Muhammedin, i ka mohuar të gjithë pejgamberët e tjerë të All-llahut xh.sh ngase të respektuarit e të fundit prej nesh (imamëve) është njësoj si respektimi i të parit, kurse nëse e mohon të fundit, e ke mohuar edhe të parin.

(1) Ibid, pjesa 2, kapitulli 4.

(2) Ibid, pjesa 2, kapitulli 21.

(3) El-Aëmal, Esh-Shejh Es-Sadik, f. 489

(4) “Isbetul-hudat”, Esh-Shejh Hurr El-Aëmal, vëllimi 6, f. 417

Por, kujdes! Djali im do të jetë i fshehur periudhë gjatë së cilës njerëzit do të dyshojnë përveç atyre të cilët All-llahu xh.sh do t’i mbrojë”. (1)

- Thëniet e Pejgamberit s.a.v.s dhe imamëve të pagabueshëm lidhur me këtë parim fetar të rëndësishëm janë mjaft të shumta, kështu që neve bukur mirë na paralajmëron për këtë. Mund të thuhet se në përmbledhjet shiite numri i rrëfimeve në lidhje me tematikën e imametit janë më të shumta.

- Shqyrtimi i udhëheqjes së Imamit të dymbëdhjetë, sundimit të tij dhe gjithçkaje që ka të bëjë me të, vjen menjëherë pas trashëgimisë së Imam Aliut, Prijësit të besimtarëve (Emirul-Mumininit)-Paqja qoftë mbi të! Ekzistojnë qindra rrëfime të këtilla, të cilat janë të përmbledhura si në burimet shiite ashtu edhe në ato sunnite. (2) Numër i madh i dijetarëve muslimanë prej të gjitha drejttimeve, pavarësisht njëri prej tjetrit, kanë bërë libra përkitazi me këtë temë. (3) Madhësia e tyre arrinë edhe deri në dhjetë vëllime.

- Vitet e udhëheqjes së Imamëve kalonin bashkë me tiraninë e sunditarëve të cilët ishin bashkëkohës të tyre, deri tek udhëheqja e Imam El-Askeriut (Paqja qoftë mbi të!) Ky imam fisnik jetoi në rrethana mjaft të vështira, fare pak duke u shfaqur në tubimet publike. Djali i tij i dashur, i cili është argument i fundit i Zotit, ishte i fshehur

nga sytë e të huajve gjer në vitin 260 sipas hixhretit, kur shkëlqyen rrezet e qenies së tij, ndërsa të gjitha shikimet ishin të kthyer kah Imam Mehdiu.

(1) Ibid, fq 427

(2) Disa prej këtyre transmetimeve janë tubuar në librin mjaft të vlefshëm “Muntehabul-Eser-fi Imami eth-thani asher alejhisselam”, nga Lutfulla Shafi Gulpajigani.

(3) Indeksi i shkurtër i këtyre librave mund të gjendet në librin “En-Nexhmus-Sakib”, të Mirza Husejn Tabersit.

## LINDJA E IMAM MEHDIUT

- Në agim të pesëmbëdhjetë sha’banit të vitit 255 sipas hixhretit, shndërriti shkëlqimi i fuqishëm në formën e njeriut, i cili u bë burim i ekzistencës së gjithësisë (universit).
- Po, më në fund u përmbush premtimi i Zotit dhe u lind Imam Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!), përkundër të gjitha përpjekjeve të atyre që nuk e pranonin.
- Kjo është njëra prej çudirave historike që emevitët, abasitët dhe kundërshtarët e tjerë të Imami të bekuar, orvateshin që ta shuajnë këtë dritë të Zotit, por që përjetuan dështim total...
- Fisi i tmerrshëm dhe tiran i Beni Abbasëve, dëgjoji se Imami i dymbëdhjetë shiitë do ta vendosë sundimin e drejtë dhe do ta sundojë gjithë botën, kurse padrejtësia do ta shkatërrojë që nga themelet.
- Ndaj, për të ndaluar këtë ndodhi, filluan t’i mundojnë shiitët dhe ta derdhnin gjakun e tyre sado që kishin mundësi. Për gjendjen në të cilën ndodheshin shiitët, për vuajtjet dhe torturimet e tyre, më së miri mund të mësohet në leximin e librave që trajtojnë këtë tematikë. (1)
- Në vitin 235 sipas hixhretit, Mutevekkili, halifi abasid, urdhëroi që Imami i dhjet Muhammed El-Hadiu (Paqja qoftë mbi të!) dhe familja e tij, të transferohen prej Medinës në qytetin e Samarrës, ku ishte selia e pushtetit të tij, me qëllim që gjithnjë të mundej t’i kishte nën mbikqyrje. (2)
- Ngjashëm me këtë, halifi abasid Mu’temidi, faraoni i kohës së vet, i frikësohej djalit të Imam Hasan El-Askeriut (Paqja qoftë mbi të!). Ndaj edhe formoi një grup spiunësh dhe mamishë-detyra e të cilëve ishte që shpesh ta vizitojnë shtëpinë e Alevijjinëve e posaçërisht shtëpinë e Imam Hasan El-Askeriut (Paqja qoftë mbi të!) që, në qoftë se lind fëmijë (djalë), të mundeshin menjëherë ta mbytnin. (3)
- Ky kërkim ndaj Imam Mehdiut, me qëllim të likuidimit, u forcua veçanërisht pas vdekjes së Imam Hasan El-Askeriut (Paqja qoftë mbi të!). Shkaku ishte ajo që të gjithë e dinin se atë ditë Udhëheqja e Zotit (imameti) i qe besuar Imami të dymbëdhjetë, i cili do të mbisundojë me botën.
- Shejh Saduki, dijetar i shquar shiit, shkruan në “Kemaluddinë”:
- “Kur trupi i Imami të ndershëm Hasan El-Askeriut u varros, kurse njerëzit u shpërndanë, halifi dhe shokët e tij, filluan të kërkojnë djalin e tij të vogël dhe me kujdes e kontrolluan shtëpinë”. (4)
- Shejh Mufidi, gjithashtu dijetar eminent shiit, shkroi në “Irshad”, këtë në vijim: “Kur Imam Hasan El-Askeriu u shpërngul në ahiret, halifi i atëhershëm e kërkonte djalin e tij, ngase besimi shiit në imamet ishte i njohur dhe dihej gjithashtu se shiitët presin ardhjen e tij madhështore”. (5)

- (1) Shih në librin “Mekatil Et-talibijin”, nga Ebul-Ferxh Isfahani, i cili është leksikon i të përvuajturve, martirëve të Ali ibn Ebu Talibit, Paqj qoftë mbi të! deri në vitin 313 sipas hixhretit.
- (2) “Isatul-Vasije”, nga Ebul-Hasan Ali ibn El-Husejn El- Mes’udi, f 435
- (3) El-Kafi “Kitabul-Huxhxhe”, pjesa mbi lindjen e Ebi Muhammed El-Hasan ibn Aliut; (Paqja qoftë mbi të!) nga Muhamed ibn Jakub El-Kulejni.
- (4) “Kemaluddin”, nga Shejh Es-Saduki, vëllimi 1, f 101
- (5) “Irshad”, nga Shejh El-Mufidi, pjesa mbi vdekjen e Ebi Muhamed El-Hasan ibn Aliut (Paqja qoftë mbi të!)
  - Mu’tedidi, njëri prej halifëve të ashpër abasid, i cili sundoi nga vitet 279 deri më 289 sipas hixhretit, papritur vendosi ta shpërngulë tërë familjen El-Askeri, kur dëgjoi (kuptoi) se kanë kaluar më tepër se njëzet vjet nga lindja e djalit të Imam Askeriut (Paqja qoftë mbi të!) dhe se ai akoma është gjallë (jeton) përkundër përpjekjeve të paraardhësve të tij për ta mbytur.
  - Njëri prej oficerëve të Mu’tedidit ka thënë: “Mu’tedidi mua dhe dy të tjerëve na urdhëroi që t’u hypim kuajve dhe të nisemi në drejtim të Samarrës, bile të mos ndalemi as edhe gjatë kohës së namazit. Na e dha adresën e Askeriut dhe na urdhëroi të futemi në shtëpinë e tij pa marrë leje prej tij, si dhe t’ia sjellim kokën e atij që do ta takojmë aty”.
  - Në realitet, ata nuk e kuptuan se po e njëjta fuqi e cila e mbrojti Imamin prej halifëve të mëparshëm, atë do ta mbrojë edhe tani, ngase:
    - ... “ All-llahu nuk do tjetër, pos ta përsosë dritën e Tij, ndonëse jobesimtarët e urrejnë”. (Et-Tevbe, 32)
    - Dhe vërtet, sa akt i paparamenduar dhe mendjelehtë ishte ky! Nëse ekziston vullneti i Zotit, a mund që njeriu të rebelohet dhe të luftojë kundër tij? A thua vallë është e mundshme që premtimet e All-llahut xh.sh të mos realizohen? Apo, a thua është e mundshme që dëshirat e tiranëve që luftojnë kundër Urdhërave të Zotit të mos shkatërrohen?
    - Po a thua vallë nuk është e mahnitshme që All-llahu i Plotfuqishëm shumë herë më parë e ka treguar fuqinë e Tij, dhe njerëzit, pas kësaj do të duhej të dinin se, nëse Ai dëshiron që robit të tij të zgjedhur t’i japë pushtet dhe fuqi, si dhe ta shkatërrojë mosbesimin (kufrin) dhe politeizmin përmes tij, askush në këtë nuk mund ta ndalojë?
    - Fatmirësisht, rrëfim i ngjashëm është përmendur në Kur’anin e Madhnueshëm. Faraoni, sundimtari i lartë i Egjiptit, i cili posedonte fuqi dhe krenari, pohonte për veten e tij se është Zot. Vendosi t’i mbytë të gjithë foshnjat meshkuj të fisit Benu Israil, ngase dëgjoi se në mesin e tyre është lindur ai që do ta shkatërrojë mbretërinë e tij.
    - E derdhi gjakun e të pafajshmëve, ndërsa shumë njerëz i shpërnguli dhunshëm nëpër vise të panjohura; mirëpo në rrëfimin e mëposhtëm të nxjerrë nga Kur’ani i Madhnueshëm, do të shohim se si All-llahu i Gjithfuqishëm e ktheu Pejgamberin e Tij, dhe si nëpërmjet vullnetit të Zotit, e mbrojti Musain a.s, kurse e shkatërroi Faraonin. All-llahu xh.sh në Kur’anin e Madhnueshëm thotë:
      - “ Ne nënën e Musait e inspiroam: T’i japë atij gji, e kur të keshë frikë për të, atëherë atë hidhe në lumë, e mos u frikëso as mos u pikëllo, se Ne do ta kthejmë atë ty dhe do ta bëjmë atë nga të dërguarit. E atë e gjeti familja e faraonit, ashtu që në fund ai t’u bëhet atyre armik e dëshpërim. Vërtet, Faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin kundërshtarë (gabonin me qëllim). E gruaja e Faraonit tha: “Shpresë gëzimi për mua



dhe për ty, mos e mbytni atë, ndoshta do të na sjellë dobi ose do ta adoptojmë për fëmijë”. Pra ata nuk e dinin rrjedhimin. E zemra e nënës së Musait agoi e zbrazët (kur kuptoi se ka rënë në duar të Faraonit) dhe gati të zbulojë atë (fëmijën), sikur të mos ia forconim Ne zemrën e saj që të bëhet e bindur (në premtimin e All-llahut). E ajo i tha motrës së saj: “Gjurmoje atë!”, kurse ajo e shikonte atë prej së largu dhe ata nuk e hetonin ( se ishte motra e tij që e përcjell). Ndërsa Ne ia patëm ndaluar atij më parë thithjen e gjinit, e ajo (motra e Musait) tha: “A doni t’ju tregoj për një familje që do të kujdeset për të dhe që do të jenë të singertë ndaj tij? Dhe ashtu atë e kthyen te nëna e vet që ajo të jetë e kënaqur e jo e pikëlluar dhe që ta kuptojë ajo se premtimi i All-llahut është i vërtetë e i sigurtë, por shumica e tyre nuk e dijnë”. (El-Kasas, 7-13)

- Po, All-llahu do ta mbrojë argumentin e Tij (Huxhxhetin) dhe do t’i përmbush premtimet dhe udhëzimet e Tij, ngase vendimi i Tij bazohet në kryerjen e tyre, edhe pse shumica e njerëzve këtë nuk e di...

- A thua All-llahu me të Madhin e Vet, do ta mbronte peygamberin Musanë a.s i cili ishte peygamber vetëm i një populli dhe fisi, kurse Imamin e të gjithë kohërave (Imami Zeman) do ta lë në duart e Mu’temidit dhe Mu’tedidit?

- A thua All-llahu do ta mbronte Musain a.s derisa ishte në dallgët e furishme të lumit, kurse të mos sigurojë Imamin e të gjitha kohërave i cili ishte në shtëpinë e babait të vet Imam Hasan El-Askeriut?

- A thua All-llahu do ta mbronte peygamberin-Ibrahimin a.s (rrëfimi i të cilit është përmendur në Kur’an) në mes të zjarrit përcëllues, kurse të mos e mbrojë margaritarin e fundit të pasardhësve të Peygamberit s.a.v.s nga mendjemadhësia dhe urrejtja e halifëve abbasidë?

- Me të vërtetë, në çfarë mënyre mendojnë dhe gjykojnë njerëzit mendjelehtë?

- Në agim, në mes të muajit Sha’ban të vitit 255 sipas hixhretit, Imam Hasan El-Askeriu e shikoi/vështroi fytyrën qiellore-të shkëlqyeshme, të birit të tij, i cili duhet t’i përmbushë të gjitha Premtimet dhe Udhëzimet e Zotit.

- Nuk kaluan më tepër se tri ditë pasiqë u lind, kur Imami i njëmbëdhjetë e mori djalin e bekuar dhe duke ua treguar shokëve të tij tha:

- “Pas meje ky do të jetë zotëriu juaj dhe pasardhësi im, dhe ky është “Mbështetësi” (El-Kaim) ardhjen e të cilit të gjithë do ta presin. Kur toka të jetë përplot me padrejtësi dhe tirani, ky do ta mbushë me paqe dhe drejtësi”. (1)

- Kur djali i tij u lind, Imami i njëmbëdhjetë u tha disa shokëve të tij:

- “Tiranët kanë thurrur komplete që të më vrasin, me qëllim që të mos lind djali im, por a e shihni tani sa është i fuqishëm pushteti i të Gjithëfuqishmit”. (2)

- Imam Hasan El-Askeri, (Paqja qoftë mbi të!) porositi dhjetë mijë funta bukë dhe mish, dhe urdhëroi t’u ndahet njerëzve të fisit Benu-Hashim, që kësisoji në këtë mënyrë ta shënojë lindjen e rëndësishme. Kjo detyrë e rëndësishme, i qe besuar Osman ibn Saidit, i cili e kreu këtë në mënyrën më të mirë.

- Që nga fillimi Imam Hasan El-Askeri (Paqja qoftë mbi të!) e fshihte djalin e tij nga të panjofshmit.

- Lexoni me vëmendje fjalët e Shejh Mufidit, nga të cilat një pjesë të madhe cituam: “Imam Hasan El-Askeriu (Paqja qoftë mbi të!) e përgatiti udhëheqjen e vërtetë për djalin e tij.

(1) “Jenabiul-Mevedde”, nga Sulejman ibn Ibrahim El-Kanduzi El-Hanefi, f 60

(2) Es-Sejjid ibn Tavus, citat nga Hasan El-Askeri, Paqja qoftë mbi të!

Lindjen e tij e ruajti si sekret, ngase jetonte në kushte të rënda, kur halifët gjithnjë kërkonin pas djalit të tij dhe me kujdes ndiqnin gjithçka që Imam Askeriu punonte. Shkak i këtillë ishte përhapja e besimit shiit mbi paraqitjen e Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) ndaj halifët prisnin që kjo edhe të ndodhë. Prandaj Imam Hasan El-Askeriu (Paqja qoftë mbi të!) nuk e tregonte djalin e tij, ndaj edhe mu për këtë armiqë nuk mund ta njihnin pas vdekjes së të jatit të tij. (1)

- Edhe pse armiqët dhe kundërshtarët e Imam Mehdiut për të asgjë nuk dinin, shiitët e sinqertë mblidhnin lajme të reja mbi këtë ngjarje të rëndësishme (të gëzueshme).

- Disa prej tyre Imam Askeriu i njoftoi nëpërmjet letrave. Njëri nga shiitët e vërtetë, Ahmed ibn Is'haku pranoi një letër, të cilën e kishte shkruar vetë Imam Askeriu, në te thuhej: “Më ka lindur djalë. Prandaj, ruaje këtë sekret dhe lajmëroji vetëm kushrinjtë e tu të afërt dhe miqtë e veçantë. (2)

- Disa shiitë privatisht e vizitonin Imam Askeriun (Paqja qoftë mbi të!), me qëllim që ai vetë t'ua tregojë Imamin e dymbëdhjetë-Mehdiun, i cili do të jetë prijësi i tyre. Ebu Omeri dhe Ahvazi rrëfejnë: “Ebu Muhammedi (Imam Hasan El-Askeriu-Paqja qoftë mbi të!), na e tregoi djalin e tij (Imamin e dymbëdhjetë), dhe na tha: “Ky është zotëriu juaj (sahib) (3)

- Disa shiitë tjerë e vizitonin Imam Askeriun në grupe, ndërsa nëse Imami u besonte se do ta ruajnë sekretin, atëherë ua tregonte djalin e tij të dashur...

- Muavie ibn Hakimi, Muhammed ibn Ejjubi dhe Muhammed Osman Omeri, kanë thënë: “Ishin dyzet veta në shtëpinë e Imamit, kur hirësia e tij na e tregoi djalin e vet, duke na thënë: “Ky është Imami juaj dhe trashëgimtari im. Këtë duhet ta dëgjoni pas meje dhe guxoni t'i kundërviheni-ngase në të kundërtën do të zhdukeni”. (4)

- D.t.th. që nga koha e lindjes së “hënës së re” (d.t.th. Imam Mehdiut) e deri te fillimi i imametit të tij, shiitët gjithnjë shkonin tek Imami i njëmbëdhjetë dhe ia uronin-lindjen e djalit.

- Hasan ibn Hasan El-Alevi ka thënë: “Shkova ta shoh Imam Hasan El-Askeriun (Paqja qoftë mbi të!) në qytetin e Samarrës dhe ia urova lindjen e djalit”. (5)

- Ebu Abdull-llah ibn Abass, gjithashtu ka thënë: “E vizitova Imam Askeriun (Paqja qoftë mbi të!) në qytetin e Samarrës dhe ia urova lindjen e djalit”.(6)

- Po, kështu u lind Imami i të gjitha kohërave dhe u mbajt i ruajtur nga të prekurit e të huajve. Ndonjëherë, vetëm shiitëve të përvuajtur u lejohej që ta shihnin, deri në vitin 260 sipas hixhretit, kur edhe vdiq Imami i njëmbëdhjetë, kurse me urdhërin e Zotit-imameti (Udhëheqja) iu dha Pronarit të pushtetit-Sahibul-Emr.

(1) “El-Irshad”, nga Shejh El-Mufidi, pjesa mbi vdekjen e Ebu Muhammed ibn Aliut, (Paqja qoftë mbi të!)

(2) “Kemaluddin”, nga Shejh Es-Saduki, vëllimi 2, f. 104

(3) “El-Irshad”, i Shejh El-Mufidit, pjesa mbi Imamin e dymbëdhjetë.

(4) “Kemaluddin”, Nga Shejh Es-Saduki, vëllimi 2, f. 109

(5) “Isbetul-Hudat”, nga Shejh Hurr El-Amili, vëllimi 6, f. 433

(6) Ibid, vëllimi 7, f. 20

## FSHEHJA E VOGËL

- Kur Imam Hasan El-Askeriu vdiq, (Paqja qoftë mbi të!), udhëheqja e Zotit (imameti) kaloi tek margaritari i fundit i Familjes së Pejgamberit s.a.v.s, Imam Mehdiu (Paqja qoftë mbi të!). Edhe pse Hirësia e Tij nuk u shfaq në mesin e njerëzve, atyre në të cilët kishte besim ua lejonte që ta vizitojnë dhe t'i flasin mbi problemet dhe çështjet e shiitëve. Ndërsa pastaj, ata ua përcillnin njerëzve të tjerë urdhërat e tij.
- Nga aspekti fetar, këta ishin muslimanë të shquar, të cilëve mund t'u besohej, ndaj edhe luanin rolin e ndërmjetësit mes Imamit dhe njerëzve. Ata ua përcillnin njerëzve porosinë e tij Madhështore.
- Duke e studjuar nivelin e besimit dhe takvallëkut (devotshmërisë) së këtyre individëve, jo vetëm që e vërejmë madhështinë e tyre, por sa vijnë e bëhemi më të afërt edhe me vetë Imamin e të gjitha kohërave-ngase në fjalët e këtyre miqëve të shquar, të shtrenjtë, fisnik, dhe të besueshëm të Imamit Fisnik-hasim në gjerësinë e Madhësisë së Hirësisë së tij-Imam Mehdiut, Paqja qoftë mbi të!
- Nga miqët e Imami-Zemanit, katër prej tyre ishin më të dashurit dhe më të besueshmit-zëvendës të tij, të cilët ishin ndërmjetës mes Imamit dhe njerëzve, ndërsa janë të njohur me emrin “Nevvabul-Erbea” (“Katër zëvendësit”).
- Për të dijtur më tepër për personalitetin e tyre, në vijim sjellim përshkrim të shkurtër të secilit prej tyre:
  - 1). Osman Ibn Said Omeri: Ky personalitet i nderuar, nuk ishte vetëm zëvendës (naib) i Imami-Zemanit (Imamit të të gjitha kohërave), por edhe përfaqësues (vekil) i Imam Hasan El-Askeriut. (Paqja qoftë mbi të!) Ai i rregulloi dhe organizoi shumë punë të shiitëve. Imami i dhjetë El-Hadi (Paqja qoftë mbi të!) u tha ithtarëve të vet për Osman ibn Said Omerin:
    - “Ky Ebu Omeri është person i besueshëm, i ndershëm dhe i vendosur. Çfarë do që t'u thotë ai, dini se u thotë në emrin tim, ndërsa çfarë do që punon, atë e bënë në emrin tim”. (1)
    - kjo zgjati deri në vitin 254 sipas hixhretit, kur Imami i dhjetë vdiq. Atë e trashëgoi Imami i njëmbëdhjetë, i cili gjithashtu e lavdëroi personalitetin e Osman ibn Said Omerit, duke iu drejtuar shiitëve:
      - “Ky Ebu Omeri është person i besueshëm dhe i ndershëm. Atij i pati besuar paraardhësi im-Imami i dhjetë-kurse edhe unë i besoj sa të jem gjallë, po edhe pas vdekjes. Çfarë do që t'u thotë ai, e thotë në emrin tim, dhe çkado që vepron, atë e bënë në emrin tim”. (2)
      - Kështu ai u bë zëvendës (Naibul-Imam) i Imamit të dymbëdhjetë, pas vdekjes së Imam Hasan El-Askeriut, Paqja qoftë mbi të!
      - Kur vdiq Ebu Omeri, Zotëriu i Kohës (Sahibuz-Zeman) personalisht i shprehu ngushëllime djalit të tij Muhammed ibn Osmanit, duke i thënë:

(1) “El-Gajbe”, nga shejh Ebi Xhafer Muhammed ibn Hasan El-Tusi, f 215

(2) Ibid, f 215

- Me të vërtetë ne jemi të All-llahut, dhe Atij i kthehemi! I dëgjojmë urdhërat e Tij dhe jemi të kënaqur me Caktimin e Tij. Babai yt jetoi mirë, dhe me dinjitet vdiq. All-llahu e mëshiroftë! Iu bashkangjit shokëve dhe zotërinjve të vet. Gjithnjë tentonte ta gjejë atë çka do ta afronte tek All-llahu dhe miqtë e tij. All-llahu ia dhuroftë shpëtimin! (1)

- 2). Ebu Xhafer Muhammed ibn Osmani: Ai ishte zëvendës i dyti i posaçëm i Imami-Zemanit. Ishte, gjithashtu edhe zëvendës i Imamit të njëmbëdhjetë, i cili për të pat thënë: “Madhështia e krenarisë së tij dhe pozita e tij, aq shumë janë të njohura në mesin e shiitëve, sa që nuk ka nevojë t’i shpjegojmë, e as që për to të diskutojmë”. (2)
- Në lidhje me të dhe babain e tij Osman ibn Saidin, Imam Hasan El-Askeriu, i tha njërit prej miqve të tij: “Edhe Omeri edhe djali i tij e meritojnë besimin. Çfarë do qoftë që punojnë, këtë e bëjnë në emrin tim, kurse çfarë do që thonë, e thonë në emrin tim. Andaj, dëgjoni fjalët e tyre dhe nënshtrojeni, ngase që të dy janë të vendosur dhe besnikë”. (3)
- Kurse vetë Imami-Zemani ka thënë për të: “Ai është i besuari im, dhe letra e tij vlen njësoj sikur e imja” (4).
- 3). Ebul-Kasim Husejn ibn Ruh Nevbehti: Ebu Xhafer Muhammed ibn Osman për të ka thënë: “Ky Husejn ibn Ruh Ebu Bekr Nevbehti është trashëgimtari im. Ai është përfaqësuesi dhe zëvendësi i besueshëm dhe i vendosur, ndërmjetësi mes jush dhe Pronarit të Kohës (Sahibul-Emr). Andaj besoni dhe drejtohuni atij kur janë në pyetje çështjet dhe punët e rëndësishme. Mua më është dhënë kjo detyrë dhe unë e përmbusha. (5)
- Shejh Tusi, bekimi i All-llahut qoftë mbi të!, ka thënë për të: “Ebul-Kasim Husejn ibn Ruhin, miqtë e tij, por edhe armiqtë e konsideronin më të dijshmin prej njerëzve”. (6)
- Vlefshmëria e Husejn ibn Ruhit si përcaktues dhe bartës i detyrës së zëvendësit ishte e pranuar edhe nga ana e armiqve të tij. Shalmagani, i cili ishte njëri prej tyre që kinse kishte të drejtë të deklarohej si bartës i kësaj detyre, më në fund qe i detyruar të pranojë se nuk është në të drejtë (d.t.th se është gabim, vërej. e përkth.), kur Imami Zemani e urdhëroi Husejn ibn Ruhin ta publikojë. Ai (Shalmagani) tha: “Nuk është e drejtë mes meje dhe All-llahut që për Husejn ibn Ruhin të them çfarë do qoftë që nuk është e vërtetë. Edhe pse gabimi i tij ndaj meje është i madh, ai megjithatë është caktuar nga Imami Zemani t’a kryejë këtë detyrë. Shiitët nuk guxojnë të largohen prej tij”. (7)
- 4). Ebul-Hasan Ali ibn Muhammed Simmari: Ky personalitet i shquar ishte zëvendësi i fundit i posaçëm (Naibul-Has) i Imami-Zemanit Fisnik. Vdekja e tij përputhet me pesëmbëdhjetë sha’banin e vitit 329 sipas hixhretit. Husejni ibn Ruhi e prezentoj si zëvendës të Imamit.

- (1) “Tenkihul-gajbetus-Sugra”, nga Muhammed Es-Sadri, f 401
- (2) “ Tenkihul-Mekal”, nga Mamakani, vëllimi 3, f 149
- (3) El-Gajbe”, shejh Et-Tusi, f 219
- (4) Ibid, f 220
- (5) “Tarihul-Gajbetis-Sugra”, nga Muhammed Es-Sadri, f 407
- (6) “El-Gajbe”, shejh Et-Tusi, f 236
- (7) “Biharul-Envar”, nga Al-lame El-Mexhlisi, “Libri mbi fshehjen”, siç është theksuar nga “Gajbe”, prej Shelmaganit.

Letra e fundit e Zotëriut të Kohës (Imami-Zemanit), drejtuar katër zëvendësve të posaçëm, i qe drejtuar këtij njeriu fisnik. Kështu, përmes kësaj letre drejtuar Ebul-Hasan Ali ibn Muhammed Simmarit, Imami e shpalli vdekjen e Ali ibn Muhammedit dhe fundin e periudhës në të cilën ekzistonin zëvendësit e tij:

- “Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit të përgjithshëm!: Do të vdesësh për gjashtë ditë, le t’ju jepë All-llahu durim vëllezërve të tu të fesë gjatë shkuarjes tënde (vdekjes) Prandaj, bëhu gati, por asnjë mos cakto që të të zëvendësojë, ngase nga dita e vdekjes tënde-do të fillojë periudha e Fshehjes sime të Madhe. Më askush nuk do të mundet të më shohë, derisa All-llahu nuk cakton ndryshe. Unë sërish do të paraqitem pas një periudhe mjaft të gjatë-kur njerëzit do të jenë të lodhur nga pritja, kurse ata që janë të dobët në fenë e tyre, do të thonë: “Çka, po ai akoma është gjallë?; kur do të jenë të dhunshëm dhe pa ndjenja, kurse bota përplot me padrejtësi dhe dhunë. Së shpejti dikush do të thotë se më ka parë. Kujdes! Kush pohon një gjë të tillë përpara se të befasohen Sufjanët dhe të dëgjohej zëri prej qiellit që shpall ardhjen time, është gënjeshtar. Nuk ka fuqi dhe madhështi përveç se tek All-llahu i Gjithëfuqishëm. (1)

- Siç mund të shihet nga ky pasues, kjo ishte urdhëresa e tij e fundit, ku dyert e përfaqësisë së veçantë (zëvendësimit) janë të mbyllura me vdekjen e Ali ibn Muhammedit. Nga vdekja e tij, secili që do të pohojë se është ndërmjetës si dhe ka patur mundësinë ta shohë Imamin, është gënjeshtar. Në periudhën e Fshehjes së Madhe askush nuk pohon se ka qenë në prani të Imami-Zemanit Fisnik.

- Njerëzit nuk do t’i pranonin katër përfaqësuesit e posaçëm të Imamit, sikur të mos iu kishin treguar çuditë e Pronarit të pushtetit (Sahibul-emri) nëpërmjet të cilave vërtetoheshite vërtetësia dhe preciziteti i tyre, edhe pse i konsideronin për njerëz të besueshëm dhe aspak nuk dyshonin në devocionin e tyre, fenë (besimin) dhe diturinë që posedonin. (2)

- Katër përfaqësuesit e posaçëm ia paraqitnin Imamit problemet dhe pyetjet e dijetarëve shiitë, kurse ai në to, që përgjigjja ishte më e domosdoshme, përgjigjej në formën e shkruar (me letër) dhe i dërgonte përmes përfaqësuesve të sipërpërmendur.

- Në këto letra, janë sqaruar problemet më të rënda dhe më të rëndësishme të besimit shiit.

- Njëra prej tyre ishte edhe pyetja e përgjegjshmërisë së shiitëve, në lidhje me ndodhitë e reja në periudhën e Fshehjes dhe ballafaqimin e tyre me të. (d.t.th Fshehjen, vërej e përkth)

(1) “El-Gajbe”, shejh Et-Tusi, fq 242 dhe 243

(2) “El-Harxhij”, nga Kutbudin Ravandi, citat nga “Biharul-Envar”, prej Al-lame El-Mexhlisiut, pjesa 13 dhe 21

- Në letrën, të cilën Imami-Zemani ia dërgoi shiitit të njohur dhe të shquar Is’hak ibn Jakubit, theksohen detyrat, obligimet dhe drejtmet për shiitët në periudhën e Fshehjes. Shiitët i ndoqën këto porosi me shekuj, dhe kjo është një prej dëshmimeve të madhësisë dhe përhershmërisë së udhëheqjes (sundimit) islam.

- Në njëren nga letrat, të cilat Is’hak ibn Jakubi, nëpërmjet përfaqësuesit të dytë të posaçëm, ia dërgoi Imamit, e pyeti mbi çështje nga më të ndryshmet, kurse njëra prej tyre kishte për objekt pikërisht trajtimin e diskutimit tonë...

- Imami iu përgjigj, se në lidhje me këtë çështje, njeriu duhet t’u drejtohet atyre që vërtet kuptojnë rrëfimet (thëniet) e Imamit.

- Mirëpo, sa u përket problemeve të cilat do të shfaqen në të ardhmen, do të duhej të ktheheni në transmetimet e thënieve tona, nga ata janë argumentet e mia për ju, kurse unë jam Argumenti i All-llahut (Huxhxhetull-llah) për ta. (1)
- Letrat e tjera të Imam Mehdiut janë dërguar gjatë periudhës së Fshehjes së Vogël (Gajbetus-Sugra) dhe secila prej tyre shtjellonte çështje nga më të ndryshmet dhe jepte udhëzim nga thellësia e pafund e detit të urtësisë. Të gjitha këto letra, nëpërmjet përfaqësuesve besnikë të Imami Fisnik, u përcilleshin njerëzve-të cilët mezi i pritnin...
- Po, katër përfaqësuesit, të cilët me vite të tëra ishin në nivelin më të lartë si besimtarë dhe individë të besueshëm, ishin ndërmjetësues të bekuar në mes të Imami dhe njerëzve, deri në vitin 329 sipas hixhretit, kur përfundoi së ekzistuari pozita e përfaqësuesit, dhe filloi, me vullnetin e All-llahut xh.sh periudha e Fshehjes së Madhe (Gajbetul-Kubra) e Imami-Zemanit. Kjo ishte ajo periudhë e Fshehjes, të cilën qysh para shumë kohësh e paralajmëroi Pejgamberi-Muhammedi s.a.v.s dhe imamët shiit, ndaj edhe muslimanët janë të durueshëm në pritjen e çastit, kur me lejen-urdhërin e All-llahut xh.sh Zotit të Plotfuqishëm, do të shfaqet Prijësi i Pritur dhe do të përmbushet synimi i Zotit.

## **FSHEJHA E MADHE**

- Pas vitit 329 sipas hixhretit, kur filloi periudha e Fshehjes së Madhe, përfundoi periudha e përfaqësuesve të Imami-Zemanit. Kushdo që pohon gjatë periudhës së Fshehjes së Madhe, se është ndërmjetës apo përfaqësues i tij, sipas vetë fjalëve të Imami-Zemanit, ky person do të duhet të shpallet gënjeshtar.
- Në mësimet (ligjëratat) e imamëve të ndershëm, qëllimi (synimi) i Fshehjes krahasohet me Diellin i cili është i fshehur mbi retë (mjegullat), por, përsëri është burim i jetës dhe gjallërisë për krijesat e gjalla. Ngjashëm me këtë, edhe pse Imami akoma është në Fshehje, ai është burim i jetës-ekzistimit për pjesën tjetër të mbetur të botës.
- Gjatë kësaj periudhe, shumë njerëz kanë arritur të takohen me Hirësinë e Tij (Imam Mehdiun), por asnjëri prej tyre nuk ka pohuar, se në të vërtetë e ka parë, apo se është përfaqësues i tij, ngase vetëm katër përfaqësues të zgjedhur (Nevvabul-hass) kanë patur nderin të shihen dhe takohen me Hirësinë e Tij, kurdo që një gjë të tillë e kanë dëshiruar.
- Disa nga emrat e atyre fatlumëve, që kanë patur nderin të takohen me Imamin, janë të përmendur në librat e besueshëm (për më gjerësisht shih në “En-Nexh”); siç është p.sh libri “Es-Sakib” i Mirza Husejn Et-Tabersi En-Nurit, pjesa e shtatë. Në mesin e atyre emrave fatlumë që u takuan me Imamin janë: Al-lame Hil-li-dijetari dha hatibi i njohur islam; Mukades Erdebili personi më i devotshëm dhe luftëtar më i madh për të drejtat e njeriut në kohën e vet; Sejjid ibn Tavusi, ligjërues i devotshëm dhe modest; Sejjid Bahrull-llumi-dijetari i famshëm, si dhe disa personalitete të mëdha dhe të shquara të Islamit.
- Po, me sytë e tyre panë “Diellin” (Imamin), dhe zemrat e tyre ishin të mbushura me besim në Imamin e të gjitha kohërave (imamul-asri), ndaj edhe të tjerëve me përulje u tregonin mbi takimet e tyre me Hirësinë e Tij.
- Si shembull, mundemi ta analizojmë pjesën e porosisë (testamentit) të cilën Sejjid ibn Tavusi e shkroi për djalin e tij në vitin 650 sipas hixhretit. Me fjalët e tij i dha shpjegim birit të tij, me të cilat fjalë nënkuptohej e vërteta, pa pohuar se në realitet, vërtet e ka parë: “ O djali im! Nëse të jepet mudësia që të keshë sukses në

zbulimin e të vërtetës dhe fshehtësisë, atëherë do të lajmëroj për Imam Mehdiun, kështu që kurrë nuk do të dyshosh dhe nuk do të nevojiten argumente intelektuale e as ligjërata të shënuara... Ngase, Hirësia e Tij, vërtet ekziston, dhe derisa All-llahu i Lartëmadhëruar dhe i Mëshirshëm nuk i jep leje të shfaqet, ai nuk e ka për obligim t'ia paraqitet botës dhe të tregojë se çfarë vepron. Kjo nuk ndodh kështu vetëm me këtë, por kështu u ka ndodhur shumë pejgamberëve dhe ndjekësve (ithtarëve) të tyre. Duhet të besosh në këtë dhe ta konsiderosh këtë besim dhe bindje tënden. Dhe dije se dituria e babait tënd për Hirësinë e Tij është më e shkëlqyeshme (ndritshme) se sa dituria mbi këtë botë". ("Keshful-Eser", Haxhi Mirza Husejn Et-Tabersi En-Nuri, pjesa e parë, f: 18.)

- Njëri prej tyre (d.m.th atyre që e pamë Imamin) është edhe vëllai ynë sunnit, Hasan Iraki, i cili në rininë e tij çonte një jetë jomorale. Një ditë u zgjua nga dremitja dhe ashtu i shkujdesshëm, pyeti vetveten: "A thua jam krijuar për mëkate?", e lëshoi vendin e pamoralshëm ku gjindej dhe vajti në Xhami. Rastësisht ligjëruesi po fliste mbi Imam Mehdiun. (Paqja qoftë mbi të!) Plotësisht i shqetësuar, shpirti i Hasan Irakit u mbush me dashuri të zjarrtë ndaj Imamin. Që atëherë ai iu lut All-llahut xh.sh në çdo lutje të tij, t'ia jep mundësinë ta shohë Imamin. (Bekijetull-llah)
- Më në fund, iu pranuan lutjet e tij, dhe ... shtatë ditë e shtatë netë u mësua për rrugën e shpëtimit-në praninë e Hirësisë së Tij. (Imami Mehdiut).
- Pas kësaj, ky njeri u bë i njohur si njëri prej dijetarëve më të mëdhenj të Islamit- Abdul-Vehab Shaërani-njëri prej dijetarëve më të shquar sunnitë, dhe treguesi i parë i kësaj ndodhie e quajti Irakiun: "Zotëriun e tij të lartë-shejh Iraki" (më gjerësisht shih: "Keshful-Huxhxhe" ose "Barname Sa'dat", nga Es-Sejjid ibn Tavusi, kapitulli 75, f 74)
- Gjatë Fshehjes së Madhe, Hirësia e Tij u dërgonte letra individëve të caktuar dhe dijetarëve të mëdhenj islamë. Në këto letra, zgjidheshin problemet e reja të rënda dhe jepeshin udhëzime të domosdoshme. Në mesin e tyre është edhe një letër e vitit 410 sipas hixhretit, në të cilën lavdërohet dijetari i shquar islam Muhammed ibn Muhammed ibn Nu'mani, i quajtur Shejh Mufidi:
- Shejh Mufidi gëzonte një pozitë të veçantë për shkak të diturisë së tij dhe përkushtimit, ndaj kjo letër paraqiste mirënjohje për mundin e tij dhe shërbimet e rëndësishme. Ndaj, edhe pas shumë shekujsh-të cilët kanë kaluar, njerëzit Shejh Mufidin akoma e respektojnë dhe i mahniten...
- Rëndësia e kësaj letre qëndron në atë se qartë tregon që Imami di gjithçka mbi gabimet dhe veprimet morale të disa shiitëve, dhe në të njëjtën kohë tregon mbi kuptimin e ekzistimit të tij dhe ngjallë shpresat; Imami-Zemani thotë: "Ne shumë mirë e dijmë gjithçka që ju ndodh dhe asgjë prej asaj (që ndodh) nuk e kemi të panjohur. E dijmë se me çfarë probleme ballafaqoheni qysh kurë keni filluar të bëni vepra të pahijshme-të cilat vepra ardhësit e juaj u largoheshin. E dijmë këtë që atëherë kur paraardhësit tuaj e thyen marrëveshjen-sikur të mos dijnin asgjë për të. Nuk do t'u anashkalojmë, e as nuk do t'u harrojmë-që mos t'ju kaplojnë hallet dhe fatkeqësitë t'ju ndodhin, dhe kështu armiqtë të fitojnë shansin dhe t'ju sundojnë. Ndaj, përmendnie All-llahun dhe frikësojuni Atij!"
- Shkrimet e çmueshme të Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) gjatë Fshehjes së Madhe, gjithsesi që paraqesin Udhëzimin më të rëndësishëm për shiitët (ndjekësit/pasuesit e tij). Këto shkrime mund të gjenden në librat e besueshëm shiitë.

(1)

- Mirëpo, ne tani po kalojmë në një kohë mjaft të ndjeshme të periudhës së Fshehjes së Madhe.

---

- Në ligjëratat islame, kur diskutohet mbi fshehjen e Imamit të dymbëdhjetë, tregohet në natyrën e ndërlikuar të kësaj sprove të Zotit. Lidhur me këtë, shiitët e sinqertë dhe besnikë ndahen nga të tjerët, dhe kështu bëhen të pastër njëllëj sikur ari (floriri) i pastër. (2)

- Në ligjëratat islame, gjithashtu bëhen krahasime mes besimit të sinqertë shiit dhe besimit të disa ndjekësve të pejgamberit-Nuhit a.s, të cilët i ndejtën besnikë edhe përkundër sprovave mjaft të rënda, dhe të cilët, duke lundruar me anije, bashkë me Nuhin a.s-qenë të shpëtuar nga Përmbytja e Madhe. (Tufani)

- Ndaj janë të bekuar ata të cilët e kalojnë këtë sprovë të Zotit, të shpresojmë se edhe ne do të jemi në mesin e tyre.

(1) “Kemaluddin”, Shejh Es-Saduk, pjesa 49; “Biharul-Envar”, Al-lame El-Mexhlisi, vëllimi i 13, pjesa 36; El-Haxh Et-Tabrisi, vëllimi 2.

(2) “El-Gajbe”, Nu’mani, f 107

---



## SHIITËT GJATË FSHEHJES SË IMAMIT

- Andaj, çfarë është obligimi i shiitëve? Cilat janë përgjegjësitë e tyre?
- Në të vërtetë, a jemi ne ndjekësit e vërtetë të Hirësisë së Tij? (Imam Mehdiut, Paqja qoftë mbi të!)
- Nëse i njohim jetërat e shiitëve të devotshëm (ndjekësve të sinqertë), Imamëve të ndershëm-para Imamit të dymbëdhjetë, dhe i vërejmë sakrificat e tyre-të cilat i kanë bërë pa asnjëfarë hezitimi, menjëherë, në vend do të zgjohemi nga gjumi ku kemi rënë, dhe do t'i kuptojmë dobësitë dhe mangësitë tona.
- Po vallë Selman El-Farisiu, Ebu Dherr El-Gifariu, Ammar bin Jasiri dhe Malik El-Eshteri a nuk ishin pasues të Aliut (Paqja qoftë mbi të!) në kohën e të cilit jetuan? Po ne sot, a jemi ndjekës të imamit të të gjitha kohërave?
- Po Mejsem Et-Tammari, i cili kurrë nuk u ndal së lavdëruari Aliun-Prijësin e besimtarëve (Emirul-Mumininin) a nuk ishte ndjekës i tij? Kurse ne të cilët me Imamin e kohës sonë kalojmë nëpër një periudhë të çuditshme-a jemi ndjekës të Hirësisë së Tij?
- A thua shehidët e Qerbelasë, të cilët me dashuri shkuan rrugës së mbrojtjes së Imamit të kohës së tyre, Husejnit (Paqja qoftë mbi të!) dhe qenë të vrarë-nuk ishin ndjekësit e Shkëlqesisë së Tij? A thua edhe ne, të cilët refuzojmë t'u japim pasurinë tonë, jetën dhe gjithçka tjetër për Imamin e kohës sonë-jemi ndjekës të Hirësisë së Tij?
- A thua personi sikur Hisham ibn Hakimi, i cili në diskutimet e tij të jashtëzakonshme i kundërshtoi dhe dërmoi kundërshtarët e Pushtetit të Zotit (Imametit), kështu që u emërtua “ndihmës i Imamit” nga ana e Imam Sadikut është shiit? Kurse, a jemi ne, të cilët jemi të ngadalshëm (plogësht) në përmbushjen e detyrës sonë më të madhe-pranimin e Imamit të kohës sonë, gjithashtu shiitë?
- Sipas asaj që lexojmë në Kur'an dhe thëniet e Pejgamberit s.a.v.s dhe Imamëve të ndershëm, Imami i të gjitha kohërave (Imami-Zeman) ka përgjegjësi të posaçme, që Imamët tjerë nuk i kanë patur. Pushteti i tij do të jetë gjithëpërfshirës dhe ai do ta mbulojë tokën me drejtësi dhe barazi. Do të shërbehet me pasuritë e tokës dhe burimet natyrore. Do t'a përmirësojë dhe zhvillojë tokën, kështu që në këtë mënyrë do të rritet edhe kuptimi dhe vetëdija e njeriut.
- Ndaj edhe duhet të pyetemi: Pasuesit/ndjekësit e tij, a thua kanë ndonjë obligim të posaçëm? A thua vallë shiitët nuk do të duhej të përpiqeshin ta meritojnë dhe të jenë bashkudhëtarët e tij të veçantë kur Ai të shfaqet me Urdhërin e Zotit?
- Prandaj, ejani t'i shikojmë obligimet tona dhe mënyrat të cilat duhet t'i plotësojmë. Pa asnjë fije dyshimi, detyra jonë e vërtetë është që të njihemi me të.
- Pranimi i Imami-Zemanit është aq i rëndësishëm dhe domethënës, saqë në një hadith të Pejgamberit s.a.v.s thuhet:
  - “Ai i cili vdes pa e pranuar imamin e kohës së vet, është njësoj sikur ai që ka vdekur para ardhjes së Islamit, në periudhën e injorancës (xhahilijetit)”. (1)
  - Të vdesësh në kohën e xhahilijetit, d.t.th të vdesësh pa Islam dhe besim.
  - Kurse është e qartë se ai i cili vdes pa pranimin e Imamit të kohës së vet i takon grupit të jobesimtarëve.
- Në një thënie tjetër, janë shënuar fjalët e Imam Muhammed El-Bakirit (Paqja qoftë mbi të!):

- “Ai i cili vdes pa pranimin e Imamit, njësoj sikur të ketë vdekur në xhahilijet, kurse njerëzit nuk janë të privuar nga pranimi i Imamit të tyre”. (2)
- Ndaj ne duhet të përpiqemi me të gjitha forcat ta pranojmë Hirësinë e Tij (Imami-Zemanin) për hirë të Islamit dhe besimit tonë, për të qenë në mesin e tyre që e meritojnë shpëtimin dhe në mesin e të besueshmëve.
- Obligim tjetër i shiitëve, të cilin e ka përmendur Imami Fisnik, është çështja e gatishmërisë për pritjen e ardhjes së Shpëtimtarit. Shkalla e parë e cila të çon drejt shpëtimit është pranimi i Imamit, kurse e dyta është përgatitja për pushtetin e drejtë të cilin do ta vendosë Hirësia e Tij.
- Ai i cili e pret (mu’tedhir) dhe përgatitet për ardhjen e Imamit, duhet të ketë cilësi të mira dhe ta meritojë që të jetë bashkudhëtar i tij-Imam Mehdiut (Paqja qoftë mbi të!) Ai duhet ta sakrifikojë jetën e tij dhe pasurinë në këtë rrugë. Ndaj lidhur me këtë Imam Sadiku ka thënë:
- “Ai i cili i pret (pranon) urdhërat tona, është sikur ai që e jep gjakun e tij (bie shehid, vërej. e përkth.) në rrugën e All-llahut.” (3)
- Po, me të vërtetë ai që është i përgatitur për ardhjen e Imamul-Asrit (Imamit të të gjitha kohërave) shndërrohet dëshmorë (martir, shehid) në rrugën e All-llahut xh.sh. Sipas një rrëfimi tjetër, i njëjti Imam (Imam Sadiku) u fliste disa prej ithtarëve të tij-mbi ata të cilët vërtetë presin ardhjen e Imami-Zemanit, duke thënë:
- “Ai i cili vdes duke e pritur pushtetin e El-Ka’imit i njëjtë është sikur ai që e është në praninë e El-Ka’imit (Imam Mehdiut, Paqja qoftë mbi të)”
- Dhe më pas, pasi pushoi pakëz shtoi:
- “Ai është sikur atë që e ka goditur shpata duke e ndjekur El-Ka’imin”.
- Më pas vazhdoi të flasë duke thënë:
- “Jo pasha Zotin! Ai është sikur ai që bie shehid në prezencën e Pejgamberit s.a.v.s” (4)
- A jemi ne në mesin e atyre të cilët e presin ardhjen e Hirësisë së Tij? A e presim, të paktën premtimin e All-llahut për Pushtetin e Zotit (Velijjull-llah), ashtu siç i presim ata të cilët i duam, kur janë në udhëtim, të na kthehen prej udhëtimit?
- Edhe në një nga thëniet e shumta të Imam Sadikut-flitet mbi veçoritë e bashkudhëtarëve të Imam Mehdiut-Paqja qoftë mbi të gjithë! Imam Sadiku thotë:
  - (1) “Ilzam En-Nasib El-Huxhxe El-Gajbe », shejh Ali Jazdi El-Hairi, f 5
  - (2) “Muntehabul-Eser”, pjesa e dhjetë, f 5
  - (3) “Kemaluddin”, shejh Es-Saduk, f 336“Biharul-Envar”, Al-lame El-Mexhlisi, vëllimi 52, f 126
- “ Nëse dikush e konsideron kënaqësi të jetë në mesin e bashkudhëtarëve të El-Ka’imit, ai atëherë duhet ta presë atë (ardhjen e tij) dhe të sillet mirë dhe i përkulur. Nëse vdes para ardhjes së Ka’imit, do të shpërblehet si ndjekës i tij. Pranadaj jini të kujdesshëm dhe pritni, ngase për këtë do të jeni të shpërblyer me shpëtimin. “më gjerësisht shih: “El-Gajbe”, nga Muhammed ibn Ibrahim ibn Xha’fer En-Numani, f 106)
- Ai i cili pret ardhjen e tij (Imam Mehdiut-Paqja qoftë mbi të!) dhe nuk është ndalë së bëri punë dhe vepra të mira e të çmuara, me siguri që do ta meritojë Mëshirën e All-llahut xh.sh, ndaj edhe All-llahu xh.sh do ta mbulojë me bekimet e Tij.

---

Shqipëruar në Sarajevë,  
Vjeshtë 2003/Ramazani 1424 Hixhri.